

## **RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT**

***MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA PËR SHQIPËRİNË NGA KOMITETI  
EUROPIAN PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE TRAJTIMIT ÇNJERËZOR DHE  
DEGRADUES***

**DREJTUAR**

**KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**QERSHOR 2022**

Ky raport është konceptuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në nivelin e tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtërues (MKPT) me kontributin e Nd/Komisionerëve znj. Gloria Ċarkaxhiu dhe z. Besnik Deda, nën drejtimin e Avokatit të Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Komisioneres së MKPT-së znj. Ermonela Xhafa.

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

Hyrje .....	5
Metodologjia.....	7
Seksioni I: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve/Ministria e Drejtësisë.....	8
Seksioni II: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/Ministria e Brendshme.....	58
Seksioni III: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. ....	86
Përfundime të përgjithshme.....	98
ANEX .....	100

## **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>AP</b>	Avokati i Popullit
<b>DPB</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
<b>DPPSH</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
<b>DVP</b>	Drejtoria Vendore e Policisë
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>IEVP</b>	Institucion i Ekzekutimit të Vendimeve Penale
<b>KPT (CPT)</b>	Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues
<b>KSHH</b>	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
<b>MKPT</b>	Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
<b>OSBE</b>	Organization for Security and Co-operation in Europe
<b>PBA</b>	Programi buxhetor afatmesëm
<b>QSB</b>	Qendra Spitalore e Burgjeve
<b>QMH</b>	Qendra pritëse e Mbyllur për të Huajt
<b>QSUT</b>	Qendra Spitalore Universitare Tiranë
<b>SKV</b>	Sektor i Kujdesit të Veçantë
<b>SHKBB</b>	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje
<b>VKM</b>	Vendime të Këshillit të Ministrave

## HYRJE

Republika e Shqipërisë aderoi në Konventën kundër Torturës dhe Dënimive, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese me ligjin nr. 7727, datë 30.06.1993, shpallur me dekretin nr. 592, datë 06.07.1993 të Presidentit të Republikës. Konventa hyri në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 11 maj 1994.<sup>1</sup> Bazuar në nenin 1 të kësaj Konverte parashikohet krijimi i Komitetit evropian për parandalimin e torturës dhe dënimive ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese i cili me anë të vizitave shqyrton trajtimin e personave të privuar nga liria duke synuar, në rast se nevojitet, forcimin e mbrojtjes së tyre kundër torturës dhe dënimive ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.<sup>2</sup> Në këtë kuadër kjo ka qenë vizita e radhës periodike nga momenti i miratimit të Konventës. Avokati i Popullit takoi gjatë vizitës përfaqësuesit. Vlen për t'u përmendur se ky raport u publikua në 17 Shtator 2019.

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), zhvilloi vizitën e tyre te radhës në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018<sup>3</sup>. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), që nga momenti i bërges publike të raportit të KPT-së (Shtator 2019), në inspektimet periodike të kryera pranë këtyre institucioneve ka monitoruar në vijimësi hapat e ndjekura nga institucionet për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së, si dhe ka kërkuar nga këto institucione informacion sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, mbi rekomandimet të cilat i kemi renditur në këtë raport. Duke mbajtur në konsideratë në rekomandimet për masat që duhet të ndërmerren nga organet kompetente për zbatimin e tyre, Avokati i Popullit ka adresuar edhe përgjigjen e dhënë nga qeveria Shqiptare në lidhje me rekomandimet e KPT-së dhe ka vlerësuar si mision të tij edhe monitorimin e zbatimit apo efektshmërisë të masave të marra sipas kësaj përgjigje<sup>4</sup>, e cila përbën një fakt pozitiv për adresimin e çështjeve të ngritura në këtë raport

Bazuar në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë datë 9.7.2020, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2019”<sup>5</sup>, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 130, datë 13 korrik 2020, Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020, kérkon nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe të raportojë në kohë pranë Kuvendit të Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kérkon angazhim nga ana e tij.

Ky raport përbledh gjetjet dhe konkluzionet më të rëndësishme në qasjen e institucioneve shqiptare, të cilat me anë të politikave të tyre duhet të respektojnë të drejtat e personave të privuar nga liria.

Avokati i Popullit, nëpërmjet MKPT-së dëshiron t'ju rikujtojë institucioneve rëndësinë thelbësore të këtyre gjetjeve dhe rekomandimeve të dala nga ky monitorim për institucionet shtetërore lidhur

<sup>1</sup> [http://arkiva.mfa.gov.al/dokumenta/cat\\_perfundimtar\\_shqip.pdf](http://arkiva.mfa.gov.al/dokumenta/cat_perfundimtar_shqip.pdf)

<sup>2</sup> Neni 1 i Konventës.

<sup>3</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

<sup>4</sup> Përgjigja e qeverisë Shqiptare është dërguar në datë 27 Shkurt 2020.

<sup>5</sup> shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/130/512f1dec-413f-4827-9b90-13740028038f>

me parandalimin e keqtrajtimit në vendet e privimit të lirisë në fokusin e respektimit të të drejtave të njeriut.

Raporti i KPT-së është i një rëndësie të veçantë për shtetet të cilat kanë ratifikuar “Konventën Evropiane kundër Torturës dhe Dënimive, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese”. KPT kryen vizita në vendet ku privohet liria, në mënyrë që të monitorojë se si trajtohen personat të cilëve ju është privuar liria, në institucionet si: burgje, qendrat e paraburgimit për të miturit, komisariatet e policisë, qendrat e mbajtjes së migrantëve, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social, etj. Bashkëpunimi i KPT-së dhe shteteve anëtarë është konfidential dhe shtetet mund të zgjedhin vetë nëse dëshirojnë të publikojnë raportin me gjetjet e KPT-së si dhe përgjigjen e tyre zyrtare. Në këtë pikë duam të vlerësojmë qeverinë shqiptare e cila nuk ka hezituar ta publikojë raportin me rekomandimet e KPT-së së bashku me përgjigjen zyrtare të qeverisë shqiptare duke e bërë transparent këtë proces edhe për publikun e gjërë.

Gjatë monitorimit tonë për zbatimin e këtyre rekomandimeve nga ana e institucioneve përgjegjëse mund të themi me keqardhje se nga një pjesë e madhe e institucioneve mungon qartësia në kuptimin e detyrave që janë lënë në raportin e KPT-së. Institucionet shqiptare duhet të kuptojnë dhe përvetësojnë këto rekomandime duke i bërë ato pjesë të pandashme të filozofisë së tyre të punës. Kjo gjë mungon, pasi kuptohet edhe nga përgjigjet që ne kemi marrë nga institucionet përkatëse duke vërejtur se nuk kemi zbatim thelbësor, por zbatimi është krejtësisht formal. Duhet promovuar dhe mbajtur lart zbatimi i këtyre standardeve që rrjedhin nga rekomandimet e KPT-së.

Së fundi, MKPT-ja dëshiron të shprehë vlerësimin e saj për institucionet, të cilat kanë dhënë përgjigjet e tyre duke treguar qasje bashkëpunuese. Informacioni i dhënë tregon se nga shumica e institucioneve të monitoruara, janë ndërmarrë disa hapa lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KPT-së për të mbrojtur të drejtat e personave të privuar liria.

Avokati i Popullit kupton se ky është një proces dhe se ka nevojë thelbësore që standardet e vendosura të ruhen dhe kushtet të përmirësohen në vijimësi.

Gjejmë rastin të falenderojmë edhe Kuvendin e Shqipërisë dhe Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për mbështetjen e dhënë deri më tanë, dhe për vëmendjen që ka ndaj përmirësimit të kushteve të qëndrimit dhe jetesës së të privuarve nga liria.

## METODOLOGJIA

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datë 9.7.2020, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2019”<sup>6</sup>, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 130, datë 13 korrik 2020, Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020, i kërkon Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, të monitorojë zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe të raportojë në kohë pranë Kuvendit të Shqipërisë për nevojën e adresimit të problematikave të përsëritura ose për të cilat kërkon angazhim nga ana e tij.

Metodologjia e hartimit të këtij rapporti konsiston në studimin e Raportit të KPT-së dhe në vijim bërjen e tij pjesë të metodologjisë sonë të inspektimit në observim, në dokumentim, në komunikimet me shkresa dhe emaile, si dhe në takimet me zyrtarët e lartë të sistemit te burgjeve, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe sistemit shëndetësor, si dhe në inspektime e vazhdueshme pranë institucioneve të sistemeve të burgjeve, policor, si dhe të atyre shëndetësor. Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka nisur shkresat përkatëse me lëndë “Kërkesë për informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues”, drejtuar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. K4/M4-2 prot., datë 11.12.2020, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë (për dijeni Ministrisë së Brendshme) me shkresën nr. K4/M4-3 prot., datë 11.12.2020 dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve (për dijeni Ministrit të Drejtësisë) me shkresën nr. K4/M4-4 prot., datë 11.12.2020, ridërguar kërkesë e përsëritur me shkresën nr. K4/M4-7 prot., datë 19.02.2021.

Për sa më lart dhe në vijim të kérkesave të mësipërme bëjmë me dije se pas marrjes së përgjigjeve nga institucionet e mësipërme dhe mbi bazën e gjetjeve faktike kemi hartuar këtë raport të ndarë sipas seksioneve me gjetjet të ndara si në vijim:

- “a. Rekomandimet e KPT-së”<sup>7</sup>;
- “b. Përgjigja zyrtare”<sup>8</sup>;
- “c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës”;
- “d. Komentet e MKPT-së”.

Vlen për t'u përmendur se misionet e monitorimit janë realizuar në një fryshtë bashkëpunimi konstruktiv me zyrtarët e lartë të sistemit të burgjeve, Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë dhe sistemit shëndetësor, si dhe vet administratës së institucioneve të monitoruara. Një qasje e tillë

<sup>6</sup> shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/130/512f1dec-413f-4827-9b90-13740028038f>

<sup>7</sup> shih: <https://rm.coe.int/168097986b>. “Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019).

<sup>8</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

bashkëpunimi krijon kushte të favorshme për përmirësimin e situatës së të drejtave të personave që mbahen në institucionet e lartpërmendura, dhe ofron mundësi më të mira për plotësimin e standardeve ndërkombëtare dhe kombëtare, që përbëjnë dhe një detyrë të rëndësishme në kuadër të procesit të integrimit evropian të vendit tonë.

Si më poshtë vijon gjeni analizat ndarë në seksionet përkatëse:

## **SEKSIONI I**

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE/MINISTRIA E DREJTÉSISÉ**

#### **I.1 Keqtrajtimet**

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekomandon që hetimet në lidhje me pretendimet për keqtrajtim nga personeli i burgut duhet të kryhen nga një organ i cili është plotësish i pavarur nga sistemi i burgjeve.

##### **b. Përgjigja zyrtare**

Ndërkohë, përveç mekanizmave të inspektimit të brendshëm, pretendimet për keqtrajtim nga personeli i burgut verifikohen nga Avokati i Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar Kundër Torturës, Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje - një strukturë në varësi të Ministrit të Drejtësisë dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut siç është Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Rastet e pretenduara të keqtrajtimit nga administrata e burgut i drejtohen Prokurorisë, e cila nëse gjen shkelje vendos të fillojë hetime të mëtejshme për të verifikuar çështjen/çështjet. Gjatë vitit 2019 nuk kemi pasur asnjë rast keqtrajtimi në sistemin e burgjeve.<sup>9</sup>

##### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Sic evidentohet edhe në raportin e KPT-së, gjatë vizitës monitoruese delegacioni nuk mori asnjë pretendim keqtrajtimi fizik të të burgosurve nga ana e stafit, përkundrazi marrëdhënia personel

---

<sup>9</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 19.

burgu-të burgosur ishte relaksuese dhe pjesa më e madhe e të burgosurve të intervistuar është shprehur pozitivisht për mënyrën si stafi trajton të burgosurit.

Në referencë të rekomandimit konkret të KPT – hetimin e pretendimeve për keqtrajtim nga një organ tërësish i pavarur nga sistemi i burgjeve – kemi sqaruar në korrespondencën tonë se përvëç mekanizmave të brendshme të inspekimit, pretendimet për keqtrajtim nga personeli i burgjeve verifikohen nga Avokati i Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës, SHKBB, si dhe nga organizata të shoqërisë civile në vend, që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut, si Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj.. Mbrojtja, advokimi dhe monitorimi i respektimit të të drejtave të të burgosurve kryhet edhe nga mbrojtësit ligjorë të tyre.

Ndërkohë, çdo indicie e mundshme për keqtrajtim nga personeli vlerësohet në mënyrë të posaçme nga DPB, duke mos u kufizuar vetëm në parandalimin e dhunës dhe keqtrajtimit fizik, por edhe në aspekt të garantimit të sigurisë dinamike si komunikimi efektiv, mosdiskriminimi, trajtimi me eficencë dhe në kohë i çdo kërkese apo ankesë etj. Këto masa janë adresuar përmes udhëzimeve për IEVP dhe trajnimeve periodike të stafit<sup>10</sup>.

Gjatë periudhës 2019-2020 nuk kemi pasur raste keqtrajtimi në sistemin e burgjeve.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Rekomandimi i KPT-së për ngritjen e një organi të pavarur në lidhje me pretendimet për keqtrajtim nga personeli i burgjeve vlerësohet i **zbatuar**. Gjatë monitorimeve tona të vazhdueshme vërehet se procedura për vlerësimin e pretendimeve për keqtrajtim nga personeli i burgut kryhet nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Burgje (SHKBB) një institucion i cili është i pavarur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB). Ndërkohë që pretendime të tillë trajtohen edhe nga Avokati i Popullit përmes Mekanizmit Kombëtar Kundër Torturës ose Seksionit të Veçantë, si dhe nga organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

Rekomandimi i KPT-së për ngritjen e një organi i cili është plotësisht i pavarur nga sistemi i burgjeve për hetimin e këtyre pretendimeve, **është zbatuar**.

### **1.2 Kushtet në burgje**

#### **1.2.1 Mbi kushtet materiale e infrastrukturore**

##### **a. Rekomandim i KPT**

Mbi kushtet materiale e infrastrukturore, kërkohen të dhëna veçanërisht për:

---

<sup>10</sup> Shkresa 2019 ‘Mbi marrjen e masave kundër diskriminimit’ dhe trajnimet periodike të stafit.

- Situatën në objektet e observimit- veçimit në IEVP Fierit;
- A po ruhet standardi prej  $4m^2$  për çdo të burgosur në IEVP Durrës dhe si është gjendja e popullimit në këtë institucion;
- Situatën e akomodimit të të paraburgosurve në Godinën 'B' në IEVP Durrës, infrastrukturën, ofrimin e shërbimit nga personeli veçanërisht mjekësor, dhe gjendjen e popullimit;
- Informacion mbi gjendjen e popullimit në IEVP "Mine Peza";
- Lidhur me rinvimin e këtij institucioni (IEVP "Mine Peza"), është deklaruar se, është parashikuar në fondin e buxhetit për vitin 2020-2021 të kryhen punimet për rindërtimin dhe mirëmbajtjen e ndërtimeve fizike infrastruktura dhe punimet inxhinierike në këtë burg. Pjesë e rindërtimit do të jetë sistemi i ventilimit dhe rindërtimi i dritareve, në mënyrë që të krijohet qasja në dritën natyrore sipas standardeve. Për këtë çështje kërkon raportim mbi zbatimin e këtij projekti i cili ka qenë i parashikuar në fondin e buxhetit për vitin 2020-2021.

Në raportin e vitit 2017, KPT ka shprehur shqetësim serioz për kushtet materiale shumë të këqija në burgun e Sarandës. Fatkeqësisht, autoritetet Shqiptare nuk kanë mundur ta përmirësojnë këtë çështje. Në vizitën e fundit, për shkak të problemeve të mëdha strukturore të burgut të Sarandës, KPT ka nxitur autoritetet shqiptare që të mbyllin këtë burg sa më shpejtë të jetë e mundur. Në letrën e datës 16 Prill 2019 autoritetet Shqiptare dhanë informacionet: '*Është planifikuar një fond prej 5,000,000 Lek nga buxheti i shtetit për të ndërhyrë në 8 muajt e ardhshëm me investime të pjesshme, për të eliminuar problemin e lagështirës, për të zmadhuar hapësirën e dritareve dhe për të zgjatur hapësirën e ajrimit-probleme të identikuara në raport; Për të zgjidhur këto probleme është ndërmarrë një proces prokurimi. KPT mendon se kjo masë për përmirësimin e kushteve të jetesës së të paraburgosurve është e përkohshme, duke marrë parasysh urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë për mbylljen e këtij institucioni në të ardhmen e afërt.*'

KPT kërkon një informacion të përditësuar në lidhje me zbatimin e masave të përkohshme të sipërpërmendura për të përmirësuar kushtet e paraburgimit në Burgun e Sarandës dhe kohën e saktë për mbylljen e planifikuar të tij.

## b. Përgjigjja zyrtare

Situata në ambientet e observimit dhe izolimit në burgun e Fierit është përmirësuar, duke kryer hidroizolim dyshemeje dhe duke eliminuar lagështirën. Gjithashtu, është kryer dezinfektimi i të gjitha qelive të të burgosurve.

Dy ndërtesat e reja (ndërtesat 'B' dhe 'C') të ndërtuara në burgun "Jordan Misja" u vunë në funksion dhe u populluan në prill të vitit 2019.

- Ndërtesa 'C', me një kapacitet prej 40 personash, do të strehojë të burgosurit nën regjimin 41 bis.
- Godina 'B', me një kapacitet prej 176 personash, aktualisht strehon rrëth 140 të paraburgosur.

Kapaciteti akomodues në IEVP Durrës është 300 persona, ndërsa aktualisht strehon 298 të burgosur. Me uljen e numrit të të burgosurve në këtë burg, standardi është arritur hapësira prej  $4\text{m}^2$  për çdo të burgosur, një standard që do të mbahet nga administrata e burgut në të ardhmen.

Që prej shkurtit 2019, të dy katet e godinës 'B' në IEVP Durrës janë përshtatur pér të akomoduar të burgosurit dhe të paraburgosurit me probleme të shëndetit mendor në sistemin e burgjeve. Kapaciteti akomodues i kësaj godine është 60 persona dhe aktualisht ka 25 të burgosur në katin e parë të godinës dhe 33 të burgosur në katin e dytë. Referuar edhe rekomandimit të KPT-së pér IEVP-në Durrës, problemet e identifikuara janë eliminuar, duke mundësuar një shpërndarje proporcionale të të burgosurve në qeli dhe duke siguruar një standard prej  $4\text{m}^2$  pér çdo të burgosur.

Në IEVP-në "Mine Peza":

- shkalla e akomodimit në qeli është reduktuar pér të siguruar të paktën  $4\text{ m}^2$  të hapësirës së banimit pér person në shumicën e qelive (duke përjashtuar hapësirën e tualetit);
- dhomat në katin e parë stehojnë jo më shumë se 3 persona;
- qelitë në këtë burg duhet të ajrosen siç duhet.

Kapaciteti akomodues i burgut 'Mine Peza' është 166 persona, ndërkohë që aktualisht strehon 162 të paraburgosur (2% nën kapacitet). Duke ulur normën e akomodimit, një standard prej  $4\text{ m}^2$  është parashikuar pér çdo të paraburgosur, duke mundësuar që në dhomat e kosit të parë të akomodohen deri në 3 persona.

Lidhur me rinvimin e këtij institucioni është paraparë në fondin buxhetor pér vitin 2020-2021 pér kryerjen e punimeve pér rikonstruksion dhe mirëmbajtje fizike (ndërtimore) punimet infrastrukturore dhe inxhinierike në këtë burg. Pjesë e rindërtimit do të jetë dhe sistemi i ventilimit dhe rikonstruksioni i dritareve, pér të krijuar akses në dritën natyrale sipas standardeve.<sup>11</sup>

Pas informacionit të dhënë prej nesh nëpërmjet shkresës së datës 16.04.2019, Burgu i Sarandës është nënshtruar një rikonstruksioni të plotë, proces që përfundoi në tetor 2019.<sup>12</sup>

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

Në ambientet e observimit dhe veçimit në **IEVP Fier** janë kryer ndërhyrje të vazhdueshme pér të reduktuar lagështirën në këto ambiente. Gjithsesi, evidentojmë se pavarësisht ndërhyrjeve kjo

<sup>11</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 19-21.

<sup>12</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 21-22.

**problematikë mbetet ekzistente për shkak të vendndodhjes së kësaj IEVP-je, e cila është ndërtuar mbi një tokë që më parë ka qenë moçalishte.**

Nisur nga konstatimi i ekzistencës së lagështirës së vazhdueshme në themelet e godinave të banimit të të burgosurve në IEVP Fier dhe rekomandimin e KPT për marrjen e masave për eliminimin e lagështirës në këtë IEVP, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve realiste dhe eficiente për rekuperimin në maksimumin e mundshëm të lagështirës në përafrim të standardeve të kërkua të kemi **nxjerrë një urdhër<sup>13</sup> për ngritjen e një grupi pune për kryerjen e një vlerësimi teknik mbi situatën e lagështirës në godinat e banimit të të burgosurve në IEVP Fier**. Në përfundim të vlerësimit, Grupi i punës i ngritur ka propozuar këto alternativa:

1. Referuar informacionit të marrë nga stafi i IEVP Fier (nëpërmjet një studimi gjeologjik të zonës realizuar më Maj 2018) mbi nivelin e ujërave nëntokësorë të kësaj zone i cili varion nga +0m deri në -5m nën sipërfaqe, rekomandohet hapja e një pusi shfrytëzimi i të cilit për nevojat e institucionit do të ulë nivelin e ujërave nëntokësorë me 2,3–3m, duke shmangur kontaktin me themelet e godinave. Gjithashtu ndërtimi i këtij pusi do të ulte kostot e furnizimit më ujë nga rrjeti i ujësjellësit Bashkia Fier dhe duke bere të mundur që brenda një periudhe dy vjeçare të merret mbrapsht investimi që do të përdoret për realizimin e këtij pusi.
2. Alternativa e dytë është veshja e sipërfaqeve me prezencë lagështire që janë kryesishët në katet e para te godinave me pllaka plastike në lartësi 1m ose me pllaka karton xhes cimentato. Ky version ka kosto më të ulët por pa bere të mundur largimin e prezencës së lagështirës, pra thjesht duke e mbuluar atë.

Aktualisht Drejtoria e IEVP Fier, ka kryer disa riparime të defekteve, por problemi nuk është zgjidhur përfundimisht.

Kapaciteti akomodues i IEVP Durrës është 300 persona, ndërkohë aktualisht janë të akomoduar **263 të burgosur**. Me uljen e numrit të të burgosurve në këtë IEVP është arritur standardi i hapësirës  $4m^2$  për çdo të burgosur, standard i cili do të mbahet edhe në vijim nga administrata e burgjeve.

Prej muajit Shkurt 2019, të dy katet e godinës ‘B’ në IEVP Durrës janë **përshtatur për akomodimin e të dënuarve e të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor** të sistemit të burgjeve. Kapaciteti akomodues i kësaj godine është **60 persona** dhe aktualisht, në katin e parë të kësaj godine gjenden të akomoduar **25 të burgosur**, ndërsa në katin e dytë **33 të burgosur** të kësaj kategorie.

Në referencë edhe të rekomandimit të KPT-së për IEVP Durrës, problematika e konstatuar është eliminuar, duke mundësuar një shpërndarje proporcionale të të burgosurve në qeli dhe duke siguruar standardin  $4m^2$  për çdo të burgosur.

---

<sup>13</sup> Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm nr.2430 prot, datë 05.03.2021

Kapaciteti akomodues i IEVP “Mine Peza” është 166 persona, ndërkojë aktualisht janë të akomoduar 166 të paraburgosur. Institucioni nuk ka mbipopullim, si rezultat është siguruar standardi  $4\text{m}^2$  për çdo të paraburgosur, duke bërë të mundur gjithashtu, që dhomat në katin e parë të akomodojnë deri në 3 persona. Sa i përket rinoimit të këtij institucioni është parashikuar në fondin buxhetor për periudhën 2020-2023 kryerja e punimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike (ndërtimore), hidroizolimin e tarracës dhe rikonstruksionin e plotë të rrjetit elektrik në këtë institucion. Pjesë e rikonstruksionit do të jetë edhe sistemi i ventilimit dhe rikonstruksioni i dritareve, me qëllim krijimin e aksesit në dritën në natyrale, sipas standardeve.

Fondi i plotë buxhetor i parashikuar për rikonstruksionin e kësaj IEVP-je është:

- 3.600.000 lekë për rikonstruksionin e rrjetit elektrik
- 1.000.000 lekë për hidroizolimin e tarracës
- 400.000 lekë për ventilimin

#### **Për vendosjen e dritareve të reja në këtë IEVP fondi do të alokohet nga projekte të tjera.**

Në IEVP Sarandë është kryer rikonstruksioni i plotë i ambienteve në regjimin e brendshëm me vlerë 3.328.882 lekë (me tvsh). Me këtë investim kushtet e banimit në këtë IEVP janë përmirësuar ndjeshëm.

#### **c. Gjetjet e MKPT**

**Ende nuk ka gjetur zgjidhje** përfundimtare situata e lagështirës në IEVP Fier, për këtë arsyë është ngritur grapi i punës më datë 5 Mars 2021. Nga monitorimet e kryera nga MKPT në godinën A, kryesisht në ambientet në katin e parë të kësaj godine, kishte ende një prezencë të lagështirës në disa dhoma (*Kushtet materiale, ambienti i dusheve në veçim dhe observim ishin tërësisht të amortizuara*), pavarësisht ndërhyrjeve të pjesshme të herë pas hershme me fondet e institucionit për rikonstruksionin e këtyre ambienteve dhe për shkarkimin e ujërave nëpërmjet kanalizimeve që ndodhen në rrethimin e jashtëm të institucionit, ku situata përsëritez sidomos në periudhën e shirave. Situata e lagështirës nuk ishte e krijuar për shkak të dëmtimeve në rrjetin hidraulik të institucionit, por që në fazën e zbatimit të projektit të ndërtimit të IEVP-së, i cili është ndërtuar në një zonë moçalishte dhe me ujë. Për këtë arsyë kemi rekomanduar që të vijojnë të merren masa, për eliminimin e plotë të lagështirës në godinën A, ku prezenca e lagështirës është më dominuese.

Për sa i përket situatës së paraqitur në IEVP Durrës gjatë monitorimit të fundit të kryer më 01.09.2021 kemi konstatuar që kjo situatë jo vetëm që nuk është përmirësuar por madje është në gjendje shqetësuese.

Kemi konstatuar **mbipopullim<sup>14</sup>** kryesisht në muajt e fundit, por ajo që është e rëndësishme është se ky mbipopullim **shoqërohej me fjetjen në tokë** të këtyre personave, duke sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues, shqetësim ky që është adresuar edhe në rekomandimet tona të mëparshme, bazuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.<sup>15</sup> Në monitorimin e fundit e kryer në vitin 2021 në IEVP Durrës për shkak të mbipopullimit të muajve të fundit **ishin krijuar diferencime** pasi që në disa dhoma banimi ishin shtuar sfungjera ku flinin në tokë të burgosurit.

Kjo situatë kishte sjellë për pasojë që numri i personave të akomoduar në dhoma ishte më shumë se norma minimale të hapësirës për person, pasi IEVP Durrës kishte akomoduar persona mbi kapacitetin e parashikuar për të. Për këtë arsy kemi rekomanduar marrjen e masave të menjëherëshme për uljen e numrit të përgjithshëm të të burgosurve që vuajnë dënimin në institucionin IEVP Durrës, pasi ky **mbipopullim** kryesisht në muajt e fundit është shoqëruar **me fjetjen në tokë** të këtyre personave, gjë që ka sjellë për pasojë një trajtim çnjerëzor e degradues të tyre. Gjithashtu kemi kërkuar marrjen e masave të menjëherëshme **për rishpérndarjen e të dënuarve në mënyrë proporcionale** duke respektuar standarde minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorë të caktuar. IEVP Durrës, kishte një sektor të kujdesit të veçantë (SKV) të vendosur në një godinë më vete (Godina B), për trajtimin dhe diagnostikimin e personave të dënuar/paraburgosur me probleme të shëndetit mendor, por në momentin e inspektimit edhe në këtë sektor kishte mbipopullim.<sup>16</sup>

Përsa i përket situatës së paraqitur në IEVP “Mine Peza”, është alokuar fondi për periudhën 2020-2023 i cili parashikon për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës fizike (ndërtimore), hidroizolimin e tarracës dhe rikonstruksionin e plotë të rrjetit elektrik në këtë institucion. Pjesë e rikonstruksionit do të jetë edhe sistemi i ventilimit dhe rikonstruksioni i dritareve, me qëllim krijimin e aksesit në dritën në natyrale, sipas standardeve. Mirëpo për vendosjen e dritareve të reja fondi do të alokohet nga projekte të reja për të cilat nuk ka ndonjë informacion më të detajuar, dhe konkretisht nuk është kryer ende asnje investim.

**Mbipopullimi në dhoma nisur nga standarde kombëtare për respektimin e hapësirës jetike për person**, ishte prezent pothuajse në të gjitha dhomat e vuajtjes të dënit. **KPT kërkon konfirmim se norma e akomodimit në qeli, në burgun “Mine Peza” 302 është ulur, për të siguruar së paku 4m<sup>2</sup> hapësirë jetese për person në pjesën më të madhe të qelive (pa përfshirë hapësirën e tualetit).**

---

<sup>14</sup> Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit- Viti 2021. Shih Anex & Konsulto: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20verpimtaris%C3%A9%C2%80%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%AB%20vitin%202021.pdf>

<sup>15</sup> Vendimi Nr.437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, Neni 30 parashikon se: “Në vendosjen e të paraburgosurve apo të të dënuarve mbahen parasysh kushtet dhe mundësítë konkrete të çdo IEVP-je, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m<sup>2</sup> për çdo person të paraburgosur apo të dënuar, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar”.

<sup>16</sup><https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Final%20Inspektim%20IEVP%20Durrës.pdf>

Pjesa më e madhe e 11 qelive në katin e parë të godinës ishin më pak se  $3m^2$  sipërfaqe për person. Rekomandimi i KPT tregon qartë se kapacitetet e institucionit nuk respektojnë hapësirën jetike për person si dhe kushtet minimale të jetesës. **Nga inspektimi i dhomave të banimit konstatuam se nevojitet rishpérndarja e të paraburgosurve në mënyrë proporcionale**, duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorë të caktuar si në: Kati i 3 dhoma nr.1 si dhe rishpérndarja e të paraburgosurve në të treja katet ku ka dhoma me 2 banorë dhe ka dhoma me 4 banorë.

Për këto arsyen Avokati i Popullit ka rekomanduar marrjen e masave të menjëherëshme për rishpérndarjen e të dënuarve në mënyrë proporcionale duke respektuar standardet minimale të hapësirës dhe duke shfrytëzuar kapacitetet e institucionit, për të shmangur mbipopullimin e krijuar në sektorë të caktuar në IEVP “Mine Peza” 302 Tiranë.

Për sa më sipër rekomandimi nuk është realizuar në pjesën më të madhe të tij.

**Për sa i përket kushteve në IEVP Sarandë, institucioni ynë ka kërkuar në vazhdimësi** “Mylljen e menjëherëshme të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë, pasi me gjithë rekomandimet e Avokatit të Popullit për kryerjen e rikonstrukzionit të plotë të godinës të këtij institucioni, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ligjin nr.8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, në këtë institucion edhe pse janë kryer punime vazhdojnë të mbahen dhe trajtohen persona të paraburgosur në kushte jo humane dhe degraduese”.

Konstatojmë si problematikë kryesore, varësinë e dyfishtë për administrimin e disa ambienteve që ndodheshin në territorin e këtij institucioni, atë të Komisariatit të Policisë Sarandë dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Sarandë. Kjo problematikë reflektohet në mungesën e menaxhimit, të miradministrimit dhe përgjegjësisë së këtyre institacioneve për rikonstrukzionin e këtyre ambienteve.

Për sa më lart, MKPT ka risjellë disa herë në vëmendjen e institacioneve përgjegjëse rekomandimin përmarrjen e masave të menjëherëshme për rikonstrukzionin e plotë të godinës së banimit të të paraburgosurve në IEVP Sarandë për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze, duke parashikuar përshtatjen e dhomave sipas kushteve për jetesë, zgjerimin e dritareve të dhomave përfutjen e ajrit dhe dritës natyrale (sipas kritereve teknike të sigurisë).

Ky rekomandim nuk ka gjetur ende zbatim<sup>17</sup>.

### **1.2.2 Kushtet në burgje (IEVP e Burrelit)**

#### **a. Rekomandim i KPT**

<sup>17</sup> Shih ANEX “Tabela me të dhënat përmbarës shtretërit e lirë në IEVP”.

KPT rekomandon që të ndërmerren hapa nga autoritetet shqiptare në IEVP e Burrelit për të sjellë kushtet e përgjithshme të paraburgimit në blloqet e akomodimit për të burgosurit e dënuar në një standard të pranueshëm. Kjo do të kërkojë kryerjen e një pune thelbësore të rinovimit që duhet të përfshijë gjithashtu masa për të zvogëluar lagështinë në qeli (p.sh. duke përmirësuar ventilimin e qelive, duke vendosur një sistem ngrohje plotësisht funksional etj.).

Më tej, Komiteti përsërit rekomandimin e tij që të merren hapa në Seksionin C për të siguruar që të gjitha qelitë të kenë qasje të përshtatshme në dritën natyrore. Kushtet në qelinë nr. 10 në seksionin C të burgut të Burrelit ishin ndër më të këqijat në të gjithë institucionin. KPT rekomandon që të ndërmerren hapa urgjentë për të korriguar këto deficite deri në përfundimin e punës së riparimit të qelisë, ajo duhet të jetë jashtë shërbimit.

### **b. Përgjigja zyrtare**

Jeni shprehur në raport se situata aktuale në këtë institucion është brenda standardeve të pranueshme të jetesës.

Problemi i lagështisë në qeli, veçanërisht në sektorët e sigurisë së lartë, është eliminuar plotësisht duke qenë se linja e vjetër e furnizimit me ujë të brendshëm (shkaku kryesor i lagështirës në regjim dhe në dhomat) më në fund është ndërprerë në këtë drejtim dhe në sajë të investimit të bërë nga DPB-ja, kjo linjë furnizimi me ujë të pijshëm është zëvendësuar me një të re.

Ky investim ka eliminuar plotësisht lagështinë në muret e dhomave të të dënuarve.

Në sektorët e sigurisë së lartë janë instaluar dushe me ujë të ngrohtë.

Aktualisht ngrohja e të dënuarve dhe të paraburgosurve mundësohet me ngrohje elektrike dhe ne nuk kemi asnjë shqetësim nga të burgosurit në këtë drejtim.

Institucioni është monitoruar nga Avokati i Popullit dhe Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, i cili vlerësoi përmirësimet e bëra në këtë IEVP në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës për të burgosurit.

Është bërë një ndërhyrje në seksionin 'C' dhe në qelinë në fjalë, duke eliminuar komplet lagështirën, lyerja e plotë e seksionit të ndalimit (seksioni 'C'), shtrimi i dyshemeja dhe higjiena e plotë e sektorit.

Për sa i përket aksesit më të madh në dritën natyrore, teknikisht nuk mund të arrihet në këtë fazë pa një rinovim të plotë të burgut.

Siq ju kemi informuar përmes letrës sonë të prillit 2019, ritheksojmë qëndrimin se edhe pse nuk ka asnë studim për shkallën e efektit të tij në shëndetin e të burgosurve ose një standard specifik në lidhje me ndriçimin artificial gjatë orëve të vona të natës, po shqyrtojmë opsjonet për zgjidhjen e çështjeve dhe përgatitjen e studimeve financiare për efektet e mundshme të opsiioneve në buxhetin e shtetit.

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Në PBA 2020-2023 është planifikuar fondi buxhetor për rikonstruksionin e IEVP Burrel, ku përfshihen:

- Rikonstruksioni i plotë i infrastrukturës fizike (godinave)
- Rikonstruksioni i plotë i rrjetit elektrik.
- Hidroizolimi i tarracës
- Rikonstruksioni i plotë i rrjetit të furnizimit me ujë.
- Rinovimi i sistemit të ngrohjes, rrjetit të shpërndarjes së ujit të ngrohte nga kaldaja në elementët ngrohës dhe garantimin e ujit të ngrohte për larje.

Sektori i sigurisë së lartë në IEVP Burrel (sektori B), në vitin 2021, është rikonstruktuar komplet me instalime, shtrime, tualete, suvatime etj.

Dhoma të veçanta që kanë patur dëmtime janë riparuar.

DPB është duke hartuar një masterplan të zhvillimit infrastrukturor, ku parashikon që ky burg të kthehet në muze dhe në reflektim të ndryshimeve të hartës së re gjyqësore, qendra e paraburgimit për prefekturën e Dibrës, të ngrihet në Peshkopi, ku do të jetë e vendosur edhe gjykata.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Për këtë rekomandim, përgjigja e DPB-së është se ka vetëm planifikim në PBA 2020-2023.

Një informacion deri diku kontradiktor, por që duket i vënë në lëvizje në vijim të shkresës sonë, duke qenë se grapi i punës (GP) është ngritur në datën që na është nisur përgjigjja, përkatësisht më datë 9 Mars 2021, i cili do të dalë me opsonet përkatëse pas vlerësimit të alternativave për reflektimin e këtij rekomandimi. Sjellim në vëmendje se detyrat e lëna janë bërë publike në Shtator 2019, dhe komunikimi i Qeverisë Shqiptare është bërë në Shkurt 2020.

Nga monitorimet e kryera nga institucioni i Avokatit të Popullit në IEVP Burrel ka rezultuar se në vijim të kërkesave të KPT-së dhe rekomandimeve të herë pas hershme të institucionit tonë për rikonstruksionin e IEVP Burrel, janë kryer riparime, mirëmbajtje, përpjekje për eliminimin e lagështirës dhe lyerje të dhomave të të dënuarve. Ndërkohë që është konstatuar se ndërtesa e kësaj IEVP-je, përveç se është e amortizuar, nuk i plotëson kushtet e përshtatshme higjenike e fizike për strehimin e të dënuarve sipas standardeve të përmbajtura në legjislacionin shqiptar por edhe ato të përcaktuar nga KPT. Sipas informacionit, gjatë viteve të fundit, në këtë IEVP janë bërë investime për eliminimin e lagështirës në të 3 sektorët në shumën 10.000.000 lekë. Pavarësisht investimeve, gjendja teknike e godinave të banimit vijon të jetë e amortizuar dhe lagështira të jetë prezente më së shumti në ambientet e katit të parë të godinave përkatësisht sektori A siguria e zakonshme. Për sa më lart ne kemi vijuar me rekomandimin për marrjen e masave për kryerjen sa

më parë të investimeve, riparimin dhe eliminimin e lagështirës në dhomat e banimit të të burgosurve.

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi mbetet ende punë për realizimin e tij.

### **1.2.3 *Kushtet në burgje* (ndriçimin e qelive gjatë natës në burgje)**

#### **a. Rekomandim i KPT**

KPT ka kërkuar që rregullat ekzistuese në lidhje me ndriçimin e qelive gjatë natës në burgje të rishikohen dhe të bëhet e mundur, të paktën, të zbehet ndriçimi artificial gjatë periudhave të gjumit. KPT rekomandon që rregulli i sipërpërmendur të hiqet pa humbur kohë.

#### **b. Përgjigja zyrtare**

Siq ju kemi informuar përmes letrës sonë të prillit 2019, ritheksojmë qëndrimin se edhe pse nuk ka asnjë studim për shkallën e efektit të tij në shëndetin e të burgosurve ose një standard specifik në lidhje me ndriçimin artificial gjatë orëve të vona të natës, po shqyrtojmë opsjonet për zgjidhjen e çështjeve dhe përgatitjen e studimeve financiare për efektet e mundshme të opsiioneve në buxhetin e shtetit.<sup>18</sup>

#### **d. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Të gjithë IEVP zbatojnë një udhëzues, që parashikon detyrat e punonjësve të policisë në çdo vendshërbimi, ku në regjimin e brendshëm, parashikohet një detyrë e përgjithshme që mos të lejohet fikja e drivate gjatë natës në dhomat e të burgosurve. Kjo masë është vendosur për arsyen madhore, që lidhen me mbrojtjen e jetës dhe të sigurisë së të burgosurve, veçanërisht për parandalimin e rasteve të vetëvrasjeve. Drita mundëson vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe pa pengesa nga ana e punonjësve të shërbimit, gjatë orëve të natës – proces i cili është krejt i domosdoshëm.

**Siq dihet në vitet e fundit janë ndërtuar disa burgje të reja me financim, projektim dhe zbatim nga BE (IEVP Fier, Berat, Shkodër etj.) dhe në fakt nuk është parashikuar në projekt reduktimi i ndriçimit gjatë natës në ambientet e banimit të të burgosurve.**

As standardet ndërkombëtare, nuk parashikojnë rregullime specifike lidhur me ndriçimin artificial gjatë orëve të natës në qelitë e të burgosurve. Kështu,

---

<sup>18</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 22.

- referuar standardeve minimale të Kombeve të Bashkuara (Rregullat e Nelson Mandelës) në rregullin 14, pika (b) parashikohet vetëm: ‘*Drita artificiale duhet të sigurohet e mjaftueshme që të burgosurit të lexojnë ose të punojnë pa dëmtime të shikimit.*’
- Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Evropës, mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve parashikon në rregullin 18.2, pika (b): ‘*Në mjediset ku të burgosurve u duhet të jetojnë, punojnë ose të rrinë së bashku ... (b) drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike ... .*’ Më tej rregulli 18.3 i këtij rekomandimi parashikon se kërkesat specifike minimale edhe në lidhje me këtë çështje parashikohen në legjislacionin vendas.

**Gjithsesi, nisur nga rekomandimin e KPT, kemi nxjerrë një urdhër<sup>19</sup> për ngritjen e një grupei pune për vlerësimin e opsiioneve të mundshme për reduktimin ndriçimit artificial gjatë orëve të vona të natës, në dhomat e banimit të të burgosurve. Grupi i punës do të vlerësojë efektet shëndetësore të ndriçimit artificial gjatë kohës së fjetjes, praktikat evropiane dhe do të propozojë alternativat e zgjidhjes bashkë me kostot relevante, afatet e zbatimit, si dhe nevojën e rishikimit të akteve nënligjore. Edhe për këtë vlerësim, i cili do të kryhet brenda datës 15 prill 2021, do t'i propozojmë Ministrisë së Drejtësisë të paktën dy alternativa të mundshme të zgjidhjes së kësaj problematike, duke hartuar për secilën raport tekniko–ekonomik (preventiv për kostot respektive financiare, sipas nevojës dhe nivelit të ndërhyrjes restauruese<sup>20</sup>). Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë, e kanë reflektuar këtë rekomandim në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, të miratuar me VKM Nr.209, datë 06.04.2022. Në nenin 29/, pika 5 parashikohet: “*Gjatë natës ndriçimi i mjediseve të banimit mbahet i fikur. Në rast se vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme, drita e mjedisit mund të mbahet e ndezur ose me ndriçim të zbehur*”. Pra ky rekomandim është zbatuar nga ana jonë.**

#### e. Gjetjet e MKPT

Një informacion i cili duket i vënë në lëvizje në vijim të shkresës sonë, duke qenë se grupei i punës është ngritur në datën që na është nisur përgjigjja, përkatësisht më datë 9 Mars 2021, i cili do të dalë me opsonet përkatëse pas vlerësimit të alternativave përfshirë reflektimin e këtij rekomandimi.

Në Vendimin nr. 209, datë 6.4.2022 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*” rezulton se, gjatë hartimit të Rregullores së re të Burgjeve është mbajtur në konsideratë rekomandimi i KPT-së, përkatësisht në parashikimet e nenit 20 “*Të drejtat e të*

---

<sup>19</sup> Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr.2546 prot. datë 09.03.2021.

<sup>20</sup> Bazuar në risqet përkatëse si psh risk për sigurinë apo risqe financiare etj.

*burgosurve*<sup>21</sup> dhe nenit 29 “*Veshjet, pajisjet e fjetjes dhe ndriçimi në mjediset e banimit*”<sup>22</sup> të saj. Megjithatë mbetemi në pritje të nxjerrjes së akteve nënligjore pér zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Ky rekomandim është i zbatuar.

### ***1.3 Regjimi***

#### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekomandon që të ndërmerren masa pér zhvillimin e aktivitete të organizuara jashtë-qelisë pér të paraburgosurit në blloqet e reja të akomodimit në IEVP Nr. 313.

#### **b. Përgjigjja zyrtare**

Ambientet në këtë Institucion janë përshtatur pér realizimin e arsimit dhe aktivitete fetare e sportive. Gjithashtu, në secilin sektor janë krijuar lehtësira të veçanta pér zhvillimin e aktiviteteve terapeutike dhe sociale.

Sipas praktikës, e cila është ndjekur prej vitesh në të gjithë sistemin e burgjeve, dyert e qelive mbahen të hapura gjatë muajve të verës (nga maji deri në tetor të çdo viti), pér shkak të temperaturave të larta. Pas tetorit, pér shkak të ndryshimeve klimatike, dera mbyllt përsëri.<sup>23</sup>

#### **c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës**

Situata e pandemisë e shkaktuar nga COVID-19 dhe masat e adresuara përmes protokollesh specifike pér të parandaluar pérhapjen e tij në sistemin e burgjeve kanë afektuar edhe zbatimin e aktiviteteve rehabilituese në sistemin e burgjeve. Nisur nga kjo situatë e jashtëzakonshme e COVID-19, prej muajit mars 2020 e në vijim, aktivitetet në grup në të cilat përfshihen kurset profesionale dhe programe të tjera edukative janë zhvilluar me pjesëmarrjen e një numri të kufizuar të burgosurish.

Gjithsesi, gjatë vitit 2020, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet në varësi:

---

<sup>21</sup> Paragrafi 1 shkronja c parashikon “*Gjatë qëndrimit në institucion, të burgosurit, me përjashtim kur parashikohet ndryshe pér kategori të veçanta, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë të drejtat, si më poshtë vijon: c) u sigurohet fjetje në krevat të veçantë me rroba fjetjeje, sipas kushteve klimaterike, si dhe ndriçim të përshtatshëm;*”

<sup>22</sup> Pikit 5 & 6 parashikojnë se: “5. Gjatë natës ndriçimi i mjediseve të banimit mbahet i fikur. Në rast se vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme, drita e mjedisit të banimit mund të mbahet e ndezur ose me ndriçim të zbehur. 6. Kuotat minimale pér ndriçimin caktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, sipas rekomandimeve të ministrisë përgjegjëse pér shëndetësinë”

<sup>23</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 24.

- kanë bashkëpunuar me Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional për zhvillimin e procesit të formimit profesional në IEVP. Kurset profesionale janë ofruar në 9 IEVP të cilat janë frekuentuar çdo muaj mesatarisht nga 351 të burgosur. Kurset e ofruara përfshijnë gjuhë e huaj (anglisht, italisht), picturë, pirografi, elektricist, hidraulik, turizëm, kuzhinë, berber, rrobaqepësi, punë me dru dhe saldaturë.
- një ndër komponentët bazë të punës ri-integruese që kryhet me personat me liri të kufizuar është aktivizimi i tyre në aktivitete punësimi. Të burgosurit janë aktivizuar në aktivitete punësimi, sipas mundësive që ofrojnë institucionet, kryesisht në funksionet mirëmbajtës, ndihmës kuzhинier, kopshtar, ndihmës në bibliotekë etj.. Për vitin 2020 janë punësuar mesatarisht në sistemin e burgjeve 542 të burgosur prej të cilëve 110 të paraburgosur.
- në zbatim të Ligjit 81/2020, DPB ka hartuar projekt-Vendimin “*Për rregullat e posaçme për organizimin e punësimit të të burgosurve, kushtet, kohëzgjatjen e punës dhe shpërblimin e saj*”. Kjo VKM ka për objekt përcaktimin e rregullave të posaçme për organizimin e punësimit të të burgosurve, kushtet, kohëzgjatjen e punës dhe shpërblimin e saj.
- gjithashtu, janë drejtuar shkresa zyrtare për disa nga shoqatat e biznesit në vend për të mbështetur të burgosurit gjatë burgimit dhe pas lirimit të tyre përmes projekteve të punësimit.
- për herë të parë në historinë e sistemit të burgjeve, në vitin 2019 është hapur website ‘Made in Prison Albania’<sup>24</sup>, përmes të cilit gratë dhe vajzat e dënuara eksposojnë dhe shesin punimet e tyre artistike “*hand-made*”
- në janar të vitit 2021 nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet DPB dhe shoqatës së biznesit ‘Pro-Eksport Albania’ për punësimin e të burgosurve, si edhe ndërmjetësimin me subjekte private biznesi për zbatimin e projekteve të punësimit në sistemin e burgjeve.
- në kuadër të adresimit të rasteve për riintegrim DPB ka adresuar kërkesa zyrtare pranë 27 bashkive në vend, duke referuar edhe të dhëna konkrete për 425 të burgosur në prag lirimi.
- një marrëveshje bashkëpunimi është lidhur me Bashkinë e Tiranës për të rritur mundësitet e ri-integrimit të personave me liri të kufizuar pas lirimit të tyre.
- në kuadër të programit të ‘TLAS’ të financuar nga BE është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me organizatat ‘ARSiS’ dhe ‘ASSIST ALBANIA’ për sigurimin e mbështetjes për 15 gra në prag lirimi me shërbime shëndetësore, psiko-sociale, mundësi arsimimi, punësimi, si dhe forcim i marrëdhënieve me familjen dhe komunitetin. Ndërkohë, ‘ARSiS’ do të mbështesë sistemin e burgjeve edhe me hartimin e një protokollit mbi mekanizmin e referimit të grave të dënuara për riintegrim pas lirimit.

### ***Bashkëpunimi ndërkombëtar***

<sup>24</sup><https://madeinprison.al/about-me/>

- **Këshilli i Evropës** që prej vitit 2017, po mbështet sistemin e burgjeve përmes Programi “Mbështetje horizontale për Ballkanin Perëndimor”. Përmes këtij programi u prezantua një modul për programet e rehabilitimit të të burgosurve që mbështeten ne teknikat e terapisë Konjitive-Biheviorale (CBT) dhe u organizuan disa trajnime të stafit. Moduli përfshinte programe të ndryshme, si: Programi i mendimit pro-social; Programi i menaxhimit të zemërimit, stresit, ankthit dhe depresionit dhe Shprehitë sociale.
- **Ambasada Amerikane** ka miratuar program i cili është në proces implementimi për të mbështetur DPB në fushën e trajnimeve me ekspertizë në çështje të forcimit të sigurisë, menaxhimit etj., dhe logistikës me pajisje profesionale për sigurinë dhe trajnimet.
- **Agjencitë Suedezë të Gjykatës, Prokurorisë, Policisë, Burgjeve dhe Shërbimit të Provës** po zbatojnë Projektin “Forcimi i kapaciteteve të agjencive shqiptare për zbatimin e ligjit për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të mitur - një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë, një bashkëpunim midis Shqipërisë dhe Suedisë”. Nga ky projekt është ofruar mbështetje për zhvillimin e mjeteve / formave / modeleve për rritjen e specializimin e stafit në drejtësinë për të mitur (instrument vlerësimi i rrezikut dhe nevojave, intervistimi motivues dhe modeli i komunikimit për zgjidhjen e problemeve); Trajnimin e stafit multidisiplinar që punon me të miturit; zhvillimin e kurrikulës së trajnimit të stafit që punon me të miturit, si dhe zhvillimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional në çështjet e drejtësisë penale për të miturit. Në lidhje me komponentin e burgjeve ky projekt është fokusuar në disa objektiva: zhvillimin e një mekanizmi për vlerësimin e riskut dhe nevojës (YRNAs) dhe modelin e trajtimit individual (PIT) me manualin përkatës “Udhëzuesi i Përdoruesit”. Mjetet e përgatitura bazohen në mjetet/procedurat ekzistuese brenda DPB, por me një theks të fortë në qasjen e individualizuar, e cila përcaktohet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Me mbështetjen e projektit suzedez është hartuar instrumenti i vlerësimit të riskut dhe nevojave për recidivizëm dhe planifikimin e dënimit tek kategoria e të miturve në sistemin e burgjeve.
- **OSBE** mbështet sistemin e burgjeve me një projekt për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje, projekt që zgjati për periudhën 2017-2020. Drejtimet kryesore të projektit kishin në fokus kryerjen e një studimi vlerësimi mbi situatën e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në sistemin e burgjeve shqiptare, hartimin e një manuali mbi menaxhimin e të dënuarve për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizëm në sistemin e burgjeve, trajnimin e stafeve multidisiplinare mbi zbatimin e këtij manuali, si dhe hartimin e një instrumenti vlerësimi të riskut për të dënuarit për ekstremizëm të dhunshëm dhe radikalizëm në burgje.
- Komiteti Holandez i Helsinkit është duke vijuar me mbështetjen për ngritjen dhe zhvillimin e Qendrës së Trajnimeve në DPB.

#### d. Gjetjet e MKPT

Gjatë inspektimit të kryer nga Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar, në I.E.V.P “Jordan Misja” Tiranë, më datë 17.05.2021, është theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të myllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se “*regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelize të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror*”.<sup>25</sup>

Ndër rekomandimet e lëna për institucionin kanë qenë edhe:

- *Marrja e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.*
- *Marrja e masave për shtimin e aktiviteteve dhe takimeve me të paraburgosurit/dënuarit dhe në veçanti për 18-21 vjeçarët për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktivitete edukative e social-kulturore-sportive.*
- *Marrja e masave për krijimin dhe vënien në funksionim të ambienteve për ushtrimin e riteve fetare të fesë krishtere në ambientet e godinës “B”.*
- *Marrja e masave për plotësimin e ambienteve të palestrave me bazë materiale në ambientet e Institucionit të I.E.V.P, “Jordan Misja” Tiranë.*
- *Marrja e masave për krijimin e kushteve në seksionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në I.E.V.P, “Jordan Misja” Tiranë, (i ashtuquajturi 41-bis) në kuadrin e ndryshimeve ligjore, në mënyrë që të paraburgosurit që do të akomodohen në këto ambiente të mos privohen nga aktivitet sportive, kulturore, krijuese, shërbimi bibliotekar, veprimtari që i shërbejnë edhe rehabilitimit/riintegrimit të të burgosurit.*

Gjithashtu, lidhur me këtë rekomandim, risi është miratimi i VKM nr.602, datë 13.10.2021, “*Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj*”, i cili ka për objekt të tij përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin për punën e kryer.

Në lidhje me aktivitetet për shkak dhe të situatës së Covid-19 që prej muajit mars 2020 aktivitetet në grup janë zhvilluar në numër të kufizuar. Në IEVP “Jordan Misja” kishte palestër, klasa dhe dhoma këshillimi sipas sektorëve. Palestra ishte pajisur me mjete të pajisura nga institucioni, si dhe vegla për ushtrimin e forcës të sjella nga vetë të paraburgosurit. Ushtrimi në palestër dhe orari i ajrimit, ishin aktivitetet kryesore që zhvillonin të paraburgosurit, pasi aktivitetet kulturore dhe sportive masive nuk zhvilloheshin për shkak të masave anti COVID-19 në fuqi, por edhe për shkak të mungesës së infrastrukturës në institucion. Gjatë periudhës së pandemisë edhe palestrat në shumicën e kohës kanë qenë të myllura, për shkak të masave kufizuese. Shumë prej të

<sup>25</sup> *Rregullat Evropiane të Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; Konsulto: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>*

intervistuarve nëpër dhoma të pyetur për aktivitetet apo programet që ata marrin pjesë, kërkuan që për shkak të lirimtë masave kufizuese për pandeminë, të kenë më shumë aktivitete të përbashkëta edukative ose sportive. Aktivitetet që zhvillohen, konsistonin në organizimin e festave me rastin e datave të rëndësishme festive ose fetare. Në ambientin e kultit nuk lejoheshin të mblidheshin praktikuesit e fesë myslimanë dhe besimtarët protestantë, me qëllim që ata të praktikonin ritet e tyre fetare, për shkak të masave kufizuese. Por, për muajin e ramazanit, institucionit kishte hartuar një program të veçantë me aktivitete për besimtarët mysliman, si dhe kishte kryer gatime në kuzhinën e institucionit, sipas riteve të tyre. Bibliotekat e institucionit gjendeshin në çdo zyrë këshillimi dhe në momentin e inspektimit ato nuk ishin të pajisur me libra të rinj. Librat ishin pjesë e inventarit të bibliotekës të cilët viheshin në dispozicion të të paraburgosurve apo të dënuarve për lexim sipas kérkesave. Aktualisht kishte 8(tetë) klasa që përdoreshin si klasa edukimi në të dy godinat, ku ndodheshin raftet me libra të ndryshëm. Biblioteka, kishte një numër të konsiderueshme librash, por që nuk i përmblushin të gjitha kérkesat që kishin të paraburgosurit. Të paraburgosurit e regjistruar në bibliotekë, kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kérkesave, megjithëse numri i të regjistruarve ishte shumë i kufizuar. Në takimin që Avokati i Popullit zhvilloi me Drejtoren e Përgjithshëm të Burgjeve në muajin Maj 2021, u informuam se IEVP 313 “Jordan Misja”, ka patur një furnizim me libra të rinj për të paraburgosurit e këtij institucioni, në veçanti për të paraburgosurit që janë vendosur në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë.

Rregullorja e Regjimit të Posaçëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 380/2019, është integruar në Rregulloren e Përgjithshme, të miratuar me VKM nr.209, datë 06.04.2022.

Kjo irregullore ka pësuar disa ndryshime lidhur me të drejtat e shtetasve subjekt të këtij ligji që vendosen në regjimin e posaçëm, ku ndërmjet të tjerave është parashikuar lejimi i një televizori në dhomat e të dënuarve, me kanale të reduktuara.

Gjithashtu janë miratuar planet individuale të trajtimit, që kanë të bëjnë me vlerësimin e nevojave dhe risqeve dhe zbatimi i aktiviteteve edukative dhe relaksuese.

Për sa më lart institucioni ynë në lidhje me këto problematika të ngritura ka rekomanduar<sup>26</sup> ndër të tjera:

- *Marrjen e masave të menjëherëshme, për shtimin e aktivitetave dhe takimeve me të paraburgosurit për qëllime rehabilitimi, këshillimi, ri-integrimi, si edhe aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive.*

---

<sup>26</sup> Rekomandim i Avokatit të Popullit nr.K4/A4-5 prot., datë 23.09.2020 drejtar Ministrat të Drejtësisë dhe Drejtore të Përgjithshëm të Burgjeve. Konsulo:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Varianti%20final%20regjimi%2041%20biss%20mkpt.pdf>

- *Marrjen e masave të nevojshme, për vënien në funksionim dhe plotësimin e ambienteve të palestrave me bazën materiale të nevojshme, me qëllim shfrytëzimin e tyre nga të paraburgosurit, brenda orarit dhe grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit.*
- *Marrjen e masave për shtimin e të paktën një kompjuteri në ambientin ku zhvillohen takimet online, si dhe të shtohet për të paraburgosurit minutazhi i takimeve online me familjarët e tyre.*
- *Marrjen e masave të menjëherëshme, për kompletimin me libra të rinj të bibliotekave që ndodhen në regjimin e brendshëm, kryesisht asaj që ndodhet në regjimin e posaçëm të sigurisë së lartë, si dhe nxitjen e të paraburgosurve për interesimin ndaj leximit të librave.*
- *Marrjen e masave për krijimin e kushteve në sektionin e posaçëm të regjimit të sigurisë së lartë në IEVP “Jordan Misja” Tiranë, (i ashtuquajturi 41-bis) në kuadër të miratimit të paketës ligjore për sistemin penitenciar, në përputhje me nenin 17 i ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe rekomandimit të Avokatit të Popullit, me fokus garantimin e të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve në regjimin e posaçëm, në mënyrë që të burgosurit që do të akomodohen në këto ambiente **të mos privohen nga aktivitetet sportive, kulturore, krijuese, shërbimi bibliotekar, veprimtari që i shërbejnë edhe rehabilitimit/riintegrimit të të burgosurit**, si dhe mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së tyre, duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të paraburgosurve.*

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

### **1.3.1 E drejta për vizitë për personat e mbajtur në regjimin 41 bis**

#### **a. Rekomandim i KPT**

Në lidhje me të drejtën për vizitë për personat e mbajtur në regjimin 41 bis është shumë kufizuese dhe duhet të rritet ndjeshëm. Të burgosurve duhet t'u lejohet të bëjnë një bisedë telefonike çdo muaj, pavarësisht nëse ata bëjnë një takim gjatë të njëjtit muaj.

Komiteti gjithashtu kërkon informacion të detajuar mbi zbatimin praktik të regjimit të paraburgimit sipas Seksionit 13/1, veçanërisht në lidhje me numrin e të burgosurve që aktualisht i nënshtrohen këtij regjimi, aktivitetet jashtë qelisë në dispozicion dhe mundësitet që të burgosurit në fjalë të shoqëroheshin me të burgosur të tjerë të së njëjtës njësi.

Gjithashtu, në vijim të ndryshimeve të fundit ligjore kërkohet rishikimi i Rregullores të Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me urdhër nr. 380, datë 19.07.2019, të Ministrit të Drejtësisë.

#### **b. Përgjigjja zyrtare**

Qëllimi i ligjit nr.108/2018 (regjimi 41bis) është vendosja e një regjimi të veçantë për një kategori të të dënuarve dhe të paraburgosurve, me qëllim zbatimin e një mekanizmi kufizues mundësh për krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, organizate terroriste, grup i armatosur ose i strukturuar kriminal, ose për kryerjen e akteve me qëllime terroriste.

Vendosja e një regjimi të posaçëm në një burg të sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen rendit dhe sigurisë dhe/ose pengimin e komunikimit të të dënuarve me organizatat kriminale ku ata janë pjesë, ose me organizata të tjera, duke marrë masa të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, të lidhura kryesisht me nevojën për të parandaluar: a) kontaktet me organizata kriminale në të cilën janë pjesë ose me organizata të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë; b) konflikte të mundshme me elementë të organizatave të tjera; (c) ndërveprimin me të burgosurit ose të paraburgosurit e tjerë që i përkasin së njëjtës organizatë ose organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë; ç) komunikimi ose shkëmbimi i sendeve ndërmjet të dënuarve ose të paraburgosurve që i përkasin grupeve të ndryshme.

Subjektet potenciale të këtij ligji janë të dënuarit e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen ose gjykojnë për vepra të caktuara të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose vepra me qëllime terroriste.

Garancitë procedurale për zbatimin e regjimit 41-bis janë dhënë plotësisht, sepse:

- akomodimi në regjimin 41-bis kryhet vetëm kur ka të dhëna / informacione nga strukturat e posaçme të parashikuara me ligj - Drejtori i Përgjithshëm i Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe organet e specializuara në luftën kundër krimít të organizuar dhe terrorizmit sipas fushat e përgjegjësisë.
- vendimi për vendosjen e personit të dënuar ose të paraburgosurit në një regjim të veçantë në një burg të sigurisë së lartë merret nga Ministri i Drejtësisë, bazuar në kërkesën e arsyetuar e Prokurorit Special, pas konsultimit me Ministrin e Brendshëm.
- Vendimi i Ministrit të Drejtësisë për vendosjen e të dënuarit ose paraburgosurit në një regjim të veçantë në një burg të sigurisë së lartë mund të shqyrtohet nga Gjykata.

Regjimi i veçantë konsiston në:

a) lejimi i një takimi mujor familjar, i cili mbahet në intervale të rregullta dhe në të përcaktuara mqedise, që ndalojnë hyrjen e personave ose objekteve të tjerë dhe i nënshtrohet audios dhe regjistrim video. Termi "*familje*" nënkuption paraardhësit, pasardhësit, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit. Takimi me persona të tjerë përveç anëtarëve të familjes për të dënuarit personave lejohet me propozim të drejtorit të institucionit dhe me miratimin e Ministrit të

Drejtësisë. Për të paraburgosurit takime me persona të tjerë përveç anëtarëve të familjes lejohen vetëm me pëlqimin e prokurorit. Dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen për takimet me avokatët mbrojtës.

- b) lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk ka takime familjare të zhvillojë një bisedë telefonike në muaj, me një kohëzgjatje maksimale prej dhjetë minutash, të cilat do të regjistrohen. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ndërsa për të paraburgosurit autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Dispozitat e këtij paragrafi nuk zbatohen për bisedat telefonike me Institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata vendase ose të huaja që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut.
- c) ndalimi i përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe sendeve që i dënuari ose i paraburgosuri mund të marrë nga jashtë, siç parashikohet në rregulloren e brendshme të institucionit;
- d) kontrollin e korrespondencës, përveç me subjektet e përmendura në nenin 43 të këtij Ligji, ose me organizata ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
- e) reduktimin e qëndrimit në ajrosje, deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë.
- f) përjashtimin nga organet përfaqësuese të të dënuarve ose të paraburgosurve.

Me Urdhrin nr.380, datë 19.07.2019, Ministri i Drejtësisë ka miratuar Rregulloren e brendshme e Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimet Penale”.

Bazuar në dispozitat e kësaj rregulloreje:

- orari i ajrimit është 8 orë gjatë muajve të verës dhe 6 orë gjatë muajve të dimrit.
  - ventilimi dhe aktivitetet e përditshme kryhen individualisht. Përveç ajrimit, të burgosurit do të përfshihen në programe rehabilitimi që synojnë të ndryshojnë sjelljen kriminale, nëpërmjet programeve të rehabilitimit të ‘Futjes së të menduarit’ dhe ‘Aftësive Shoqërore’.
  - qëndrojnë në dhoma teke, me ndriçim, dritië artificiale, ngrohje dhe ventilim sipas standardeve evropiane, duke siguruar sipërfaqe jo më pak se  $6\text{ m}^2$  dhe një kubaturë prej  $9\text{ m}^3$ .
  - procedura e kërkesë-ankesave është e njëjtë si për të dënuarit e regjimeve të tjera të të burgosurve.
  - shërbimi shëndetësor është i garantuar si për të burgosurit e regjimeve të tjera, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në sistemin e burgjeve.
- Aktualisht nuk ka asnë të burgosur nën regjin 41 bis.<sup>27</sup>

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

<sup>27</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 17-19.

Në zbatim të ligjit nr.108/2018 “*Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve’*”, i ndryshuar<sup>28</sup>, Ministri i Drejtësisë miratoi Urdhrin nr. 8927/1 prot, datë 27.09.2018 “*Për klasifikimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, ndryshuar me Urdhrin Nr.381 datë 19.07.2019. Sipas këtij urdhri IEVP Peqin dhe IEVP ‘*Jordan Misja*’ u kategorizuan (respektivisht si burg dhe paraburgim) me një seksion për zbatimin e Regjimit të posaçëm 41 bis.

Rregullat për funksionimin e regjimit të posaçëm u miratuan me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.380, datë 19.07.2019 – për të cilat është vënë në dijeni edhe Institucioni i Avokatit të Popullit dhe DPB nuk ka marrë kontestime apo sugjerime lidhur me to.

Në lidhje me vizitat dhe bisedat telefonike për personat e mbajtur në regjimin 41 bis, ligji i ri nr. 81/2020 ‘*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*’ në nenin 17 ‘*Regjimi i posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë*’, pika 5/a/b ka parashikuar ndër të tjera të drejta dhe kufizime, konkretisht:

- lejimin e një takimi në muaj me anëtarë të familjes, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjetëse të caktuara;
- ndalimin e hyrjes së personave ose sendeve të tjera;
- vizitat i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video;
- takimi me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes, për personat e dënuar, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve;
- për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes lejohet vetëm me miratimin e prokurorit. Këto parashikime nuk zbatohen për takimet me mbrojtësit ligjor;
- lejimin e të burgosurit për kryerjen e një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet;
- kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve pas propozimit të drejtorit të institucionit, ndërsa për personat e paraburgosur autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e kësaj shkronje nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të ligjit 81/2020 u diskutuan edhe parashikimet në lidhje me këtë regjim.

---

<sup>28</sup> Aktualisht është miratuar ligji Nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve*”.

- ligji 108/2018 parashikonte kryerjen e një telefonate në muaj në rast se i burgosuri nuk kryen takime me familjen, ndërkokë
- ligji nr. 81/2020 e ka hequr këtë kusht, duke parashikuar mundësinë e kryerjes së një telefonate gjatë muajit edhe në rast se i burgosuri ka kryer takim me familjarët.

Procedura e miratimit të kryerjes së telefonatës nuk ka pësuar ndryshime, për të paraburgosurit miratimi kryhet me vendim të arsyetuar nga prokurori, ndërsa për të dënuarit miratimi kryhet me vendim (të arsyetuar) nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Natyrisht që DPB lidhur me komunikimet telefonike ka aplikuar rregullin sipas ligjit e jo kufizimin sipas rregullores – ndryshim, i cili do reflektohet në vijim edhe në rregullore.

Kjo, në referencë të rekomandimit të KPT, ndërsa takimet me familjarët për burgosurit e regjimit 41 bis lejohen vetëm një herë në muaj, ata lejohen të kryejnë bisedë telefonike me familjen një herë në muaj, pavarësisht nëse kanë kryer apo jo takim me familjen gjatë të njëjtit muaj.

Sa i përket zbatimit në praktikë të së drejtës dhe parashikimeve ligjore për telefonata dhe takime me familjarët të të burgosurve në regjimin 41 bis<sup>29</sup>, evidentojmë se DPB ka ndjekur rast pas rasti procedurat ligjore, duke miratuar për periudhën shtator 2020-shkurt 2021 si vijon:

- kryerjen e 6 telefonatave dhe 5 takimeve virtuale përmes komunikimit online me anëtar të familjes për të dënuarin G.B.;<sup>30</sup>
- kryerjen e 6 telefonatave dhe 3 takimeve virtuale përmes komunikimit online me anëtar të familjes për të dënuarin A.A.<sup>31</sup>. Gjithashtu ky i dënuar ka kryer edhe 2 takime virtuale me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes.<sup>32</sup>

Në korrik 2020 u vendosën në regjimin 41 bis në total 7 të burgosur (5 të paraburgosur në IEVP ‘Jordan Misja’ dhe 2 të dënuar në IEVP Pequin), me qëllim parandalimin e komunikimit, ndërveprimit dhe bashkëpunimit me organizata kriminale.

Sa i përket ankimimeve në gjykatë për vendimmarrjet për vënien në regjim të posaçëm të të burgosurve rezulton se vetëm 5 të burgosur kanë bërë ankim në Gjykatë. Gjykata ka rrëzuar secilën prej këtyre padive.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

---

<sup>29</sup> Ligji nr.81/2020 ‘Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve’, nenii 17 ‘Regjimi i posaçëm në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë’, pika 5/a/b: ‘Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve pas propozimit të drejtorit të institucionit ...’.

<sup>30</sup> Vendimet respektive të Drejtorit të Përgjithshëm: Nr.8781/1, datë 09.09.2020; Nr.10315/2, datë 14.10.2020; Nr.11308/1, datë 10.11.2020; Nr.12360/1, datë 10.12.2020; Nr.94/1, datë 08.01.2021; Nr.1286/1, datë 09.02.2021.

<sup>31</sup> Vendimet respektive të Drejtorit të Përgjithshëm: Nr.9318/2, datë 17.09.2020; Nr.10316/2, datë 14.10.2020; Nr.11721, datë 17.11.2020; Nr.12359, datë 10.12.2020; Nr.93/1, datë 08.01.2021; Nr. 1287, datë 09.02.2021.

<sup>32</sup> Referuar nenii 17 pika 5 gërrma ‘a’, të burgosurit e regjimit 41 bis kanë të drejtën e një takimi në muaj me anëtarët e familjes. Takimi me persona të ndryshëm nga anëtarët e familjes mund të lejohet kundrejt procedures: drejtori I IEVP propozon Drejtorit të Përgjithshëm lejimin e një takimi të tillë dhe më pas DPB vlerëson për miratim ose jo të këtij takimi

Në lidhje me rekomandimin e KPT-së nga DPB sqarohet se me ndryshimet legjislative dhe risitë që rrjedhimisht kanë sjellë është zbatuar takimi një herë në muaj bashkë me telefonatën një herë në muaj me kohëzgjatje maksimale 10 min e cila regjistrohet. Megjithatë nuk rezulton se bëhet i njëjtë trajtim edhe për të paraburgosurit, të cilëve e drejta e telefonatës ju miratohet paraprakisht nga Prokurori, ndryshe nga ajo për të dënuarit që miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, pas propozimit të Drejtorit të Institucionit (për të cilin na kanë vënë në dijeni se është miratuar dhe plani i zbatimit të tyre për periudhën shtator – shkurt). Nga monitorimet tona kushtet në lidhje me vizitat kanë rezultuar tepër kufizuese, në vijim është përcjellë nëpërmjet rekomandimit<sup>33</sup> marrja e masave të menjëherëshme, për ngritjen e një grapi pune për rishikimin e Rregullores të Regjimit të Posaçëm të Sigurisë së Lartë në IEVP, miratuar me Urdhrin nr.380, datë 19.07.2019 të Ministrit të Drejtësisë, e cila duhet të sqarojë, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore të qershorit 2020, të drejtat bazë, përgjegjësitë, kushtet e zbatimit dhe monitorimit të brendshëm të regjimit të posaçëm, si dhe garantimin e një sistemi efektiv ankimore.

Avokati i Popullit i ka adresuar edhe Ministrisë së Drejtësisë një rekomandim <sup>34</sup> lidhur me këtë çështje.

Për sa më lart, ky rekomandim i KPT-së **nuk është zbatuar**, pasi akoma nuk kemi një rishikim të kësaj rregulloreje.

## ***1.4 Kujdesi shëndetësor***

### ***1.4.1 Mungesat në mjekë***

#### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekomandon që të ndërmerren hapa për të sigruar praninë e rregullt të një mjeku të përgjithshëm në IEVP e Durrësit dhe për të rekrutuar të paktën një mjek të përgjithshëm me kohë të pjesshme në Burgun e Fierit. Më tej, Komiteti i bën thirrje edhe njëherë autoriteteve shqiptare për të rritur personelin me infermierë në Burgun Nr. 313. KPT kërkon përmirësim të vazhdueshëm në këtë fushë.

#### **b. Përgjigjja zyrtare**

Vërehet se organograma e personelit mjekësor të IEVP Durrës është i përbërë nga 5 (pesë) mjekë. Aktualisht dy prej tyre janë mjekë të përgjithshëm dhe dy specialistë mjekë (një psikiatër dhe një reumatolog) të caktuar me kohë të plotë. Në Burgun e Durrësit mungon vetëm një mjek.

<sup>33</sup> Rekomandim nr.K4/A4-5, datë 23.09.2020 drejtar Ministrit të Drejtësisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

<sup>34</sup><https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Varianti%20final%20regjimi%2041%20biss%20mkpt.pdf>

Organigrama e personelit mjekësor në IEVP Fier përbëhet nga dy mjekë. Aktualisht ka një mjek me kohë të plotë të punësuar. Vëmë re se emërimi i një mjeku me kohë të pjesshme është në proces.

Përsa i përket burgut “Jordan Misja”, theksojmë se kemi bërë një propozim për shtesë organike në këtë Institucion me 1 (një) mjek dhe 4 (katër) ndihmës mjekë.

Një nga problemet me të cilat përballemi ishte mungesa e personelit shëndetësor në sistemin e burgjeve dhe vështirësi në rekrutimin e tyre. Përmes shkresës nr. 2037 prot, datë 28.02.2019 kemi pasqyruar problemet e sistemit shëndetësor në sistemin e burgjeve dhe adresuar këto përpjekje për të përmbushur kujdesin shëndetësor të të burgosurve dhe rritjen e nivelit të tij, duke sugjeruar si zgjidhje të nevojshme:

- Domosdoshmërinë e ndryshimeve në Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Shëndetësisë për angazhimin e kësaj të fundit për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të të burgosurve nga sistemi mjekësor i shëndetit publik në disa burgje ku ka mungesë të personelit mjekësor - deri tani është e domosdoshme që kujdesi shëndetësor të ofrohet për të burgosurit nga strukturat e shëndetit publik ashtu siç është objektivisht e pamundur për t'u aksesuar nga sistemi shëndetësor i burgjeve.

Për të adresuar këtë situatë, ne kemi bërë parashikimin e duhur buxhetor për periudhën 2020- 2022, duke detauar jo vetëm si nevojë por si domosdoshmëri problemin e mungesës së mjekëve në sistemin e burgjeve.<sup>35</sup>

### c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës

Organika e stafit shëndetësor në IEVP Durrës ka të parashikuar 5 mjekë dhe aktualisht kjo organikë është plotësuar tërësisht me 2 mjekë të përgjithshëm me kohë të plotë, 1 mjek të përgjithshëm me kohë të pjesshme, 1 mjek psikiatër me kohë të plotë dhe 1 mjek specialist reumatolog me kohë të plotë.

Organika e stafit shëndetësor në IEVP Fier ka të parashikuar në organikë dy mjekë dhe aktualisht ajo është plotësuar me një mjek të përgjithshëm me kohë të plotë dhe një mjek me kohë të pjesshme.

Organika e stafit shëndetësor në IEVP ‘Jordan Misja’ është e plotësuar. Evidentojmë se DPB ka bërë propozime për shtim të stafit shëndetësor për këtë institucion, konkretisht me 1 mjek dhe 4 infermierë.

Përsa i përket rekrutimit të stafit shëndetësor në sistemin e burgjeve, evidentojmë se, DPB herë pas herë ka bërë shpallje on-line lidhur me rekrutimin e mjekëve, infermier, farmacist dhe

<sup>35</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 24-25.

stomatolog në sistemin e burgjeve, por rekrutimi i stafit shëndetësor e sidomos ai mjekësor ka qenë i vështirë për plotësimin e vendeve vakante. Megjithëse, gjatë muajit mars 2020 dhe në vazhdimësi nga DPB ka bërë shpallje on-line për stafin shëndetësor, e madje u shqyrtuan kërkesat e stafit shëndetësor të interesuar për punësim në sistemin e burgjeve të cilët u emëruan, por vazhdon të këtë mungesë të stafit shëndetësor në IEVP (mjekë, farmacistë, stomatologë dhe nd/mjekë).

Gjatë pandemisë COVID 19 në sistemin e burgjeve janë emëruar 22 staf shëndetësor, konkretisht:

10 nd/mjekë në IEVP Berat, Korçë, Fier, Krujë, Rrogozhinë, Vlorë, Korçë.

- 6 mjekë, prej të cilëve 3 part-time në IEVP Tepelenë, QSB dhe Fier dhe 3 full-time në IEVP Sarandë, “Mine Peza” dhe Durrës.
- 4 farmacistë në IEVP Peqin, Berat, QSB dhe “Ali Demi”
- 2 stomatologë në IEVP Rrogozhinë dhe Berat

Edhe me herët nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve është identifikuar se, shkaku i mungesës së interesimit të profesionistëve të fushës (mjekë specialistë e madje edhe mjekë të përgjithshëm) për t'u punëuar në sistemin e burgjeve, konsiston në faktin se, veç vështirësive specifike të punës në burgje, paga e tyre është më e ulët se e mjekëve në shërbimit shëndetësor publik, ndërkohë që edhe kjo e fundit mbetet e ulët.

Lidhur me këtë shqetësim DPB në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ka rishikuar klasifikimin e pagave të stafit të kujdesit shëndetësor në burgje e cila është definuar në dhjetor 2020<sup>36</sup>.

#### d. Gjetjet e MKPT

Përsa i përket rekrutimit të mjekëve kjo është një problematikë që për shkak të kushteve të papërshtatshme të punësimit nuk ka gjetur një zgjidhje adekuate. Mungesat në stafin mjekësor<sup>37</sup> është një problematikë që vijon të jetë ende e pranishme. Situata në tërësi ka nevojë si për shtimin e personelit të stafit mjekësor në organikë, ashtu edhe për plotësimin e vendeve vakante dhe pagesës. Shkaku i mungesës së interesimit të profesionistëve të fushës (mjekë specialistë e madje edhe mjekë të përgjithshëm) për t'u punëuar në sistemin e burgjeve, konsiston në faktin se, veç

<sup>36</sup> VKM nr.1076, datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin 555, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë se Shëndetësisë dhe njësisë mjekësore ushtareke pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e Forcave të Arsmatosura" të ndryshuar, ku përfshihet dhe stafi shëndetësor në IEVP dhe Spitalin përkatës, lidhja nr. 8 "Nivelet e pagave për personelin mjekësor dhe personelin teknik të shkencave mjekësore ne IEVP dhe Spitalin e Burgjeve"

<sup>37</sup> Konsulto ANEX "Tabela pasqyruese e shërbimit mjekësor në burgje sipas të dhënave të mbledhura gjatë inspektimeve të realizuara nga MKPT për vitin 2021".

vështirësive specifike të punës në burgje, paga e tyre është më e ulët se e mjekëve në shërbimin shëndetësor publik.

Lidhur me këtë shqetësim, DPB në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ka rishikuar klasifikimin e pagave të stafit të kujdesit shëndetësor në burgje e cila është definuar në dhjetor 2020.

Megjithatë gjatë monitorimeve tona në këto institucione vërehet se kjo problematikë ngelet akoma e pa zgjidhur. Në IEVP Durrës mungonte një mjek psikiatër me kohë të plotë<sup>38</sup>, ndërkohë që një mjek i përgjithshëm shërbente me kohë të pjesshme. Mbetet shqetësues fakti i mungesës së mjekëve në këtë institucion, çka shkakton shkeljen e drejtpërdrejtë të së drejtës për qasje te mjeku të personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë që interpretuar dhe nga qëndrimet e KPT-së ku parashikohet se: “*Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*” dhe se “*shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme*”.

Për sa më lart kemi rekomanduar marrjen e masave për **plotësimin e organikës** të stafit mjekësor me një mjek psikiatër dhe një mjek të përgjithshëm me kohë të plotë në IEVP Durrës.

Situata në IEVP Fier nuk paraqitej ndryshe. Personeli i shërbimit shëndetësor në këtë institucion, përbëhej nga 13 punonjës, 1(një) mjek i përgjithshëm, 1(një) farmacist, 1(një) mjek stomatolog dhe 10 (dhjetë) infermierë. Mjeku ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesshme dhe nuk punonte me kohë të plotë, ndërsa personeli tjetër shëndetësor ishte me kohë të plotë. Duke qenë se, IEVP Fier është një nga institucionet më të mëdha të sistemit penitecier në Shqipëri, **është e nevojshme plotësimi i organikës me mjek me kohë të plotë, si dhe për trajtimin akut të personave me probleme të shëndetit mendor, duhet të shtohet organika dhe me një mjek psikiatër**. Aktualisht, vizitat mjekësore të specializuara të pacientëve të sëmurë kronikë, trajtimi i rasteve emergjente, si dhe atyre me probleme të shëndetit mendor në IEVP Fier, kryhen pranë Spitalit Rajonal Fier dhe në IVSHB (Spitalin e Burgjeve) në Tiranë.

Në IEVP Fier u evidentuan të sëmurë që vuanin nga probleme të shëndetit mendor, gjithsej 37 persona prej të cilëve 16 të sëmurë ishin të shtruar në Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV). Personat të cilët vuajnë nga çrrëgullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të shtuar veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, në kushtet

<sup>38</sup> *Organika e Sektorit të Shëndetësisë është 17 punonjës, nga të cilët:*

2 Mjekë Psikiatër  
2 Mjekë të Përgjithshëm  
1 Mjek Stomatolog  
1 Kryeinfermier  
1 Farmacist  
10 Infermierë

kur në institucion mungon mjeku psikiatër. Në funksion të kësaj kategorie, institucioni kishte SKV, por ndaj tyre kërkohet të tregohet një vëmendje e veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku ata qëndrojnë, higjenës vetjake të tyre, si dhe të mjesdit që i rrethon.

Duke marrë shkas nga numri i lartë i të sëmurëve, specifika institucionale dhe dinamika e lartë e problematikave tek të paraburgosurit/dënuarit, lidhur me gjendjen e tyre emocionale apo problemet e mbartura gjatë vuajtjes së dënimit në një kohë relativisht të gjatë, prezenca e mjekut psikiatër në I.E.V.P Fier është e nevojshme dhe e domosdoshme, pasi ndihmon në parandalimin e rëndesës së gjendjes dhe shëndetit të tyre mendor. Për këto arsyе kemi rekomanduar marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin në organikë të pozicionit të mjekut me kohë të plotë në institucion, të mjekut psikiatër, specialistit psikolog etj.

Ndërsa personeli i kujdesit mjekësor në I.E.V.P. "Jordan Misja", Tiranë sipas organikës përbëhej nga 1(një) mjek, 1(një) farmacist, 1(një) stomatolog dhe 5 (pesë) infermierë. Mjeku aktual punonte me kohë të plotë në këtë institucion. Referuar organikës, mungesa konsistonin në 1 farmacist dhe 1 infermierë. Nga pikëpamja e organizimit të punës të sektorit shëndetësor, nuk ndihej mungesa e stafit, për arsyе edhe të transferimit të disa punonjësve dhe stafit nga IEVP "Vaqarr" pranë këtij institucioni. Stafi ishte i plotë dhe nuk kishte asnjë mungesa. Në përfundim të monitorimit tonë kemi rekomanduar ndër të tjera për marrjen e masave të nevojshme për plotësimin e organikës të institucionit me 1 farmacist, 1 infermier etj.

Rekomandimi është zbatuar në masë të ulët. Vlerësojmë se ka nevojë të merren masa të tjera emergjente për të siguruar ofrimin e shërbimit shëndetësor. Në Raportin e tij vjetor Avokati i Popullit ka paraqitur problematikën e tërë sistemit penitenciar.<sup>39</sup>

#### ***1.4.2 Dhënia e çdo shërbimi të kujdesit shëndetësor të burgjeve në vend me pajisje të tilla themelore për të shpëtuar jetën.***

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekomandon që të ndërmerren hapa për të dhënë çdo shërbim të kujdesit shëndetësor të burgjeve në vend me pajisje të tilla themelore për të shpëtuar jetën. Më tej, pajisjet e vjetruara dhe shumë të zhurmshme dentare në Burgun e Burrelit duhet të zëvendësohen.

##### **b. Përgjigjja zyrtare**

Në lidhje me këtë rekomandim:

<sup>39</sup> Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit- Viti 2021. Shih Anex & Konsulto:  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20verpimtaris%C3%A9%C2%A0%C2%80s%C3%AB%C2%20institucionit%20t%C3%AB%C2%AB%20AP%20p%C3%AB%20vitin%202021.pdf>

- në çdo institucion dhoma e infermierisë është e plotësuar me medikamentet e urgjencës.
- burgjet Reç-Shkodër, Peqin, Fier dhe Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve (Spitali i Burgut) janë plotësuar me elektrokardiograma (EKG).
- jemi në proces të furnizimit të institucioneve me pajisjen mjekësore “defibrilator”.
- gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 janë siguruar pajisje të reja dentare në burgjet e Burrelit, Tepelenës, Peqinit, Kavajës, Rrogozhinës dhe “Mine Peza”.<sup>40</sup>

### c. Përgjigja e Institutacionit përgjegjës

Lidhur me pajisjet mjekësore të IEVP-ve nga momenti i inspektimit të fundit të KPT, evidentojmë se:

- **IEVP Burrel është pajisur me kabinet të ri dentar** (poltron dhe autoklavë),
- **janë pajisur me kabinete të reja dentare 12 IEVP**, ku 6 prej tyre (IEVP Burrel, Tepelenë, ‘Mine Peza’, Peqin, Kavajë, Rrogozhinë) janë pajisur në shtator 2019 dhe 6 të tjera (IEVP Vlorë, Fier, Lushnjë, Durrës, Krujë, Berat) në nëntor të vitit 2020.

Gjithashtu, përveç kabinetave dentare, disa IEVP janë pajisur me pajisje të tjera mjekësore, konkretisht:

- IEVP Krujë me aparaturë mjekësore ECHO-grafi dhe defibrilator
- QSB me defibrilator
- 5 institucione me aparaturë EKG (IEVP Elbasan Durrës, Rrogozhinë, “Ali Demi”, “Jordan Misja”, Lezhë)
- të gjitha institucionet janë pajisur me oksimetër.

Në përgjigjen e qeverisë shqiptare për këtë rekomandim të KPT citohet se:

- në çdo institucion salla e infermierisë plotësohet me medikamentet e urgjencës.
- Burgu i Reçit, Peqinit, Fierit dhe QSUT (Spitali i Burgut) janë plotësuar me elektrokardiogramë (EKG).
- Jemi në proces të furnizimit të institucioneve me pajisjen mjekësore “defibrilator”.
- Gjatë gjashtëmujorit të dytë të 2019-ës janë siguruar pajisje të reja dentare për burgjet e Burrelit, Tepelenës, Peqinit, Kavajës, Rrogozhinës dhe “Mine Peza” 302 Tiranë.

---

<sup>40</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 25.

#### d. Gjetjet e MKPT

Nga monitorimet e kryera nga MKPT kemi konstatuar se ka pasur një përmirësim në kushtet e kabineteve dentare, siç ka ndodhur në IEVP Burrel dhe në I.E.V.P, "Mine Peza" 302 ku dhoma e stomatologut ishte e pajisur me poltron, sterilizues dhe unit dentar të ri. Në IEVP Fier shërbimi stomatologjik kishte filluar të funksiononte gjatë vitit 2021 si rezultat i plotësimit të bazës materiale. IEVP Elbasan ishte pajisur me kabinet stomatologjik me një poltron dentar. Në IEVP Fushë-Krujë dhoma e stomatologut ishte e pajisur me karrige, sterilizues, si dhe njësinë dentare të cilat ishin funksionale, sipas kërkesave të të burgosurve për vizitë apo kontroll mjekësor. Në IEVP Reç dhoma e stomatologut e pajisur me kabinetin e ri për kryerjen e vizitave dhe mbushjeve të dhëmbëve. IEVP Rrogosjinë ishte zbatuar rekomandimi për furnizimin e kabinetit të stomatologut me instrumente dhe materiale dentare, me qëllim ofrimin e një shërbimi stomatologjik cilësor dhe në kohë me ndërhyrjet përkatëse. Në IEVP Vlorë dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme. IEVP Shënkoll Lezhë dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme. Në IEVP Berat institucioni kishte marrë masa për kompletimin e dhomës së stomatologut dhe ishte e pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme. IEVP Kosovë, Lushnje dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Mirëpo ka akoma institucione të cilat ende ky shërbim nuk mbulohet nga vetë institucioni si në IEVP Sarandë ku të paraburgosurit ngritën si shqetësim dhe problematikën e ilaçeve që për efekt shpejtësie duhej t'i siguronin nga familjarët, sikurse nuk kishte as shërbim stomatologjik. Këto shërbime sipas rastit, trajtoheshin në spitalin rajonal të Sarandës. Në IEVP Tepelenë shërbimi stomatologjik nuk funksiononte normalisht si rezultat i mungesës së materialeve. Në IEVP Kukës shërbimi i stomatologjisë për të paraburgosurit mbulohej me shërbim në poliklinikën e qytetit të Kukësit ose në shërbim privat me rekomandimin e mjekut të institucionit. Për këto raste, Institucioni mbulonte shpenzimet e lëvizjes.

Nga monitorimet tona, mbetet ende problematike mungesa e pajisjes së këtyre institucioneve me autoambulancë. Në IEVP "Mine Peza" 302 Tiranë, IEVP Durrës, IEVP Vlorë IEVP Sarandë dhe IEVP Berat sërisht mungonin ambulancat, si pjesë e domosdoshme për shërbimin cilësor shëndetësor në kohë të shpejtë, për të shoqëruar personat në spitalet përkatëse të vendit, .

Ndërkohë që IEVP "Jordan Misja" 313 dhe IEVP Elbasan ishin pajisur e institucionit me **ambulancë** të re për shoqërimin e personave me probleme shëndetësore përvizita mjekësore pranë spitaleve rajonale apo në QSUT-së Tiranë, në përputhje me nevojat shëndetësore të të paraburgosurve.

Ky rekomandim është në proces zbatimi për sa i përket përmirësimit të pajisjeve mjekësore, i cili është një proces i vazhdueshëm.

### **1.4.3 Të burgosurit me probleme të shëndetit mendor**

#### **a. Rekomandim i KPT**

Në burgun nr. 302, delegacioni vuri re se receta e përgjithshme e diazepinave ishte mjaft e lartë. Në veçanti, u vërejt se, në muajt e fundit, mjeku i burgut shpesh përshkruante diazepam përmes injeksioneve intravenoze. Për më tepër, u duk se një infermiere mundet, pa përshkrimin e mjekut, të administrojë ose shpërndajë tek të burgosurit një gamë të gjerë ilaçesh, përfshirë diazepamin. KPT dëshiron të marrë komentet e autoriteteve shqiptare për këto çështje.

KPT rekomandon që autoritetet shqiptare të rishikojnë burimet e personelit të kujdesit shëndetësor në të gjitha burgjet që kanë një SKV, në dritën e vërejtjeve të mësipërme. Do të dëshironte gjithashtu të merrte një kopje të protokollit në lidhje me funksionimin e SKV-ve në burgje.

#### **b. Përgjigja zyrtare**

Është e vërtetë që ka pasur raste të personelit mjekësor që janë dhënë benzodiazepina por kjo është një ngërç i shkaktuar nga mungesa e mjekëve specialistë që i përshkruajnë ato.

Për sa i përket administrimit të Diazepam nga mjeku i institucionit, duhet marrë parasysh se ka një kontigjent njerëzish që vijnë ngajeta e lirë me këtë abuzim me substancë dhe është e vështirë të reduktohet menjëherë përdorimi i këtij medikamenti.

Lidhur me këtë rekomandim, vërejmë se janë marrë masa, duke iu përbajtur në mënyrë rigorozë përshkrimi i barnave nga ndihmësmjekët vetëm në përputhje me recetën e mjekët.

Aktualisht, edhe për shkak të rritjes së numrit të konsultimeve nga psikiatër, administrimi i benzodiazepinave është kufizuar shumë.<sup>41</sup>

#### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Qeveria shqiptare në përgjigjen e saj pranoi që ka pasur raste që personeli mjekësor ka dhënë benzodiazepina, por ky ishte një ngërç i shkaktuar nga mungesa e mjekëve specialistë që i përshkruajnë ato. Në lidhje me dhënien e Diazepam nga mjeku i institucionit, duhet pasur parasysh se ka një kontigjent njerëzish që vijnë ngajeta e lirë me abuzimin me këtë substancë dhe është e vështirë të reduktohet menjëherë përdorimi i tyre. Lidhur me këtë rekomandim, janë shprehur se janë marrë masa, duke respektuar me përpikëri përshkrimin e barnave nga ndihmës mjekët vetëm në përputhje me përshkrimin e mjekëve.

---

<sup>41</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 26.

Aktualisht, edhe për shkak të rritjes së numrit të konsultimeve nga psikiatër, administrimi i benzodiazepinave është kufizuar shumë.

Të gjithë të burgosurit me probleme të shëndetit mendor trajtohen konform ligjit 44/2018 “Për shëndetin mendor”, me të njëjtat standarde të strukturave të shëndetit publik, konsultohen nga mjekët psikiatër të sistemit të burgjeve dhe spitaleve rajonale dhe trajtohen sipas rekomandimeve të tyre. Përshkrimi i konsultave mjekësore dhe dokumentimi në kartelat klinike të të burgosurve është detyra themelore e mjekut.

Stafi mjekësor në IEVP është udhëzuar për procedurat e menaxhimit, disiplinimit dhe trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve<sup>42</sup>, si dhe mbi realizimin e ekzaminimeve mjekësor për të burgosurit<sup>43</sup>, sipas formave të regjistrave të kufizimit fizik dhe ushtrimit të dhunës.

Të burgosurit me probleme të shëndetit mendor janë të akomoduar në Sektor të Kujdesit të Veçantë, apo në dhoma të veçanta ku marrin një kujdes të veçantë jo vetëm shëndetësor, por edhe psiko-social, konkretisht:

- SKV janë krijuar dhe funksionojnë në IEVP Durrës, Fier, Shkodër, Peqin, Rrogozhinë, “Ali Demi”, “Jordan Misja”, Lezhë, Korçë.
- në IEVP “Mine Peza”, Lushnjë dhe Elbasan për shkak të numrit të ulët të tyre, por edhe për arsyet e infrastrukturës, akomodimi i tyre është bërë në dhoma të veçanta.

**Përkujdesja për verifikim në kohë dhe monitorim të vazhdueshëm ndaj të burgosurve me probleme të shëndetit mendor ka qenë specifike sidomos gjatë periudhës 2019-2020, konkretisht:**

- a. janë kryer analiza të hollësishme dhe verifikime në vend në çdo IEVP, në lidhje me:
  - raste të reja për të burgosur me probleme të shëndetit mendor
  - securinë, trajtimin dhe gjendjen shëndetësore të tyre
  - vlerësimin për nevoja të suportit shtesë shëndetësor edhe duke i transferuar në SKV të IEVP që kanë mjek psikiatër.
- b. për shkak edhe të mungesave në staf, por edhe për të inspektuar e vlerësuar punën e stafeve mjekësore në IEVP, në muajin nëntor 2019 kemi ngritur grup pune me mjekë specialistë nga DPB dhe QSB apo/dhe IEVP.
  - përgjatë muajve janar, maj dhe nëntor 2019, grupi i punës kreuz 160 vizita me të burgosurit në IEVP Fushe Krujë, Peqin, Shkodër, ‘Mine Peza’ dhe ‘Jordan Misja’

<sup>42</sup> Urdhëri nr. 2155 Prot, datë 27.02.2018, “Mbi menaxhimin dhe disiplinimin e procedurave të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve”

<sup>43</sup> Urdhëri nr. 1688/1 Prot, datë 04.02.2018 “Mbi realizimin e ekzaminimeve mjekësor për të burgosurit”

- nga vizitat e kryera rezultuan në total 322 të burgosur me probleme të shëndetit mendor, prej të cilëve:
  - 184 të dënuar të sigurisë së zakonshme, nga të cilët 31 ishin në gjendje më të axhituar, për rrjedhojë 27 prej tyre u transferuan në SKV e IEVP Durrës për të maksimizuar nevojat e tyre shëndetësore dhe psiko – sociale; duke qenë se në SKV Durrës kishte kapacitete për të akomoduar edhe 15 të dënuar të tjerë me probleme të shëndetit mendor, në maj 2019 u transferuan në SKV të IEVP Durrës edhe 15 të dënuar të sigurisë së zakonshme me probleme të shëndetit mendor me gjendje më të agravuar shëndetësore (axhituar)
  - 138 të dënuar të sigurisë së lartë, të cilët konsultohen në mënyrë periodike nga mjekët psikiatër të IEVP dhe spitaleve rajonale dhe trajtohen sipas rekomandimeve të tyre në SKV përkatëse apo në dhoma të veçanta (kur numri i tyre është i ulët).

Analiza e rasteve shërbeu për vlerësimin e mundësisë së transferimit të burgosurve me probleme të shëndetit mendor në SKV e IEVP Durrës, gjithmonë duke vlerësuar mundësitë dhe kapacitetet e këtij institucioni dhe rastet më problematike të IEVP, që janë siguri e zakonshme.

Si rezultat është kryer transferimi i të burgosurve me probleme të shëndetit mendor nga disa institucione për në IEVP Durrës, pasi ky institucion siç dihet ka SKV me staf mjekësor të plotësuar krahasimisht me IEVP e tjera - duke garantuar trajtimin më efikas të të burgosurve të kësaj kategorie.

Nga ana tjetër akomodimi i të burgosurve të evidentuar me probleme të shëndetit mendor në një IEVP me SKV do të shërbente jo vetëm për kujdesin shëndetësor dhe psiko-social, por edhe do të shërbente si një indikator pozitiv sa lidhet me trajtimin e tyre në mënyrë të padiferencuar dhe të specializuar për specifikat që u dikton sëmundja që ata kanë, do të krijojë mundësi për rehabilitim dhe trajtim të këtij kontingjenti sipas standardeve të të drejtave të njeriut dhe trajtimit të tyre.

c. Gjatë vitit 2020, pavarësisht situatës së pandemisë:

- është rritur numri i konsultave të specializuara dhe ekzaminimeve mjekësore në tërësi dhe atyre psikiatrike në veçanti, të kryera nga mjekët e sistemit të burgjeve, në bashkëpunim edhe me spitalet rajonale
- nga mjekë psikiatër të burgjeve janë kryer konsulta psikiatrike të të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, konkretisht:
  - në IEVP Peqin – 65 konsulta psikiatrike
  - në IEVP ‘Mine Peza’ – 61 konsulta psikiatrike
  - në IEVP ‘Jordan Misja’ – 103 konsulta psikiatrike

- në IEVP Krujë, Durrës dhe Qendrës Spitalore të Burgjeve janë kryer konsulta të vazhdueshme nga mjekët psikiatër me kohë të plotë të punësuar në këto IEVP
- po ashtu konsulta periodike psikiatrike janë zhvilluar në IEVP Korçë, Fier, “Ali Demi” ku ka të punësuar mjekë psikiatër me kohë të pjesshme.

Evidentojmë se, kryerja e vizitave psikiatrike përveç ndikimit në rritje të besimit të të burgosurve ndaj administratës së burgjeve ka patur efekt të drejtpërdrejtë për njohjen më të thellë të nevojave por edhe përcaktimin me profesionalizëm të lartë të diagnozës dhe rekomandimeve për trajtim të mëtejshëm sidomos të të burgosurve të rinj (prurjet e reja).

Personeli i kujdesit shëndetësor nga viti 2018, është shtuar me 6 mjek dhe 7 ndihmësmjekë, të cilët janë emëruar në IEVP që kanë sektor të kujdesit të veçantë.

Viti	Mjek	Stomatolog	Farmacist	Ndihmësmjek
2018	44	20	20	152
2022	50	20	21	159

Shtesat janë bërë në IEVP Fier, Jordan Misja, Korçë, Fushë Krujë dhe në QSB. IEVP Durrës është i kompletuar me 4 mjek.

#### d. Gjetjet e MKPT

Në lidhje me këtë rekomandim të KPT-së nga monitorimet tona është konstatuar e njëjta situatë siç edhe raportohet nga DPB. Dokumentacioni i stafit shëndetësor si regjistrat për shpërndarjen e medikamenteve, si dhe kartelat mjekësore të të burgosurve, janë të sekretuara, të plotësuara sipas rubrikave dhe në zbatim të marrëveshjes trepalëshe ndërmjet FSDKSH-së, IEVP-së dhe depos farmaceutike, në mënyrë që të vihet në funksion skema e rimburimit të ilaçeve si për sëmundjet kronike ashtu dhe për ato të urgjencës, duke siguruar kështu një furnizim të rregullt të këtij institucioni me medikamente.

Pra zbatimin e këtij rekomandimi e konsiderojmë të pjesshëm.

Në konkluzion vlerësojmë se ka nevojë për përmirësim në adresimin e problemeve të shëndetit mendor ndërkohë që duhet rritur numri i mjekëve psikiatër në vend në sistemin e burgjeve, si dhe rritja e kapaciteteve për shtrimin dhe trajtimin shëndetësor të tyre në bazë të protokolleve shëndetësore.

#### **1.4.4 Trajnimi i stafin përkatës**

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT u bën thirrje edhe një herë autoriteteteve shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm-përfshirë përmes lëshimit të udhëzimeve dhe ofrimit të trajnimit për stafin përkatës për të siguruar që në të gjitha institucionet e vizituara, si dhe në burgjet e tjera në Shqipëri, mjekësia kryen ekzaminimet për të burgosurit. KPT do të donte të dinte nëse ekzaminimi për sëmundjet e transmetueshme u ishte ofruar të gjithë të burgosurve të sapoardhur dhe në të cilat burgje dhe nëse u ofrohej ndonjë trajtim atyre që ishin testuar pozitivisht.

##### **b. Përgjigjja zyrtare**

Në dritën e këtij rekomandimi, vërejmë se ne e kemi standardizuar këtë proces dhe ofruar trajnime për të gjithë mjekët në sistemin e burgjeve.

Aktualisht, në çdo burg kryhet:

- të gjithë të burgosurit e sapoardhur i nënshtrohen një kontrolli mjekësor brenda 24 orëve të para të pranimit;

Në çdo rast, në përfundim të ekzaminimit mjekësor, mbahet procesverbal, në përputhje me Protokollin e Stambollit dhe rekomandimet e KPT-së. Të dhënat për çdo rast dokumentohen edhe në kartelën klinike të të burgosurit:

- nëpërmjet procesit të check-up-it kemi nisur këtë vit depistimin dhe testimini vullnetar për TB, HIV dhe hepatitin B/C, proces i cili kryhet nga mjekë të kualifikuar dhe do të vijojë të kryhet sistematikisht;
- të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve kryhen në ambiente të posaçme të personelit mjekësor - jashtë shikimit dhe pranisë së personelit jomjekësor;
- çdo burg administron një regjistër të veçantë të traumave, ku regjistrohen të gjitha llojet e dëmtimeve të ekzaminuara;
- stafi mjekësor në institucionet e burgjeve janë njoftuar me detyrimet ligjore për të raportuar në prokurorinë kompetente për çdo lëndim që tregon keqtrajtim brenda 48 orëve.

Në lidhje me shqyrtimin për sëmundjet e transmetueshme a ju ishte ofruar të gjithë të burgosurve të sapoardhur dhe në të cilat burgje dhe nëse u ofrohej ndonjë trajtim atyre që ishin testuar pozitivisht,

Vëmë re se,

- në bashkëpunim me Shoqatën STOP AIDS kemi ofruar trajnime për personeli shëndetësor dhe psikosocial për menaxhimin dhe trajtin e të burgosurve me sëmundjet infektive (të tillë si hepatiti B dhe C, HIV / AIDS dhe të tjera seksualisht sëmundjet e transmetuara)
- vazhdon kontrolli vullnetar i të burgosurve për sëmundjet infektive.

- shqyrtimi dhe trajnimi i stafit multidisiplinar kanë qenë të vlefshëm jo vetëm për diagnostikimin e hershëm të të burgosurve, por edhe për parandalimin dhe menaxhimin e rastet e sëmundjeve infektive.
- deri në fund të vitit 2018 kemi kryer 430 kontolle vullnetare të të burgosurve për infeksione sëmundjet (të tillë si hepatiti B dhe C, HIV / AIDS, sëmundjet seksualisht të transmetueshme).
- gjatë vitit 2019 kemi kryer 432 kontolle vullnetare të të burgosurve për infeksione sëmundjet.
- personat e dyshuar me HIV/AIDS kontrollohen menjëherë nga Institucioni i Shëndetit Publik dhe, nëse janë pozitive, konsultohen nga një specialist i sëmundjeve infektive dhe trajtohen sipas protokollit të trajtimit antiretroviral të ofruar falas sipas skemës së rimbursimit.<sup>44</sup>

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar dy urdhra për zbatim nga të gjitha IEVP, përkatësisht nr.11453/1 prot., datë 20.11.2018 ‘Mbi menaxhimin dhe disiplinimin e procedurave të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve’; nr.11454 prot., datë 20.11.2018 dhe nr.11455 Prot, datë 20.11.2018 ‘Mbi realizimin e ekzaminimeve mjekësor për të burgosurit’, ku janë parashtruar qartë:

- plotësimi me korrektesi dhe përgjegjësi i dokumentacionit shëndetësor (kartelës klinike, regjistrave e konsultave mjekësore, regjistrat e infermierëve) për të burgosurit nga stafi shëndetësor i IEVP-ve;
- marrjen e anamnezës mjekësore të hollësishme, të burgosurve në momentin e pranimit;
- realizimin e ekzaminimeve mjekësore për rastet e reja (laboratorike dhe skopi apo Ro-grafi pulmoni) brenda 48-72 orëve, përashtuar rastet urgjente;
- realizimin e ekzaminimeve mjekësore të të burgosurve sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

Për të gjithë të burgosurit që kanë patur probleme me sëmundjet infektive apo kanë referuar për to janë marrë masa të menjëhershme për veçimin e tyre (sidomos rastet me TBC) dhe trajtimin e tyre. Të burgosurit me tbc trajtohen vetëm në Qendrën Spitalore të Burgjeve deri në momentin kur BK del negativ (në ketë moment nuk përbën problem për përhapje të infeksionit). Më pas bëhet dalje me mjekim ambulator, trajtohen në IEVP sipas rekomandimeve të mjekut specialist dhe konuslohen çdo muaj nga mjeku pneumolog. Mjekimi i pacientëve për tbc sigurohet falas nga Sanatoriumi. Ky mjekim zgjat deri në 6 muaj pas daljes nga spitali.

Të gjitha rastet që kanë rezultuar me HIV/AIDS janë konsultuar me mjekët specialistë infeksioniste. U realizohen të gjitha ekzaminimet e nevojshme dhe u sigurohet mjekimi falas me

---

<sup>44</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 28-29.

antiretroviral, nga Spitali Infektiv i QSUT ‘Nënë Tereza’. Ky mjekim merret një herë në muaj nga stafi shëndetësore i IEVP-ve, pranë Spitalit infektiv.

Evidentojmë se:

- në bashkëpunim me shoqatën ‘STOP AIDS’ kemi realizuar trajnime të stafit shëndetësor dhe psikosocial mbi menaxhimin dhe trajtimin e të burgosurve me sëmundje infektive (si Hepatiti B dhe C, HIV/AIDS dhe sëmundje seksualisht të transmetueshme)
- gjatë vitit 2020 janë vendosur laboratorë në IEVP Fier, Shkodër dhe ‘Jordan Misja’ për realizimin e testeve të shpejta për sëmundjet infektive e depistimin e të burgosurve me qëllim diagnostikimin e të burgosurve sa më herët, por edhe për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve me probleme të sëmundjeve infektive.
- personave që rezultojnë të dyshimt për HIV/AIDS, menjëherë u realizohen ekzaminime mjekësore pranë Institutit të Shëndetit Publik (ISHP) dhe në rast se rezultojnë pozitiv, konsultohen me mjekun specialist infeksionist dhe trajtohen sipas protokollit të mjekimit me antiretroviral- mjekim, i cili sigurohet falas sipas skemës së rimbursimit.
- shoqatat STOP – AIDS dhe Aksion Plus kanë zhvilluar trajnime të stafit shëndetësor, sigurisë dhe psiko-social mbi menaxhimin dhe trajtimin e të burgosurve me sëmundje infektive dhe ish-përdorues të lëndëve narkotike.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

**Në lidhje me këtë rekandomdim janë marrë masa për nxjerrjen e urdhraleve nr.11453/1 prot., datë 20.11.2018 ‘*Mbi menaxhimin dhe disiplinimin e procedurave të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve*’; nr.11454 prot., datë 20.11.2018 dhe nr.11455 prot, datë 20.11.2018 ‘*Mbi realizimin e ekzaminimeve mjekësor për të burgosurit*’. Ndërkohë që ka një vëmendje të shtuar për rastet e sëmundjeve të transmetueshme jo vetëm për shkak të procedurave ekzaminuese sipas urdhrit të sipërcituar, por edhe për shkak dhe të pandemisë COVID-19. Mendojmë se ky rekandomdim është realizuar për sa ka pasur një numër shumë të ulët të personave që kanë humbur jetën në IEVP nga Covid-19, fatmirësisht. Në çdo rast mbetet nevoja për të përshkruar protokoll për ekzaminime të hollësishme që do të përfshijë edhe analizat e gjakut përkatëse.**

#### **1.4.5 Personeli i burgut**

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT ka theksuar në mënyrë të përsëritur rëndësinë e garantimit që të gjithë oficerët e rinj të burgjeve të përfitojnë nga trajnimi i duhur fillestare dhe që të organizohet trajnimi i vazhdueshëm për të gjithë oficerët e burgjeve që tashmë punojnë në sistemin e burgjeve. Vëmendje e veçantë në

fazën e rekrutimit duhet t'i kushtohet edhe përgjedhjes së personave me cilësitë e duhura personale. Delegacioni u informua se rekrutimi dhe trajnimi fillestar i oficerëve të burgut u krye në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë. Komiteti do të dëshironte të merrte informacione të hollësishme për trajnimin fillestar dhe atë të shërbimit të marrë nga punonjësit e burgjeve.

### **b. Përgjigja zyrtare**

Ne e konsiderojmë çështjen e trajnimit të stafit një prioritet, veçanërisht trajnimin fillestar të rekrutimit në sistemi i burgjeve. Trajnimi fillestar është përmirësuar në aspektin e kurrikulave, me mbështetjen e Projektet e Këshillit të Evropës në kuadër të Programit të Mbështetjes Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqia, faza I dhe II. Vitet e fundit kemi bashkëpunuar me Akademinë e Sigurisë për trajnimin fillestar të stafit të ri, duke ofruar akomodim pranë ambienteve të Akademisë.

Trajnimi bazë (fillestar) zgjat 240 orë dhe pasohet me praktikë. Temat më të rëndësishme të trajnimit fillestar kanë të bëjnë me çështjet e të drejtave të të burgosurve, parandalimin e dhunës, incidentin e menaxhimit, trajtimi i grupeve vulnerabël etj.

Krahas trajnimit bazë ka edhe trajnime në punë, duke iu referuar nevojave të stafit që janë vlerësuar gjatë ushtrimit të detyrës.

Në Planin e Veprimit për sistemin e burgjeve për periudhën 2020-2022, ndër 8 shtyllat kryesore është planifikuar fuqizimin e qendrës së trajnimit kryesish nëpërmjet: 1. rishikimit të fillimit dhe kurrikulat e vazhdueshme në lidhje me Kodin e Etikës, aspektet shëndetësore dhe të ndihmës së parë, përdorimin e forcës dhe kufizimi fizik, aspektet e menaxhimit, menaxhimi i krizave, abuzimi me substancat dhe droga ndërgjegjësimi etj.; 2. Programi i trajnimit për nevoja të veçanta për gratë e burgosura dhe menaxhimi i burgjeve për gratë; 3. Program trajnimi për stafin e burgjeve për menaxhimin e të burgosurve të dhunshëm.

Komponenti i trajnimit do të vazhdojë të mbështetet nga KiE.<sup>45</sup>

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Në vijim të informacionit përcjellë KPT-së<sup>46</sup>, evidentojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, realizimin e misionit të saj e ka mbështetur në rritjen e kapaciteteve të stafit,

<sup>45</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 29-30.

<sup>46</sup> E konsiderojmë prioritet çështjen e trajnimit të stafit, veçanërisht trajnimin fillestar për rekrutim në sistemin e burgjeve. Trajnimi fillestar është përmirësuar në aspektin e kurrikulave, me mbështetjen e projekteve të Këshillit të Evropës në kuadër të programit "Mbështetje Horizontale për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë", faza I dhe II. Vitet e fundit kemi bashkëpunuar me Akademinë e Sigurisë, për trajnimin fillestar të punonjësve të rinj, duke u ofruar edhe akomodim pranë ambienteve të Akademisë. Trajnimi bazë (fillestar) zhvillohet në 240 orë dhe shoqërohet me praktikë në terren. Temat më të rëndësishme të trajnimit fillestar kanë të bëjnë me çështje të të drejtave të burgosurve, parandalimi i dhunës, menaxhimi i incidenteve, trajtimi i grupeve vulnerabël etj. Krahas trajnimit bazë zhvillohet edhe trajnime në detyrë, referuar nevojave të stafit të cilat janë vlerësuar gjatë ushtrimit të detyrës. Në Planin e Veprimit për sistemin e burgjeve për periudhën 2020-2022, ndër 8 shtyllat kryesore është planifikuar forcimi i qendrës

nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe trajnimit të vazhdueshëm, të të gjitha kategorive të punonjësve<sup>47</sup>.

Gjatë vitit 2020, edhe shërbimi i trajnimeve ka funksionuar në kushtet e kufizimit social dhe vështirësive të krijuara nga pandemia, megjithatë trajnimi nuk është ndërprerë veçanërisht për punonjësit e rinj, të cilët janë rekrutuar gjatë këtij viti.

Trajnimet janë organizuar kryesisht përmes aplikacioneve të trajnimit online me grupe të ndryshme, veçanërisht trajnimin e punonjësve të rolit të mesëm për specialistë të policisë dhe me stafin e shërbimit social. Trajnine janë realizuar edhe në terren, duke krijuar ambiente të përshtatshme sipas protokolleve anti-Covid 19.

Në bashkëpunim me ekspertë të KiE janë rishikuar e përmirësuar 19 module ekzistuese trajnimi<sup>48</sup> dhe gradualisht do të rishikohen të gjitha modulet. KiE do të mbështesë edhe publikimin e tyre.

Tashmë në ambientet e DPB janë krijuar 4 sala trajnimi me kapacitet deri në 80 persona dhe janë pajisur me mjetet e nevojshme mësimore.

Me lehtësimin e masave kufizuese anti-Covid 19, trajnimet do të zhvillohen rregullisht në ambientet e dedikuara.

Gjatë vitit 2020 janë trajnuar:

- 852 punonjës (20% e numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të burgjeve) nga të cilët, 299 janë punonjës të nivelit të mesëm të shërbimeve multidisiplinare; 315 janë punonjës të rolit bazë dhe 238 punonjës të ekipeve multidisiplinare.
- 315 punonjës të rinj të rolit bazë para fillimit të punës
- 238 punonjës të ekipeve multidisiplinar të nivelit të mesëm dhe të lartë të menaxhimit të shërbimeve të sigurisë, kujdesit social dhe shëndetësor.
- janë ofruar programe të shumëllojshme, sistematike dhe në përputhje me nevojat. Konkrektisht janë zhvilluar trajnime bazë dhe trajnime për zhvillim karriere për punonjësit e shërbimit të sigurisë, trajnim për parandalimin dhe menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm, për

---

së trajnimeve kryesisht përmes: 1. rishikimit të kurrikulës fillestare dhe ato në detyrë në lidhje me Kodin e Etikës, aspektet shëndetësore dhe të ndihmës së parë, përdorimit të mjeteve të forcës dhe të kufizimit fizik, aspektet e menaxhimit, menaxhimi i krizave, abuzimi me substancat dhe ndërgjegjësimit mbi drogat etj.; 2. program trajnimi për nevoja të veçanta të grave të burgosura dhe menaxhimi i burgjeve për gratë; 3. program trajnimi për menaxhimin e të burgosurve me rrisk të lartë/të dhunshëm. Komponenti i trajnimeve do të vazhdojë të mbështetet nga KiE.

<sup>47</sup> Plani i Veprimit për sistemin e burgjeve, Objektivi Strategjik nr.3 ‘Trajnimi i stafit, përfshirë edhe stafin menaxherial’

<sup>48</sup> **Modulet kryesore të programit bazë:** Programet e trajnimit kanë 7 modulet bazë, moduli ligjor, i sigurisë, i komunikimit, shëndetësor, i emergjencave, përdorimit të forcës dhe ai i menaxhimit, si dhe programet e trajnimit: të personelit që punon me të mitur dhe gratë, të stafit të nivelit të mesëm dhe të lartë, për ngritje në gradë të punonjësve të policisë së burgjeve, të stafit në detyrë etj.. Modulet janë në proces rishikimi dhe përditësimi në bashkëpunim me ekspertë të KiE.

procedurat e shoqërimit dhe të transportit, për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të nivelit të mesëm të menaxhimit, vlerësimin e riskut etj..

- bashkëpunimi me partnerët jashtë dhe brenda sistemit (OSBE, KE) ka qenë shumë efektiv dhe ka bërë të mundur që të ketë një koordinim midis programeve duke shmangur mbivendosjet. Mbështetja e tyre ka qenë kryesisht për trajnimin e stafit mbi radikalizmin.
- bashkëpunimi me Akademinë e Sigurisë gjatë këtij viti ka konsistuar vetëm në procedurat e testimit për rekrutim dhe të testimeve për zhvillim karriere. Gjatë vitit janë bërë tre testime në Akademi, nga të cilët njëri për zhvillim karriere.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë kryer edhe procese të tjera të lidhura me trajnimet, si:

- administrimi i të dhënave të punonjësve të sistemit për gjendjen dhe nevojat e trajnimit.
- hedhja në katalog, përpunimi dhe vlerësimi i nevojave të trajnimeve
- vlerësimi i trajnimeve nga pjesëmarrësit, nëpërmjet pyetësorëve dhe vlerësimet individuale, për shkallën e përvetësimit të programit.
- bashkëpunimi me partnerë jashtë sistemit për zhvillimin e trajnimeve specifike dhe zbatimi i marrëveshjeve përkatëse.

Programi bazë i trajnimit është pasuruar gjatë kësaj periudhe me module nga praktika pune të përditshme, shoqëruar me ilustrime në DVD. Kjo praktikë përdoret për tema si përdorimi i forcës, përdorimi i mjeteve kufizuese, teknikat e kontrollit personal, të kontrollit të qelisë dhe ambienteve të tjera, të zgjidhjes së incidenteve, të plotësimit të raporteve për incidente etj..

Për nivelin e mesëm drejtues janë ofruar trajnime për stafin që punon me të mitur në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të mitur; për parandalimin e radikalizmit dhe të ekstremizmit të dhunshëm dhe mbi sigurinë dinamike dhe grupet vulnerabël.

Të gjitha modulet dhe prezantimet mbështeten në standartet bazë dhe në filozofinë e trajtimit human dhe respektimit të dinjitetit të personave të privuar nga liria.

Ndërkohë, një komponent i rëndësishëm i trajnimeve të të gjitha niveleve ka qenë trajtimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe KPT-së.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Rekomandim i reflektaur kryesisht në përshtatje me situatën e pandemisë. Gjatë monitorimeve tona kemi konstatuar se trajnimet për personelin kanë qenë në numër më të kufizuar për shkak edhe të rregullave të vendosura gjatë periudhës së pandemisë.

#### **1.4.6 Masat disiplinore**

### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekomandon që të ndërmerren hapa në Burgun e Burrelit dhe Burgun e Fierit (dhe kur është e përshtatshme, edhe në institucionet e tjera të burgjeve në Shqipëri) për të siguruar që të burgosurve që i nënshtronen sanksioneve disiplinore u jepet sistematikisht një kopje e vendimit, si parashikohet me ligj<sup>49</sup>.

### **b. Përgjigja zyrtare**

Nëpërmjet udhëzimit të datës 31.10.2019 kemi sjellë në vëmendje të të gjitha burgjeve zbatimin e detyrimeve lidhur me procedimin disiplinor për të burgosurit. Ne e kemi standardizuar tashmë këtë proces në çdo burg, si dhe përgjigjet që u jepen të burgosurve, më konkretisht:

- në çdo rast i burgosuri informohet menjëherë dhe firmos (për informim) për urdhrint përfillimin e procedimit disiplinor ndaj tij.
- i jepet menjëherë një kopje e vendimit të Komisionit Disiplinor atit - nënshkruan i burgosuri (për marrjen e kopjes së vendimit) dhe shënon gjithashtu edhe datën kur e ka marrë atë.
- i burgosuri njoftohet gjatë mbledhjes së Komisionit Disiplinor për të drejtën dhe afatet kohore për ankimim e masës disiplinore në DPB. Kjo e drejtë dhe afati 15 ditë për ankimim ndaj masës disiplinore shënohen në Vendimin e Komisionit Disiplinor, një kopje e të cilit i jepet të dënuarit.
- në rastet e ankimimit të masës disiplinore, kopje e vendimit e Komisionit të Apelit në DPB i dërgohet zyrtarisht të burgosurit.<sup>50</sup>

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Kjo problematikë është tejkaluar. Çdo i burgosur njihet paraprakisht dhe pajiset me kopje të urdhrit përfillimin e procesit disiplinor (përmes të cilës njoftohet edhe përfatësi e shqyrtimit disiplinor) dhe me kopjen e vendimit të masës disiplinore. Në çdo rast përmes këtij vendimi, i burgosuri njoftohet edhe përfatësi e drejtën e apelimit të vendimit pranë Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore të të burgosurve (KAMD).

Gjithsesi, nga monitorimet e kryera dhe praktikat e shqyrtuar nga KAMD në DPB kanë rezultuar raste kur të burgosurit refuzojnë të nënshkruajnë marrjen dijeni në të gjitha fazat e shqyrtimit

<sup>49</sup> *KPT thekson se të dënuarve duhet t'u jepet një kopje e masës së tyre disiplinore siç kërkohet nga ligji. KPT është e shqetësuar pasi mjekët e burgjeve vazhdojnë të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve disiplinore dhe lëshojnë vërtetime se të dënuarit mund ta përballojnë masën e dhënë.*

<sup>50</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 31-32.

disiplinor<sup>51</sup> apo të pranojnë kopje të vendimit për masën disiplinore<sup>52</sup>, madje duke ngritur edhe pretendime se nuk janë njoftuar.

Gjatë vitit 2020 KAMD në DPB ka trajtuar 117 ankime të të burgosurve për masat disiplinore të dhëna nga Komisionet Disiplinore në IEVP. Të gjitha këto ankime janë paraqitur për shqyrtim në KAMD brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga marrja dijeni për vendimin e Komisionit Disiplinor të IEVP-së dhe në asnjë prej tyre nuk ka patur pretendime për mos marrje dijeni nga ana e tyre për këto vendime.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Në lidhje me këtë rekomandim në vitin 2021 institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë me një rekomandim të veçantë ku ndër të tjera ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse për marrjen e masave për përmirësimin e procedurës që duhet të ndiqet nga administrata e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), sa i përket njohjes së të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe kohës (afatit) së zbatimit të saj, duke i kërkuar atij të nënshkruajë vendimin e marrë ndaj tij si në kopjen që i dorëzohet ashtu edhe në atë që ruhet në dosjen personale, dhe në rast refuzimi, vendimi të nënshkruhet nga dy persona të tjerë të personelit me shënimin “refuzon firmën”. Gjithashtu kemi rekomanduar përgjithësimin e këtij rasti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në të gjitha IEVP-të, për të garantuar respektimin e të drejtave të personave të burgosur gjatë procedurës së dhënies ndaj tyre të masave disiplinore.<sup>53</sup>

Rekomandimi vlerësohet pjesërisht i zbatuar.

#### **1.4.7 Roli i stafit mjekësor në lidhje me masat disiplinore**

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT përsërit rekomandimin se roli i stafit mjekësor në lidhje me masat disiplinore duhet të rishikohet, në bazë të vërejtjeve të përmendura në këtë raport. Duke vepruar kështu, duhet të mbahen në konsideratë Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe komentet e bëra nga Komiteti në Raportin e 21-të të përgjithshëm të tij. Mjekët nuk duhet të marrin pjesë në asnjë proces vendimmarrës për masa, përveç rasteve kur masa aplikohet për arsyen e mjekësore. Mjeku duhet të jetë prezent një herë në ditë tek i dënuari, i cili ndodhet në veçim, për t'i siguruar assistencë mjekësore. Mjeku duhet të raportojë tek drejtori i burgut në rastet, kur shëndeti i të dënuarit në veçim është në rrezik.

<sup>51</sup> Rasti i E.SH. në IEVP ‘Jordan Misja’ Tiranë, i cili ka refuzuar nënshkrimin për marrjen dijeni në të gjitha fazat e shqyrtimit disiplinor, për një nga masat disiplinore të dhëna ndaj tij nga Komisioni Disiplinor.

<sup>52</sup> Rasti V.M. në IEVP Burrel i cili refuzoi vendimin e KAMD

<sup>53</sup> Rekomandim për përmirësimin e procedurës që ka të bëjë me njohjen e të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe kohën (afatin) kur duhet të zbatohet ajo

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20lidhur%20me%20proceduren%20e%20dhenies%20se%20mases%20disiplinore%20i%20denuari%20K.%20M..pdf>

## b. Përgjigja zyrtare

Mjeku nuk është pjesë e Komisionit Disiplinor të burgjeve. Ai/ajo lëshon një raport që përmban vetëm gjendjen shëndetësore të të burgosurit. Në asnjë rast mjeku nuk duhet të deklarojë nëse është ose jo i burgosuri në gjendje të përballet me masën disiplinore. Ky raport drejton Komisionin Disiplinor për përcaktimin e vendit ku do të zbatohet sanksioni disiplinor. Në rast se i burgosuri ka probleme shëndetësore ai/ajo kryen masën disiplinore në qeli, në të kundërtën masa disiplinore zbatohet në dhomat e izolimit siç përcaktohet në ligj.<sup>54</sup>

## c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

Ligji 81/2020 ka parashikuar rregullime të qarta për procedurën disiplinore dhe zbatimin e masave disiplinore.

Në referencë të rekomandimit të KPT për reduktimin e kohëzgjatjes maksimale të zbatimit të masës disiplinore, afati prej 20 ditësh u reduktua në 14 ditë<sup>55</sup>.

Sipas këtij ligji, dhe në praktikën e punës, mjeku nuk është pjesë e Komisionit Disiplinor në IEVP. Mjeku përgatit një raport mbi gjendjen shëndetësore të të burgosurit, i cili është në procedim disiplinor. Në asnjë rast mjeku nuk shprehet nëse i burgosuri e përballon ose jo masën disiplinore.

Raporti njëherësh impakton dhe orienton Komisionin Disiplinor për të përcaktuar kohëzgjatjen e masës disiplinore (dhe jo llojin e shkeljes disiplinore), vendin e kryerjes së masës disiplinore nga i burgosuri (në dhomë ose në veçim). Në rast se i burgosuri ka probleme shëndetësore, ai e kryen masën disiplinore në dhomën/qelinë e tij, në të kundërt masa disiplinore kryhet në ambientet e vecimit, siç është përcaktuar në ligj. Mjeku dhe psikologu vizitojnë dhe asistojnë rregullisht të burgosurin që është nën efektin e masës disiplinore. Këtë praktikë të mirë pune jemi duke e standardizuar edhe përmes përmirësimit të udhëzuesit për masat disiplinore për të burgosurit, i hartuar e miratuar në vitin 2013.

## d. Gjetjet e MKPT

**Rekomandimi i zbatuar** në vijim edhe të ndryshimeve ligjore që kanë ardhur si rrjedhojë e miratimit të ligjit ne. 81/2020 “*Për trajtimin dhe të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, përkatësisht neni 65 i tij “Organë kompetent për dhënien e masave disiplinore”, i cili parashikon se komisioni disiplinor përbëhet nga 5 anëtarë nga të cilët mjeku **nuk** është pjesë e këtij komisioni. Mjeku përgatit një raport mbi gjendjen shëndetësore të të burgosurit, i cili është në procedim disiplinor. Në asnjë rast mjeku nuk shprehet nëse i burgosuri e përballon ose jo masën

<sup>54</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 32.

<sup>55</sup> Ligji 81/2020, Neni 64, pika (ç)

disiplinore. Në pikën 4 të po këtij nenj parashikohet se “*Përpara fillimit të shqyrtimit disiplinor, mjeku përgatit një raport mjekësor ku shprehet për gjendjen shëndetësore të të burgosurit ndaj të cilët ka filluar procedura disiplinore. Raporti vihet në dispozicion të komisionit disiplinor dhe shqyrtohet prej tij përfshirë efekt të përcaktimit të masës disiplinore. Mjeku merr pjesë në mbledhjet e komisionit disiplinor pa të drejtë vote dhe ka të drejtë të japë sqarime nëse kjo kërcohët nga komisioni disiplinor.*” Gjatë monitorimeve dhe vlerësimit të dokumentacionit kemi konstatuar se kjo praktikë ndiqet nga institucioni.

## **Kontakti me botën e jashtme**

### **a. Rekomandim i KPT**

Komiteti përsërit rekondimet e tij që autoritetet shqiptare të rishikojnë rregullimet e vizitave në burgje në mënyrë që të sigurojnë që vizitat afatshkurtra të zgjasin të paktën një orë dhe që ato të zhvillohen, si rregull, në kushte të hapura (p.sh. me të burgosurit dhe vizitorë të ulur rrëth një tavoline).

Ministria e Drejtësisë ka raportuar se kohëzgjatja e vizitave përcaktohet nga orari ditor i punës në burg dhe numri i takimeve me anëtarët e familjes gjatë ditës. Duke pasur parasysh këta faktorë, takimet nuk mund të tejkalojnë 30 minuta, pasi ato do të shkaktonin orë shtesë dhe jo të gjitha takimet e përditshme mund të përfundonin.

Lidhur me takimet me familjet me fëmijë të mitur, administrata e burgut zbaton programin “Prindër në distancë”, duke mundësuar takime deri në 1 orë në salla të veçanta dhe të hapura për takime.

Takimet një orëshe ofrohen rregullisht për gratë dhe të miturit e dënuar dhe të paraburgosur.

### **b. Përgjigjja zyrtare**

Kohëzgjatja e vizitave përcaktohet nga orari i punës ditor i burgut dhe numri i takimeve me familjarët gjatë ditës. Nisur nga këta faktorë, takimet nuk mund të tejkalojnë 30 minuta, pasi do të shkaktonin orë jashtë orarit dhe nuk do mund të përfundonin të gjitha takimet ditore. Për takimet me familjet me fëmijë të mitur zbaton administrata e burgut zbaton programin ‘Prindërimi në distancë’, që mundëson takime speciale dhe të hapura deri në 1 orë në dhomat e mbledhjeve. Organizohen rregullisht takime një orëshe për gratë e dënuara dhe të paraburgosura dhe të miturit.<sup>56</sup>

### **c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës**

<sup>56</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 32-33.

Rekomandimi i KPT për rishikimin e kohëzgjatjes së vizitave me familjarët, të paktën 1 orë ka gjetur zbatim në nenin 49, pika 1 të Ligjit 81/2020, por për shkak të situatës së pandemisë COVID-19 dhe pezullimit të përkohshëm të takimeve fizike me familjarët, ky rregullim nuk ka gjetur ende zbatim në praktikë në burgjet ku ka infrastrukturë dhe për ta maksimizuar në burgjet e tjera, sikurse është parashikuar në ligj.

Siç ju kemi informuar në vijimësi, e së fundmi përmes shkresës nr.1698/1 prot., datë 22.02.2021 kemi adresuar periodikisht dhe në dinamikë masa parandaluese, përmes protokolleve shëndetësore, udhëzimeve e instruktimeve përkatëse, mjeteve dhe pajisjeve profilaktike shëndetësore etj.

Si rezultat i mënyrës së jetesës në grup që imponon regjimi i burgut janë vendosur edhe disa kufizime që lidhen me distancimin social, në proporcion me riskun e lartë të përhapjes së virusit COVID-19 në sistemin e burgjeve.

Siç jeni në dijeni, pjesë e kufizimeve kanë qenë edhe takimet me familjarët dhe të afërmit, të cilat janë zëvendësuar përmes takimeve online. Rregullimet specifike për këto kufizime janë parashikuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 91, datë 09.03.2020 ‘Për marrjen e masave në IEVP për parandalimin e përhapjes së COVID-19’.<sup>57</sup>

Vlen të citohet se në të gjitha IEVP janë kryer inspektimi nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, me objekt inspektimin e masave për parandalimin e përhapjes së COVID 19 – në konkluzion të të cilave janë konfirmuar si të përbushura shumë mirë masat për parandalim të përhapjes së virusit.

#### d. Gjetjet e MKPT

Rekomandimi tashmë është parashikuar në ligjin nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” që të burgosurit ju lejohen 4 takime me familjarët me mundësinë e zëvendësimit të njërit prej tyre me takim online. Gjithashtu ligji nr. 81/2020 ka ndryshuar në nenin 3, pika 1 përkufizimin e termit “Anëtarët e familjes” duke e ngushtuar këtë rreth personash në krahasim me ligjin pararendës. Duke iu referuar ligjit të mëparshëm nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, në nenin 41 të tij parashikohej se “Të paraburgosurit dhe të dënuarit lejohen që të kenë takime dhe korrespondencia me familjarët dhe persona të tjera”, praktikisht me çdo person, ndërsa ligji nr. 81/2020 e kufizon rrethin e personave me të cilët i burgosuri mund të marrë takim. Ky parashikim ka përkeqësuar kushtet e të dënuarve. Kontaktet me botën e jashtme kanë pësuar përkeqësim në krahasim me momentin në të cilin është bërë raporti, kjo përfaktin se Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve lejon takime vetëm nga e hëna në të premte, duke kufizuar kështu takimet për të shtunën dhe të dielën përfëmijët të cilët janë në shkollë.

Ky rekomandim mbetet i pazbatuar.

<sup>57</sup> Ky Urdhër qëndroi në fuqi deri në Qershor 2021.

#### **1.4.8 Situata e pacientëve me masë mjekësore**

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT ndër vite ka ngritur shqetësimin se situata e pacientëve me masë "*mjekim i detyruar*" në Shqipëri ka qenë subjekt i një dialogu të gjatë midis KPT-së dhe autoriteteve shqiptare. Në reportin përvizitën në Shkurt 2017, KPT shprehu shqetësim serioz megjithë rekomandimin specifik të bërë në mënyrë të përsëritur nga Komiteti që nga vizita e vitit 2000 dhe në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, pacientët me masë "*mjekim i detyruar*" vazhdojnë të mbahen në Spitalin e Burgut në Tiranë dhe në Institucionin e Veçantë të Zaharisë në Krujë në kushte të papranueshme<sup>58</sup>. Në fakt, kushtet e jetesës në këto dy institucione ishin përkeqësuar më tej që nga vizita e vitit 2014 (në veçanti për sa i përket gjendjes së riparimit dhe mbipopullimit)<sup>59</sup>, dhe niveli i kujdesit psikiatrik mbetet qartë i pamjaftueshëm. Në përgjithësi, Komiteti krijoi përshtypjen e "braktisjes terapeutike" të shumë pacientëve.

KPT ka kërkuar:

- informacion të detajuar mbi hapjen e objektit psikiatrik në burgun e Lezhës (përfshirë mënyrën e menaxhimit të kësaj strukture, numrin e stafit të përkujdesjes shëndetësore dhe të stafit tjetër të specializuar, trajnime të stafit, mënyrën e sigurisë, mundësimin e aktiviteteve terapeutike dhe rekreative etj).
- konfirmimin se të gjithë pacientët janë transferuar në Lezhë.
- një kopje të konceptit të rishikuar për ndërtimin e institucionit psikiatrik në Tiranë.

##### **b. Përgjigjja zyrtare**

Vëmë re se pacientët me masë mjekësore vazhdojnë të akomodohen në burgun e Krujës.

Ju jeni në dijeni edhe për zgjidhjen që qeveria shqiptare po i jep kësaj çështjeje, duke i akomoduar në 2 godinat e përshtatura në burgun e Lezhës.

- Procedurat e investimit në pasuri të paluajtshme janë kryer me fonde të Qeverisë Shqiptare, duke arritur standardet më të mira të akomodimit dhe shërbimeve shëndetësore për këtë kategori.
- Aktualisht jemi në fazën e rialokimit të fondeve për mobilimin e ambienteve, procedurë që po përshtojhet nga ana jonë, në mënyrë të përfundojë sa më shpejt.

<sup>58</sup> shih: <https://rm.coe.int/16808ae48f> "Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)" from 2 to 9 February 2017 CPT/Inf (2018), fq. 45.

<sup>59</sup> Më datë 2.12.2020 rezulton se kapaciteti i këtij institucionit është 196 persona, ndërkohë që aktualisht ndodhen 292 persona. Mbipopullim 96 persona.

Në dhjetor 2019, Ministria e Shëndetësisë nxori një projekt-urdhër të përbashkët “*Për miratimin e planit të masave kalimtare në kuadër të përmirësimit të kushteve dhe trajtimit të personave me masën “mjekim të detyrueshëm”*”.

Në këtë draft janë përcaktuar masat që do të ndërmerren, institucionet përgjegjëse dhe afati për zbatim. Aktualisht jemi duke konsultuar planin e masave në bashkëpunim me ekspertë të Ministrisë së Shëndetësisë.<sup>60</sup>

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës<sup>61</sup>

Situata e tërmetit të tetorit të vitit 2019 dhe më tej pandemia e shkaktuar nga COVID-19 afektuan edhe sistemin e burgjeve.

Tërmeti shkaktoi dëme në dy godinat e banimit të burgosurve në IEVP Lezhë, për të cilat u paraqit e domosdoshme rialokimi i fondit të planifikuar për rikonstruksionin e dy godinave në këtë IEVP, ku do të akomodoheshin pacientët me masë mjekësore. Gjithsesi, me rihapjen e procedurave të rikonstruksionit, parashikohet që deri në korrik 2021 të përfundojë rikonstruksioni i plotë i godinave dhe njëkohësisht mobilimi dhe instalimi i pajisjeve logistike për ngrohje dhe gatim. Ky proces do i hapë rrugë procesit të transferimit në IEVP Lezhë të të gjithë pacientëve me masë mjekësore.

Sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për Shqipërinë për trajtimin e pacientëve me masë mjekësore jemi duke bashkëpunner me Ministrinë e Shëndetësisë për gjetjen dhe përshtypjen e zbatimit të zgjidhjeve alternative për këta shtetas, duke qenë se mbështetur në Ligjin 81/2020, neni 15, pika 2 ‘*Institucionet e kujdesit shëndetësor për personat për të cilat gjykata ka vendosur zbatimin e masave mjekësore të detyrueshme administrohen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë ...*’.

### d. Gjetjet e MKPT

#### Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, nuk është zbatuar.

Në vijim të vëmendjes së shtuar të institucionit të Avokatit të Popullit, ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur institucioneve përgjegjëse mbylljen e IEVP Zahari, Krujë ku ata trajtohen më së shumti, dhe ka kërkuar në mënyrë të përsëritur me forcë, ngritjen e një institucioni të veçantë të parashikuar me ligj. *Deri në ngritjen e këtij institucioni, Avokatit të Popullit ka kërkuar përbushjen e standardeve të kushteve materiale të këtyre mjidiseve të lidhura drejtpërsëdrejti*

<sup>60</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 33.

<sup>61</sup> Referuar përgjigjes së DPB me nr. 12512/3 prot., datë 9.03.2021, situatë e cila ka ndryshuar në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye me sukses procesi transferimit nga IEVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore në dy godinat e IEVP Lezhë.

*me investimet e pamjaftueshme, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor, që mundësohet pikësëpari me rritjen e numrit të punonjësve të stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse.*

Referuar rekomandimeve të KPT-së dhe Avokatit të Popullit nga ana Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në vitin 2018 u morr një vendim lidhur me zgjidhjen provizore të kësaj problematike, e cila nisi me rikonstruktimin dhe përshtatjen e dy godinave 4, 5 brenda IEVP-së Shën Koll<sup>62</sup>, Lezhë, të cilat do të shërbejnë për akomodimin provizor të personave të trajtuar në IEVP Zahari, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm të parashikuar me ligj.

Në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye me sukses procesi transferimit nga IEVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore<sup>63</sup> dhe akomodimi i tyre në dy godinat në IEVP Lezhë<sup>64</sup>. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i gjithë stafi i IEVP Krujë, përfshirë psikiatër, infermierë, punonjës social kujdestarë dhe sanitarë tashmë janë alokuar si kapacitete në dy godinat në IEVP Lezhë, dhe po ushtrojnë funksionin e tyre për trajtimin e specializuar të pacientëve me masë mjekësore.

Numri i stafit që do të trajtojë këtë kategori personash në Lezhë është 35, konkretisht 2 mjekë psikiatër, 1 mjek kardiolog, 1 mjek i përgjithshëm, 2 psikologë, 1 stomatolog, 1 kryeinfernier, 10 infermierë, 5 kujdestarë, 5 sanitarë, 6 punonjës socialë dhe 1 pharmacist.

Me transferimin e këtyre shtetasve në IEVP Lezhë, përvèç përmirësimit të ndjeshëm të kushteve të banimit, është lehtësuar edhe aksesi i pacientëve në shërbime të specializuara shëndetësore, të cilat do të mundësohen nga shërbimet mjekësore të ambulancave/spitaleve shtetërore në afërsi të zonës

Ndërkohë, dy godinat në Lezhë krahas stafit të dedikuar për trajtimin e pacientëve do të kenë edhe ambiente dhe pajisje të dedikuara mjekësore, konkretisht:

- dhomën e infermierisë të kompletuar me medikamentet e urgjencës,
- elektrokardiogramë (*EKG*) dhe *defibrilator*,
- poltron të ri dentar.

Avokati i Popullit në datë 17 shkurt 2022, kreu vizitën inspektuese të radhës në IEVP Lezhë ku konstatoi se, në seksionin e personave me masë mjekësore **ishin akomoduar në total 349**

<sup>62</sup> CPT Report 2018, faqet 7,37,38, si dhe faqja 45 “Administrimi i spitalit të ri në burgun e Lezhës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mundësojë shërbime të specializuara për këtë kategori, duke bërë të mundur aksesin e këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelive, përkujdesjen e nevojshme njerëzore dhe kontaktin me specialistë (psikiatër, psikologë, kujdestarë)”.

<sup>63</sup> 217 shtetas me masë mjekësore “shtrim i detyruar” dhe 97 shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”.

<sup>64</sup> IEVP Lezhë përmes urdhërit Nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë është klasifikuar Burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion të veçantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore mjekim i detyruar.

**persona**, nga të cilët 225 shtetas me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, 119 shtetas me masë mjekësore “shtrim i përkohshëm”, si dhe 5 shtetas paraplegjik të dënuar me vendim gjykate.

Ndërkojë, sipas projektit të ndërtimit për përshtatjen në spital të ambienteve në dy godinat e IEVP Lezhë, pajisja me shtretër ishte për mbajtjen dhe trajtimin e **184 (maksimumi 200) shtetasve** me masë “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”, përveç ambienteve të destinuara si sallë për urgjencat, laboratorët, klinikat mjekësore të mjekëve, dhomat e infermierëve, për personelin mbështetës (sanitar dhe kujdestarë), si dhe ambienteve për punën e administratës.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, Institucioni i Avokati i Popullit, gjatë kohës të funksionimit të IEVP “Zahari”, Krujë, por edhe aktualisht në IEVP Lezhë, midis të tjerave, ka evidentuar dhe një problematikë që lidhet me vendimet e gjykatave kompetente për dhënien e masës mjekësore për personat me çregullime të shëndetit mendor, si dhe me ekzekutimin e vendimeve penale me masë mjekësore, duke i akomoduar këtë kategori në ambientet e këtyre IEVP-ve dhe jo në një institucion të posaçëm mjekësor, brenda sistemit shëndetësor të integruar.

Trajtimi dhe akomodimi jo adekuat i personave me masë mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” të vendosur nga gjykata, mbi kapacitetin fizik në IEVP Krujë, por edhe në IVSHB (Spitali i Burgjeve), është denoncuar vazhdimi i institucionit i Avokati i Popullit, si një shkelje flagrante e ligjit dhe e standardeve ndërkombëtare, që sjell trajtim diskriminues dhe denigrues të këtyre pacientëve si dhe përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore. Personat me çregullime të shëndetit mendor e kanë domosdoshmëri trajtimin nga mjeku specialist psikiatër dhe nga ekipi multidisiplinar, në çdo kohë, pavarësisht nga regjimi i mbajtjes së tyre.<sup>65</sup> Megjithatë, ashtu sikurse është përmendur në rekomandimet në vite të institucionit të Avokatit të Popullit, situata e mbipopullimit, mungesat në stafin mjekësor të specializuar si dhe në radhët e ekipit multidisiplinar (i cili ose ka probleme me kualifikimin ose është në numër të ulët), e bënин të pamundur respektimin e këtij standardi të vendosur edhe nga institucionet ndërkombëtare, për këtë qëllim.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, shtetasve me masë mjekësore ju janë cenuar rëndë të drejtat e tyre, kjo pasi prania e tyre në burgje është e kundraligjshme. Kësaj i shtohet edhe faktit që në vite nuk ka patur një përmirësim të qenësishëm në rritjen e numrit të stafit mjekësor, si dhe situata e braktisjes terapeutike e konstatuar nga KPT, ende nuk ka ndryshuar. Kjo problematikë ka patur ndikim edhe në mbipopullimin e IEVP Zahari dhe aktualisht të IEVP Lezhë, duke përkeqësuar klimën në këto institucione. Mbetet Akoma nevoja urgjente për adresimin e përmirësimeve infrastrukturore të menjëhershme. Në Shën Koll ka mbipopullim të lartë dhe strukturë organike të papërshtatshme.

---

<sup>65</sup> CPT/Inf (92) 3 – part 2, parag. 56.

## **1.4.9 Çështje të tjera**

### **a. Rekomandim i KPT**

Gjatë vizitës së saj në burgje, KPT-ja mori ankesa nga oficerët e policisë së burgjeve se ata nuk kishin asnjë pushim dreke gjatë turnit tetë orarësh. Një ankesë tjetër ishte puna jashtë orarit e pa paguar. Komiteti dëshiron të informohet për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

### **b. Përgjigjja zyrtare**

Puna dhe kohëzgjatja e saj në sistemin e burgjeve organizohet në bazë të dispozitave të Kodit të Punës<sup>66</sup> si për administratën civile ashtu edhe për oficerët e policisë. Kohëzgjatja normale e punës është përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM), në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës, brenda kufijve kohorë maksimalë të punës javore. Koha normale ditore e punës për punonjësit e policisë në sistemin e burgjeve është 8 orë për ditë, e vazhdueshme pa pushim të parashikuar.

Sipas kësaj VKM-je<sup>67</sup> orët jashtë orarit kompensohen:

- a. me një pushim të barabartë me orët jashtë orarit plus 25 për qind të kohës së tyre kur këto orë punohen në ditët normale të punës, ose me orët jashtë orarit plus 50 për qind të kohës së tyre kur punojnë orët me pushime, pushime ose ora 22:00-6:00. Pushimi kryhet brenda 2 (dy) muajve nga orë shtesë.
- b. Në rastet kur është e pamundur të jepet leje për orë shtesë, punonjësi ka të drejtë të kompensohen me shtesa mbi pagën normale.

Praktika e ndjekur nga administrata e sistemit të burgjeve është ajo e përcaktuar në pikën (a). Në rast të punës jashtë orarit, punonjësit e policisë kompensohen me ditë pushimi, siç përcaktohet në VKM.<sup>68</sup>

### **c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës**

Ligji nr.80/2020 “Për policinë e burgjeve” ka sjellë përmirësimë të ndjeshme në funksion të krijimit të një stafi sigurie me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet dhe të aftë për të garantuar sigurinë në burgje dhe paraburgime.

---

<sup>66</sup> Ligji nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 136/2015.

<sup>67</sup> VKM nr. 511, datë 24.10.2002, i ndryshuar.

<sup>68</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 30.

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji ka sjellë ndër të tjera, përmirësim të pagës financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërtë në status dhe ecurinë në karrierë.<sup>69</sup>

#### d. Gjetjet e MKPT

##### Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, është zbatuar pjesërisht.

Janë hartuar projektaktet në zbatim të ligjit nr. 80/2020 “*Për policinë e burgjeve*” dhe ligjit nr. 81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*” miratimi i të cilave pritet që të adresojë dhe këto rekomandime.

Deri më tani në zbatim të tyre janë miratuar aktet nënligjore sa më poshtë:

- Vendimi nr. 209, datë 6.4.2022 i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve*”;
- Vendimi nr. 280, datë 29.4.2022 i Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e rregullave dhe kritereve të detajuara për kushtet teknike, sigurinë, përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë nga personat me aftësi të kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale*”;
- Vendimi nr. 602, datë 13.10.2021 i Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj*”;
- Vendimi nr. 920 datë 25.11.2020 “*Për trajtimin me pagë e shtesa mbi pagë për procedurën e kompensimit finanziar gjatë qëndrimit në punë të punonjësve të Policisë së Burgjeve*” i Këshillit të Ministrave;
- Vendimi nr. 356 datë 16.6.2021 “*Për përcaktimin e kritereve për dhënien dhe kohëzgjatjen e pushimeve për punonjësit e Policisë së Burgjeve*” i Këshillit të Ministrave;
- Vendimi nr. 260, datë 5.5.2021 “*Për miratimin e paraqites, formës dhe ndërtimit të gradave të punonjësve të policisë së burgjeve*”;
- Vendim nr. 296, datë 19.5.2021 “*Për përcaktimin e flamurit, stemës, uniformës, si dhe ngjyrës e shenjave në mjetet e Policisë së Burgjeve*”;

---

<sup>69</sup> Neni 18 ‘Trajtimi ekonomik dhe financiar’: ‘1.Punonjësi i Policisë së Burgjeve përfiton trajtimin ekonomik dhe financiar, ku përfshihet: a) paga mujore, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetësie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune; b) në rast pamundësie të garantimit të transportit në vendin e punës nga vetë institucioni, kompensimi për kostot shtesë për largësi nga vendbanimi, pagesat për transport apo qiranë e banesës dhe ushqimin; 2.Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Policisë së Burgjeve, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave; 3.Për aq sa nuk është e parashikuar në këtë ligj, punonjësit e Policisë së Burgjeve kanë të drejtën e përfitimit sipas legjisacionit në fuqi për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë.’

- Vendimi nr. 305, datë 11.5.2022 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për rastet dhe mënyrën e përdorimit të armëve, të ndryshme nga armët e zjarrit, si dhe të pajisjeve kufizuese nga policia e burgjeve*”.
- Udhëzimi nr. 8, datë 30.07.2021 “*Për përcaktimin e rasteve, kushteve dhe mbrojtjes së veçantë në situata emergjente të punonjësve të Policisë së burgjeve dhe drejtuesve të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale*”;
- Urdhri nr. 409, datë 19.7.2021 “*Për miratimin e kodit të etikës dhe të sjelljes profesionale për Policinë e Burgjeve*”;
- Urdhri nr. 519, datë 8.9.2021 “*Për miratimin e Rregullores së Disiplinës për Policinë e Burgjeve*”.

Avokati i Popullit, në veprimtarinë e tij ka shqyrtuar dhe trajtuar një sërë ankesash që punonjës të policisë së burgjeve kanë adresuar për respektimin e të drejtës së tyre ligjore, në lidhje me kompensimin e punës së bërë gjatë ditëve të pushimeve javore dhe të festave zyrtare. Në përfundim të shqyrtimit të këtyre ankesave, Avokati i Popullit ka rekomanduar, marrjen e menjëhershme të masave organizative nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe drejtoritë e IEVP-ve, për respektimin e të drejtës ligjore të parashikuar në nenin 87 të Kodit të Punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve, për kompensimin për punën e kryer në ditët e pushimit favor ose në ditët e festave zyrtare ata të kompensohen me një shtesë page jo më pak se 25 për qind ose një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj.<sup>70</sup>

Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

## **SEKSIONI II**

### **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT/MINISTRIA E BRENDSHME**

#### ***II.1 Mbajtjes në polici të personave me masë sigurie "arrest me burg"***

##### **a. Rekomandim i KPT**

Autoritetet shqiptare duhet të bëjnë përpjekje për t'i dhënë fund praktikës së mbajtjes në polici të personave me masë sigurie "arrest me burg" dhe të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë.

---

<sup>70</sup> Rekomandim nr. K2/A135-3 prot., datë 08.09.2020 “*Për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtës ligjore të punonjësve të Policisë së Burgjeve lidhur me kompesimalin e kohës së punës të bërë gjatë ditëve të pushimeve javore dhe të festive zyrtare*”.

## b. Përgjigjja zyrtare

Për këtë, bashkëpunimi me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u rrit dhe u intensifikua për pranimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të personave me masën e sigurisë "Arrest me burg" dhe transferimi i të dënuarve me burgim, me vendim të formës së prerë, jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

Procedurat dhe afatet për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë nga Policia e Shtetit në ambientet e IEVP-ve janë përcaktuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 "*Për kalimin në IEVP të të ndaluarit/të ndaluarit me masë sigurie "paraburgim"*" dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë duke rritur sigurinë e IEVP-ve dhe duke siguruar të burgosurit dhe të paraburgosurit të trajtohen me leje dhe gjatë shoqërimit të tyre.<sup>71</sup>

## c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës

Në vazhdimësi janë marrë masa për transferimin në kohë në IEVP të personave të arrestuar/ndaluar me masën e sigurisë "arrest ne burg" dhe të dënuarve në mungesë me burgim me vendim të formës së prerë nga gjykata, duke bërë të mundur përmirësimin e situatës në këtë drejtim, **por jo zgjidhjen përfundimtare**.

Raste të kësaj natyre janë ndeshur në strukturat e DVP Tiranë, ku dhe numri i personave që ndaloohen dhe arrestohen është më i madh se në strukturat e tjera të Policisë së Shtetit.

Strukturat e DVP Tiranë, gjatë vitit 2020 kanë **evidentuar 54 raste të mos transferimit** në kohë në IEVP të personave me masë të sigurisë "arrest në burg", **për arsyet e mungesës së kapaciteteve/ambienteve akomoduese nga strukturat e IEVP-ve** të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në ndonjë rast pengesë për mos transferim ka qenë edhe mungesa e dokumentacionit përkatës (dokumentet e identifikimit të personave, apo edhe raste të shtetasve të huaj që nuk kanë pasur asnjë dokumentacion).

Vështirësi dhe pengesë është hasur dhe në transferimin në IEVP-ve të të dënuarve me burgim me vendim të formës së prerë, pasi strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kryejnë pranimin e kësaj kategorie personash vetëm pasi më parë të ketë dalë një urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për caktimin e IEVP-së, se ku do të kryejë burgimin.

Zakonisht strukturat vendore të Policisë së Shtetit menjëherë pas ekzekutimit të vendimit penal kanë paraqitur kërkesën në strukturat e DP Burgjeve, (së bashku me kopje të dokumentacionit) për transferimin e personit të dënuar me burgim me vendimin të formës së prerë dhe sipas

<sup>71</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 8.

marrëveshjes së përbashkët me DPSH, nga ana e DP Burgjeve duhet që brenda 24 orëve nga mbërritja e kërkesës të dërgohet urdhri për transferim në strukturën përkatëse policore.

Për vitin 2020, nga ana e strukturave të DVP Tiranë janë evidentuar rreth **90 raste të mos transferimit në kohë në IEVP**, të personave dénuar me burgim në mungesë, **për arsyе të vonesave në përgatitjen dhe dërgimin e urdhrove** përkatës të DP Burgjeve për transferimin e këtyre personave. Përgjigjja e Qeverisë Shqiptare evidenton se për këtë qëllim është shtuar dhe intensifikuar bashkëpunimi me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për pranimin dhe dorëzimin e menjëhershëm të personave me masë sigurie “Arrest me burg” dhe transferimin të të dénuarve me burgim me vendim të formës së prerë jo më vonë se 24 orë pas paraqitjes së kërkesës nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe se procedurat dhe afatet e transferimit të të dénuarve me vendim të formës së prerë nga Policia e Shtetit në ambientet e IEVP-ve përcaktohen në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nr. 897/3, datë 04.03.2019 dhe nr. 2194, datë 05.03.2019 “*Për kalimin në IEVP të të paraburgosurve/paraburgosurve me masë sigurie “arrest në paraburgim” dhe të dénuarve me burgim me vendim të formës së prerë në mungesë, duke rritur sigurinë e IEVP-ve dhe duke sigruar të burgosurit dhe të paraburgosurit që janë trajtohen me leje dhe gjatë shoqërimit të tyre*”.

#### d. Gjetjet e MKPT

Lidhur me këtë rekomandim, megjithëse janë bërë përpjekje për adresimin e situatës **ende nuk është arritur një zgjidhje përfundimtare**. Gjykojmë se këto masa **nuk kanë rezultuar të jenë të mjaftueshme**.

Nisur nga problematikat e evidentuara në inspektimet e MKPT-së, ka rezultuar se Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet organit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nr.897/3, datë 04.03.2019 dhe nr.2194, datë 05.03.2019 “*Për transferimin në IEVP të të paraburgosurve/paraburgosurve me masën e sigurisë “paraburgim” dhe të dénuarve me burgim me një vendim të formës së prerë në mungesë, duke rritur sigurinë e IEVP-ve dhe duke sigruar të burgosurit dhe të paraburgosurit që trajtohen me leje dhe gjatë shoqërimit të tyre*” (si angazhim i Qeverisë Shqiptare për zbatimin e rekomandimit të KPT-së), **nuk zbatohet rregullisht**, sa për shkak të **vonesës të përgjigjes nga DPB**, po aq dhe të **problematikave që paraqiten në mungesat e një dokumentacioni** të plotë, të personave që transferohen nga komisariatet e policisë për në IEVP.

Ky shqetësim, është evidentuar edhe në takimet e zhvilluara midis Avokatit të Popullit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Gjithashtu, Komisioneri i MKPT-së në takimin e zhvilluar në datën 10 Qershor 2021 me Drejtorin e Departamentit për Rendin dhe Sigurinë Publike në Policinë e Shtetit, në lidhje me përditësimin e informacionit midis DPSH dhe DPB, si dhe gjetjen e zgjidhjes që do të eliminonte vonesat për transferimin brenda një afati sa më të shkurtër të

personave të pajisur me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente nga mjediset e policisë për në IEVP. Avokati i Popullit lidhur me këtë shqetësim, ka rekomanduar dixhitalizimin e procedurës shkresore midis strukturave të policisë së shtetit dhe DPB, si mjetin e vetëm për të shkurtuar afatet dhe eliminuar vonesat në transferimin e këtyre personave, me qëllim garantimin e të drejtave që janë të sanksionuara për këta persona.

## ***II.2 Abuzimit fizik ose psikologjik të personave të ndaluar/arrestuar***

### **a. Rekomandim i KPT**

KPT ka rekomanduar që personeli policor të jetë i informuar dhe të mbahet rregullisht në vëmendjen e tij se të gjitha format e abuzimit fizik ose psikologjik të personave të ndaluar/arrestuar janë të kundërligjshme dhe të dënueshme me ligj. Ata nuk duhet të përdorin më shumë forcë sesa është e nevojshme në arrestimin, kryerjen e kontrolleve, prangat nuk duhet të bëhen duke i shtrënguar ato më shumë sesa masa e domosdoshme dhe duhet të mbahen për aq kohë sa janë të domosdoshme. Të dyfishohen përpjekjet për të luftuar keqtrajtimin nga ana e policisë, si dhe rastet e mundshme të keqtrajtimit, të jenë objekt i një hetimi të organeve të prokurorisë me pasojë ndëshkimin e oficerëve të policisë të cilët janë përgjegjës për aktin.

### **b. Përgjigja zyrtare**

Përgatitur dhe dërguar për njohje dhe zbatim të strukturave qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit disa akte të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit:

- Letër urdhëruese - nr. 6104/3, datë 02. 09.2019 “*Për njohjen e kallëzimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit*”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke paraqitur konstatimet e bëra nga KPT delegimin dhe caktimin e tyre për zbatimin dhe respektimin e rekomandimeve të KPT-së.
- Térheqja e vëmendjes nr. 5669/2, datë 15.08.2016 “*Për respektimin e të drejtave të njeriut gjatë përdorimit të forcës në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore nga ana e Policia e Shtetit*”.
- Për shkelje të të drejtave të njeriut (si ndalimi i paligjshëm, përdorimi i paligjshëm i forcës, etj.), për punonjësit e policisë rekomandohen masat e mëposhtme disiplinore<sup>72</sup>:

---

<sup>72</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 9-10.

### **Për 2017:**

Përjashtim nga Policia	<b>5</b>
Zgjatja e afatit të promovimit deri në 2 vjet	<b>13</b>
Rekomandohet për masë të lehtë	<b>7</b>
Masat parandaluese ("Vëmendje", "Këshilla")	<b>2</b>

### **Për 2018:**

Përjashtim nga Policia	<b>2</b>
Zgjatja e afatit të promovimit deri në 2 vjet	<b>12</b>
Rekomandohet për masë të lehtë	<b>7</b>

### **Për 2019:**

Përjashtim nga Policia	<b>4</b>
Zgjatja e afatit të promovimit deri në 2 vjet	<b>13</b>
Rekomandohet për masë të lehtë	<b>7</b>
Masat parandaluese ("Vëmendje", "Këshilla")	<b>2</b>

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, si dhe drejtorët e Departamenteve të Policisë Kriminale dhe Departamentit për Sigurinë Publike, kanë tërhequr vëmendjen dhe i kanë kërkuar gjithë personelit policor që të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë vetëm dhe në bazë të ligjit dhe procedurave standarde të punës duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Pjesë e strukturave qendrore të Policisë së Shtetit janë dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale, e cila ka përgjegjësinë për evidentimin e trajtimin e të gjitha shkeljeve dhe mangësive të konstatuara apo të raportuara për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe në përfundim jep masa disiplinore deri në përjashtim nga Policia e Shtetit për punonjësit përgjegjës.

Kjo strukturë ka përgjegjësinë e kryerjes së kontrolleve dhe monitorimeve të të gjithë strukturave/shërbimeve të Policisë së Shtetit, lidhur me përbushjen e detyrave dhe përgjegjësive sipas akteve ligjore/nënligjore dhe procedurave standarde të punës të miratuara për këtë qëllim, si dhe inspektimi e kontrollës së pa planifikuara në raste të veçanta.

Drejtoria e Standardeve Profesionale, në vazhdimësi ka ndjekur, trajtuar rastet e veprimeve e mosveprimeve të punonjësve të policisë duke dhënë masat përkatëse disiplinore deri në përjashtime nga Policia e Shtetit dhe në ndjekje penale, për raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut (keqtrajtim të personave, ushtrim dhune, shoqërim i padrejtë, etj)

Për rastet kur shkelja ka elementët e një vepre penale, materiali i referohet AMP-së<sup>73</sup> për vlerësimin e fillimin e ndjekjes penale dhe treguesit në këtë drejtim duhet të merren pranë AMP-së.

Ne përkrahim dhe jemi në pritje të përfundimeve dhe hetimeve të rekomanduara në organin e prokurorisë nga MKPT-së për ankesa të administruara ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me kryerje të veprimeve arbitrale e shpërdorime të detyrës gjatë vitit 2019-2020.

Në rastet kur personat të cilët janë Objekt i shoqërimit, arrestimit apo ndalimit, në momentin e kryerjes së veprimeve policore/procedurale për shoqërimin, ndalimin apo arrestimin, kanë nën kujdesin e tyre fëmijë (nën 18 vjeç) dhe nuk ka persona të tjera që mund të kujdesen për ta (fëmijët), janë marrë masa për sigurimin e prezencës së një të afërmë/personi madhor, si dhe njoftimin/referimin e menjëhershëm të rastit pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, me qëllim lënien nën kujdes dhe marrjen e masave mbrojtëse të nevojshme për fëmijët.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

**Rekomandimi i KPT-së është zbatuar pjesërisht**, duke konsistuar vetëm në rritjen e numrit të masave disiplinore apo dërgimit për ndjekje penale të punonjësve të policisë që kanë kryer veprime abuzive në përdorimin e forcës më shumë sesa është e nevojshme në arrestimin, kryerjen e kontrolleve, apo vendosjen e prangave duke i shtrënguar ato më shumë sesa masa e domosdoshme, mbajtjen për aq kohë sa janë të domosdoshme, etj. megjithatë duhen bërë përpjekje më të mëdha për luftimin e këtij fenomeni.

Ndërkohë, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar që DPPSH duhet të ndërmarrë edhe forma të tjera alternative për trajnimin dhe përgatitjen profesionale të punonjësve të policisë, motivimin dhe mbështetjen logjistike ndaj tyre, si përsosjen e procedurave standarde të punës gjatë veprimeve të kryera, kryesisht në rastin e protestave masive të qytetarëve apo subjekteve politike apo shoqërore.<sup>74</sup>

### ***II.3 E drejta për t'u informuar gjate procesit të ndalimin/arrêtimin***

#### **a. Rekomandim i KPT**

- Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të siguruar që e drejta për t'u informuar për ndalimin/arrêtimin të garantonët në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon familjen e personit të ndaluar/arrêtuar pa vonesë.

<sup>73</sup> Më datë 20 dhjetor 2021, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, një emrëtësë që zëvendëson strukturën e SHÇBA, si pjesë e paketës ligjore për reformimin e strukturave të sigurisë.

<sup>74</sup>Për më shumë Konsulto:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20parimit%20ligjor%20t%C3%AB%20proporcionalitetit%20kur%20p%C3%ABrdoret%20forc%C3%AB%20fizi%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20kontrolluar%20sjelljen%20e%20protestuesve.pdf>

- Është rekomanduar që oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluar/të arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasin me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë të drejtë.

### **b. Përgjigjja zyrtare**

Në Letër urdhëruese - nr. 6104/3, datë 02. 09.2019 “*Për njohjen e kallëzimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit*”, e gjithë vëmendja i është tërhequr strukturave vendore të policisë dhe u është kërkuar që: të njoftojë anëtarët e familjes / të afërmit / kujdestarët ligjorë për faktin e arrestimit / ndalimit të një personi në momentet e para të privimit të lirisë, në bazë të nenit 255/4 të Kodit Penal.<sup>75</sup>

Në Letër urdhëruese - nr. 6104/3, datë 02. 09.2019 “*Për njohjen e kallëzimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit*”, e gjithë vëmendja i është tërhequr strukturave vendore të policisë dhe u është kërkuar që:

- Të garantojnë të drejtën për mbrojtjen me avokat për personat e privuar nga liria, për sigurimin në kohë të mbrojtësit të përzgjedhur dhe praninë e tij në rrjedhën e procedurës përmarrjen në pyetje të të ndaluarve/arrêtuarve të parashikuar në KPP.<sup>76</sup>

### **c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës**

Në përgjithësi nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore, bëhet njoftimi në lidhje me arsyet e ndalimit/arrêtimit si dhe njohja me listën e të drejtave që gjëzojnë personat e ndaluar/arrêtuar. Për këtë qëllim, Policia e Shtetit, ka formatuar, prodhuar dhe aplikon njohjen e të drejtave përmarrjen në cilën janë pasqyruar të gjitha të drejtat kushtetuese dhe ligjore që kanë, që prej muajit Korrik 2011.

Një kopje e formatit/deklaratës të shkruar me të drejtat që u njeh ligji në këtë fazë u jepet personave të ndaluar/arrêtuar.

Formati/deklarata e të drejtave përvëç gjuhës shqipe është prodhuar dhe në disa gjuhë të tjera të huaja si: angleze, italiane, gjermane, sllovene, serbe, greke, franceze, rumune dhe rome.

Shërbimet e policisë të strukturave vendore, kanë detyrimin që përmalimin/arrêtimin e personit të vënë në dijeni menjëherë familjarët apo persona të tjerë të zgjedhur prej tij, duke u komunikuar

---

<sup>75</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 10-11.

<sup>76</sup> Po aty.

arsyen e masës së marrë dhe vendndodhjen e personit. Kjo realizohet nëpërmjet telefonit ose komunikimit të drejtpërdrejtë që kryhet me familjarët nga ndihmës specialisti për policimin në komunitet, specialisti për krimet dhe ndihmës specialisti për krimet.

Për të gjitha veprimet procedurale që kryhen nga policia gjyqësore me personat që arrestohen/ndalohen, ata janë nën kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të prokurorit të çështjes i cili vihet në dijeni menjëherë për ngjarjen e ndodhur dhe jep detyra dhe kontrollon zbatimin e tyre në raport me sigurimin e mbrojtësit dhe pjesëmarrjen tij gjatë intervistimit dhe akteve të tjera procedurale.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk është mjaftuar vetëm me hartimin e shkresave (urdhra, letër porosi, tërheqje vëmendje, etj) por këto i ka kombinuar me planifikim dhe kryerje të kontrolleve ndaj strukturave vendore të Policisë së Shtetit si nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, Departamentet në D. P.P Shtetit, etj.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Ky rekomandim nuk është reflektuar në praktikën që ndjekin punonjësit e policisë me personat e shoqëruar në mjediset e policisë. Rekomandimi i KPT-së, në përbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet tu jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Kjo, pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 10 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë apo kanë të drejtë për njoftimin e familjarëve të tyre, e drejta për qasje me avokat mbrojtës, etj.

Karta me të drejtat jepet vetëm në momentin kur i ndaluari/arrestuari merret në pyetje nga OPGJ dhe hyn në dhomat e sigurisë. Avokati i Popullit ka rekomanduar pajisjen me këtë kartë në momentin e hyrjes në ambiente dhe po e monitoron këtë praktikë në vijim në inspektime dhe rekomandime përkatëse prej 2 vitesh.

Në raportin e KPT-së nga vizita inspektuese në Shqipëri në muajin nëntor të vitit 2018, kanë qenë në fokusin e takimit të Avokatit të Popullit dhe Drejtorit e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit që u zhvillua në datë 25.02.2022. Ndër të tjera në takim, u diskutua për garantimin e të drejtave të njeriut në këndvështrimin e organeve ligjzbatuese, si dhe bashkëpunimin e frytshëm në lidhje me kryerjen e inspektimeve nga MKPT në ambientet e privimit të lirisë së shtetasve në Policinë e Shtetit, duke u ndalur veçanërisht në standardet që duhet të respektohen nga strukturat dhe punonjësit e policisë, sipas rekomandimeve të lëna në raportin e fundit nga KPT-ja për Shqipërinë.

#### ***II.3.1 vijim i kësaj pike***

##### **a. Rekomandim i KPT**

Sigurohuni që personat e arrestuar/arrêtuar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të tyre nga liria, duke siguruar informacione të qarta verbale rrëth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë në fillim të ndalimit ose arrestimit. Personave të arrestuar/ndaluar duhet t'u jepet dhe të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se kanë marrë një kopje të fletës me të drejtat e tyre.<sup>77</sup>

### **b. Përgjigja zyrtare**

Në Letër urdhëruese - nr. 6104/3, datë 02. 09.2019 “Për njohjen e kallëzimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit”, e gjithë vëmendja i është tërhequr strukturave vendore të policisë dhe u është kërkuar që:

- të njoftojë familjarët/të afërmit/kujdestarët ligjorë për faktin e arrestimit/ndalimit të një personi në momentet e para të heqjes së lirisë, në zbatim të nenit 255/4 të Kodit Penal.

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Këto rekomandime kanë vazhduar të zbatohet nga Policia e Shtetit që në vitin 2012, në zbatim të rekomandimeve të KPT-së dhe zbatohet dhe aktualisht pa hezitim.

Për këtë qëllim është formatuar dhe miratuar një format i shkruar me të gjitha të drejtat që kanë personat e privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit (deklarata e të drejtave të personave të arrestuar/ndaluar), e cila pasi i bëhet me dije personit në fjalë, ai e nënshkruan atë që mori dijeni dhe i jepet një kopje të cilën duhet ta mbajë me vete gjatë kohës së qëndrimit në ambientet e policisë.

Kopja e dytë e nënshkruar nga personi mbahet dhe administrohet nga personeli i shërbimit policor që kryen detyra për trajtimin dhe sigurimin e këtyre personave. Në praktikë ka ndodhur shpesh që personat dëmtojnë dhe grisin kopjen e deklaratës së të drejtave të tyre.

Nuk kemi konstatuar raste që personave të arrestuar/ndaluar të mos u jetë dhënë kopje e deklaratës së të drejtave të tyre. Deklarata u është vënë në dispozicion edhe në disa gjuhë të huaja.

### **d. Gjetjet e MKPT**

---

<sup>77</sup> Në lidhje me këto dy rekomandime jeni shprehur se me anë të shkresës nr. 6104/3, datë 02.09.2019, “Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit” është tërhequr vëmendja e të gjitha strukturave vendore të policisë dhe i është kërkuar sigurimi i informacionit verbal të qartë dhe të plotë në lidhje me të drejtat e tyre, që nga momenti i parë i privimit të lirisë, plotësimi dhe sigurimi i një kopje të formularit/deklaratës me shkrim me të drejtat dhe nënshkrimin e tyre pas njohjes.

Në inspektimet tematike e periodike të kryera nga MKPT në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të Policisë së Shtetit, si dhe intervistat e zhvilluara me personat e shoqëruar, kemi konstatuar se, në përgjithësi njohja me të drejtat e personave që shoqërohen në mjediset e komisariateve të policisë, **nuk bëhet nga punonjësit e policisë që në momentet e para kur ju privohet liria**, por bëhet vetëm në momentin kur i ndaluari/arrêtuar merret në pyetje nga OPGJ. Në ambientet e privimit të lirisë të drejtat janë të afishuara në ambiente të ndryshme të Komisariateve, por jo në vende që të konsultohen nga të shoqëruarit lehtësisht. E drejta për informimin e personave të arrestuar/ndaluar që në momentet e para të shoqërimit, nuk është e parashikuar gjithashtu edhe në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, gjë e cila bie ndesh me rekomandimin e KPT-së që thekson nevojën për informimin e personave rrëth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të arrestimit ose ndalimit të tyre, pra në momentin kur hyjnë në mjediset e Policisë së Shtetit. Për zbatimin e këtij rekomandimi, **MKPT thekson nevojën që Karta e të Drejtave** duhet t’ju jepet personave të shoqëruar ose të arrestuar/ndaluar, që në momentin e parë të privimit të lirisë kur ata hyjnë në mjediset e policisë së shtetit dhe vendosjen e këtij standardi në rregullat e parashikuara në procedurat standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Ky rekomandim nuk është zbatuar plotësisht.

## ***II.4 Ekzaminimi mjekësor fillestar i personave të ndaluar/arrêtuar***

### **a. Rekomandim i KPT**

Autoritetet shqiptare të marrin masa për:

- a. Të sigurohet zbatimi i dispozitave të përcaktuara në manual/procedurë për trajtimin dhe sigurimin e të paraburgosurve/arrêtuarve për kryerjen me rigorozitet të ekzaminimit mjekësor fillestar të personave të ndaluar/arrêtuar, duke marrë parasysh vëzhgimet e mësipërme.
- b. Të sigurojë që të gjitha ekzaminimet mjekësore të personave të arrestuar/ndaluar të jenë të kryera pa praninë dhe jashtë dëgjimit të oficerëve të policisë, përveç rasteve kur është kërkuar nga personeli mjekësor.
- c. Udhëzime, dhënia e sqarimeve dhe kryerja e trajnimeve me personelin e kujdesit mjekësor policor në kryerjen e vizitave, identifikimin/regjistrimin e dëmtimeve fizike dhe raportimin e tyre pranë organit të akuzës për trajtim të mëtejshëm procedural.

### **b. Përgjigjja zyrtare**

Në Letër urdhëruuese - nr. 6104/3, datë 02. 09.2019 “Për njohjen e kallëzimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të

*privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit*”, e gjithë vëmendja i është tërhequr strukturave vendore të policisë dhe u është kërkuar që:

- Kryerja dhe dokumentimi i vizitave mjekësore në dosjen përkatëse dhe përpilimi i procesverbalit që përmban:

- Një llogari e gjetjeve objektive mjekësore, bazuar në një ekzaminim të plotë të lëndimeve traumatike dhe mundësishët të fotografuara;

- Një llogari e deklaratave të bëra nga personi i ekzaminuar për rrethanat që i shkaktuan lëndime, ankesa dhe pretendime për keqtrajtim;

- Vëzhgimet e mjekut për gjetjet dhe deklaratat e të dëmtuarit, duke treguar konsistencën midis çdo pretendimi të bërë dhe gjetjeve objektive mjekësore.

- Rastet e konstatimit të lëndimeve/keqtrajtimit të cilat janë në përputhje me deklaratat e të dëmtuarit duhet t'i dërgohen organit të akuzës, në bazë të nenit 282 të Kodit Penal, pavarësisht kundërshtimeve të të dëmtuarit.

- Kryerja e vizitave mjekësore pa praninë dhe pa dëgjimin e punonjësve të policisë, përvçe nëse kërkohet nga personeli mjekësor.
- Trajnim i temën “*Parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit të të ndaluarve/të paraburgosurve nëpërmjet shërbimit shëndetësor*” u krye me personelin mjekësor Drejtori të së Policisë Vendore dhe Qendrës së Mbyllur për të Huajt në Kufi dhe Departamentin e Migracionit.<sup>78</sup>

### c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës

Ky rekomandim zbatohet në praktikë nga personeli mjekësor i policisë, i cili njeh dhe bën përpjekje për zbatimin korrekt të rregullave dhe procedurave standarde për kryerjen e vizitave mjekësore menjëherë pas ndalimit/arrestimit: Procedura standarde ”Për trajtimin, sigurimin e të arrestuarve/ndaluarve dhe trajtimi e zgjidhja e kërkësë ankesave të tyre në ambientet e Policisë së Shtetit”, miratuar së fundmi me urdhrin nr. 925, datë 18.07.2020 të D.P.P.Shtetit.

Po kështu personelit mjekësor i janë sjellë në vëmendje të gjitha konstatimet, gjetjet dhe arsyetimet e shtjelluara në Raportin e KPT-së të vitit 2019, duke vënë fokusin në evidentimin e rasteve të dëmtimeve fizike, mënyrën e dokumentimit, sjelljen e rastit në vëmendje të organit të hetimit dhe AMP-së për verifikimin e trajtimin e rastit, etj.

Kjo procedurë nuk është anashkaluar në asnjë rast. Në këtë drejtim Policia e Shtetit ka hasur vështirësi në disa struktura vendore për arsyen e mungesës së personelit mjekësor të nivelit

<sup>78</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 11-12.

mjek/specialist. Në këto raste kryerja e kontrolleve e vizitave mjekësore kryhet në shërbimin mjekësor të Urgjencës në qëndrën apo rajonin përkatës.

Në këtë drejtim, në muajin Dhjetor 2019 me gjithë personelin mjekësor policor u zhvillua një trajnim një ditor me tematikë kryerjen e vizitave mjekësore, evidentimi i dëmtimeve fizike (shenja dhune/keqtrajtime) dhe sjellja në vëmendje pa vonesë organeve të hetimit për sqarimin e nxjerrjen e përgjegjësisë dhe rr Ethanave të shkaktimit të dëmtimit fizik.

Ky trajnim u zhvillua nga Akademia e Sigurisë në bashkëpunim dhe me Byronë e Mjekësisë Ligjore në QSUT "Nënë Tereza", Tiranë.

#### e. Gjetjet e MKPT

Vlerësojmë se informacioni i dërguar nuk është shterues. MKPT konstaton se, **nuk është krijuar një protokoll i veçantë shëndetësor** dhe se vlerësimi i këtyre aspekteve (në procedurën standarde) nuk është i mjaftueshëm.

Në përgjigjen e DPPSH-së nuk evidentohet fakti nëse është ngritur apo jo një mekanizëm efektiv verifikues dhe raportues mbi mënyrën se si zbatohet ky rekomandimi KPT-së, si dhe nuk ka informacion të detajuar në lidhje me raste apo raportime që evidentojnë se kjo procedurë është anashkaluar, apo veprimet verifikuuese dhe sankzionet të cilat mund të jenë marrë nga autoritet përgjegjëse.

Gjithashtu, evidentojmë se në mjaft raste kemi ankesa për cilësinë e shërbimit mjekësor, dhe ka mungesa të personelit mjekësor pranë drejtive/komisariateve të policisë që kanë ambiente sigurie, siç dhe raportohet nga vetë DPSH.

Kjo situatë u evidentua dhe në takimin e zhvilluar nga Avokati i Popullit me Drejtuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, më datë 25 Shkurt 2022 por edhe në Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit 2020 dhe 2021.<sup>79</sup>

Rekomandimi mbetet i pazbatuar.

### ***II.5 Ambientet e Komisariateve të Policisë në Elbasan dhe Mat***

#### a. Rekomandim i KPT

- Merrni hapa urgjent që:

---

<sup>79</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-757/>

- qelitë/dhomat e sigurisë të mbahen në gjendje të pranueshme, të kenë ndriçimin e duhur përfshirë dritë natyrale dhe ajrim/ventilim.
  - që të ruhet higjena dhe pastërtia në tualetet dhe ambientet e tjera të dhomave të sigurisë.
  - të sigurohen mjete dhe pajisje për të garantuar ngrohjen në dimër në dhomat e sigurisë ku mbahen të ndaluarit/arrêtuar nga policia.
  - të sigurohet dhoma e personave të ndaluar/arrêtuar, përfshirë ato për gratë e paraburgosura me materiale bazë të higjienës personale.
- b) Vëmendje dhe përparësi e veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të projekteve/planeve për ndërtimin e ndërtesës/bllokut të dhomave të sigurisë për të paraburgosurit/arrêtuarit në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, për të cilat kërkohet informacion mbi kohën e fillimit të punës, përfundimit dhe hapjes/funksionimit të këtij objekti.
- c) Deri në përfundimin dhe funksionimin e këtij objekti, ambientet e dhomave të sigurisë në komisariatet e polisë nr. 1, 2, 3, 5 në Tiranë të riparohen dhe të mirëmbahen në gjendje të pranueshme pastërtie dhe të ndriçohen mjafthueshmë.
- d) Personat të arrestuar/ndaluar të mos mbahen në ambiente/dhoma që janë më pak se  $5\text{m}^2$ .
- e) Dhoma/zona sigurie prej  $6\text{-}8\text{ m}^2$  të përdoren vetëm për një person.
- f) Të zgjidhet situata në Komisariatin e Polisë Mat për të pajisur dhomën e paraburgimit me mobilje dhe pajisje të nevojshme për të lejuar qëndrimin ulur të personave të akomoduar aty.<sup>80</sup>

### **b. Përgjigjja zyrtare**

Në Letër urdhëruese - nr. 6104/3, datë 02. 09.2019 “Për njohjen e kallëzimit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Polisë së Shtetit”, e gjithë vëmendja i është tërhequr strukturave vendore të polisë dhe u është kërkuar që:

---

<sup>80</sup> Në lidhje me këtë rekondim të KPT-së jeni shprehur se me anë të shkresës nr. 6104/3, datë 02.09.2019, “Për njohjen e raportit dhe zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të KPT-së për respektimin dhe garantimi i të drejtave të personave të privuar nga liria në mjediset e Polisë së Shtetit”.

Është tërhequr vëmendja e të gjitha strukturave vendore të polisë dhe i është kërkuar marrja dhe zbatimi i masave si më poshtë:- Sigurimi dhe vënia në dispozicion e personave të arrestuar/ndaluar të mjeteve të higjienës personale dhe produkteve të tillë si sapunë, detergjentë, lecka pastrimi dhe kova, peshqirë sanitare për gratë, larje në ujë të nxehëtë, etj.- Krijimi i kushteve minimale për ajrosjen dhe ndriçimin natyror në ambientet e dhomave të sigurisë së komisariateve nr. 1, 2, 3, 5 Tiranë, Shkodër, Dibër, Mat, Elbasan, Vlorë dhe Sarandë, duke ndërhyrë dhe zgjeruar sigurinë e dritareve të dhomave të sigurisë, me standarde miratuarë për këtë qëllim.- Mosmbajta e personave të arrestuar/ndaluar në dhoma me sipërfaqe më pak se  $5\text{m}^2$  dhe mosmbajta e më shumë se një personi në përmasat  $5\text{-}8\text{m}^2$ .- Përfundimi i dhomave të paraburgimit me pajisjet dhe orënditë e nevojshme për uljen e qytetarëve në Komisariatin e Polisë dhe njësitë e tjera poliore ku ekzistojnë mangësi të tillë.

- Sigurimi dhe vënia në dispozicion të personave të arrestuar/ndaluar të produkteve të higjienës personale dhe produkte të tilla si sapunë, detergjentë, copa pastrimi dhe kova, peshqirë higjenike për femra, larje me ujë të nxeh të etj.
- Krijimi i kushteve minimale për ajrim dhe ndriçim natyral në ambientet e dhomave të sigurisë të Komisariateve nr. 1, 2, 3, 5 Tiranë, Shkodër, Dibër, Mat, Elbasan, Vlorë dhe Sarandë, duke ndërhyrë dhe zgjeruar sigurinë e dritaret e dhomave të sigurisë, me standardet e miratuara për këtë qëllim.
- Të mos mbajnë persona të arrestuar/ndaluar në dhoma më pak se  $5m^2$  dhe në përmasa prej  $5 - 8m^2$  të mos mbahet më shumë se një person.
- Kompletimi i dhomave të paraburgimit me pajisjet dhe orenditë e nevojshme për uljen e qytetarëve në Komisariatin e Policisë dhe njësitë e tjera policore ku të tilla objekte mungojnë.
  - Lidhur me përfundimin e ndërtimit të godinës/bllokut të sigurisë dhomat për të arrestuarit/ndaluarit D.V.P Tiranë, sqarojmë se:
  1. Është nënshkruar Kontrata Nr.1412 datë 14.08.2019 me operatorin ekonomik “HASTOCI” sh.p.k. për ndërtimin e zonës së sigurisë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.
  2. Është miratuar prishja e objektit ekzistues për kuzhinën dhe magazinën në ish Komisariatin nr.3, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë sipas Urdhrit Nr.563, datë 31.10.2019, ku do të ndërtohet ambienti i sigurisë.
  3. Ka përfunduar prishja e objektit ekzistues, trualli është niveluar nga kompania zbatuese dhe disa materiale ndërtimi të nevojshme për fillimin e punimeve janë vënë në dispozicion.
  4. Afati i përfundimit të punimeve do të varet nga ecuria e punës së firmës zbatuese.
  5. Afati i përfundimit të punimeve sipas kontratës së lidhur me Operatorin Ekonomik është 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës.
    - Janë të myllura, të vulosura dhe të papërdorura për mbajtjen dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar dhomat që janë më pak se  $5 m^2$ , në Komisariatin nr. 1, 2, 3 në Tiranë.

Mbyllja është bërë me urdhrin nr. 1010, datë 14.08.2019 “*Për Ndalimin e mbajtjes dhe trajtimin e personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrêtuar në ambientet me sipërfaqe të pamjaftueshme dhe kushte të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme*”, nga Prokuroria e Shtetit.

Në zbatim të këtij urdhri janë myllur këto dhoma në ambientet e dhomave të sigurisë:

  - Në Komisariatin nr. 1, 2 (dy) dhoma janë të myllura.
  - Në Komisariatin nr. 2, 2 (dy) dhoma janë të myllura.
  - Në Komisariatin nr. 3, 1 (një) dhomë është e myllur.

- Departamenti i Sigurisë Publike, në përputhje me rekomandimet e Delegacionit të KPT-së në raportin e vizitës në vendin tonë në nëntor 2018; raportet dhe rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2019, hartuar, miratuar dhe dërguar për zbatim tek të gjitha strukturat e policisë qendrore dhe vendore:
- Programi i punës nr. 5949, datë 09.07.2019 “*Për plotësimin e rekomandimet e rapportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019, rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komitetit Evropian Kundër Torturës (KPT) për përmirësimin e trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit*”. Ky program është ende duke u zbatuar dhe ndjekur nga strukturat e Policisë së Shtetit.<sup>81</sup>

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

#### **Për Komisariatin e Policisë Elbasan**

- Me fonde të buxhetit të shtetit, është hartuar projekt i përgjegjësuar për rikonstruksionin dhe ndërtimin e godinave të D.V.P dhe Komisariatit të Policisë Elbasan dhe pritet lëvrimi i fondeve për realizimin e investimeve gjatë vitit 2021, vlerë e cila shkon në shumën 286.266 lekë.
- hartimi i projekteve për ndërtimin e funksionimin e dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit është bërë sipas kushteve, parametrave dhe standardeve më të përparuara të vendeve të BE-së.
- është bërë zëvendësimi i menjëhershëm i materialeve të fjetjes në dhomat e sigurisë me materiale te reja si, dyshek e batanije, si dhe është në proces marrja e masave për sigurimin dhe pajisjen me krevat fjetje të dy dhomave të rekomanduara.
- ambientet e dhomave të sigurisë në vazhdimësi janë lyer, dezinfektuar dhe higjienizuar dhe këto ambiente janë pajisur dhe me çertifikatën përkatëse nga strukturat shëndetësore.
- janë në proces zbatimi disa masa për eliminimin e lagështisë në dhomat e sigurisë, masa të cilat nuk mund të jepin efektivitetin e duhur për shkak të vjetërsisë dhe amortizimit që ka kjo godinë pasi është ndërtim i vitit 1960.
- tualeti i dhomave të sigurisë është i pajisur me të gjitha pajisjet dhe aksesoret që nevojiten për një tualet në dhomat e sigurisë, si dhe është bërë zëvendësimi i kokave të dushit dhe janë funksionale.
- dhoma e vizitave mjekësore që ndodhet në ambientet e dhomave të sigurisë, është pajisur me medikamentet e nevojshme mjekësore sipas kërkësave dhe nevojave të paraqitura nga

<sup>81</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 13-14.

personeli mjekësor i D.V.P Elbasan, si dhe është në proces sigurimi i një frigoriferi në funksion të shërbimit mjekësor.

- po kështu, çdo raport/rekomandim i dërguar nga institucioni i Avokatit të Popullit për vizitat e inspektimet e kryera në D.V.P/Komisariatet e Policisë, u bëhet me njohje strukturës/njësisë vendore të policisë të inspektuar si dhe strukturave qëndrore përgjegjëse, ku këto të fundit përcaktojnë dhe detyrat që duhet të kryhen për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Ju informojmë se fondi për projektin për "Rikonstruksionin /Ndërtimin e objekteve të Drejtorisë dhe Komisariatit të Policisë Elbasan" i cili përfshin rikonstruksionin e objekteve ekzistuese dhe ndërtimin e një objekti të ri për Drejtorinë si dhe sistemimin e të gjithë territorit, është lëvruar. Drejtori i Përgjithshme i Policisë së Shtetit me Autorizimin nr. 8346 datë 19.11.2021 ka autorizuar projektuesin për aplikim dhe ndjekje të procedurave për sigurimin e lejes së ndërtimit.

Zbatimi i projektit parashikohet te fillojë menjëherë pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe lidhjes së kontratave dhe parashikohet të zgjasë 24 muaj.

Procedura e prokurimit për shpalljen e operatorit ekonomik fitues ende nuk ka përfunduar, pasi nuk ka kaluar ende afati i ankimimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 162/2020, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik".

### **Për Komisariatin e Policisë Mat, në D.V.P Dibër**

Është i pamundur realizimi i investimeve për ndërtimin apo rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese të dhomave të sigurisë, dhomave të shoqërimit dhe ambienteve të tjera sipas kushteve dhe standardeve të kërkua të arsyesh të mungesës të fondevit financiare në zërin "Investime".

Financimi i kryerjes së Studim-Projektimit për rikonstruksionin e Komisariatit të Policisë Mat, në të cilin përfshihen dhe ambientet e dhomave të sigurisë dhe shoqërimit, është parashikuar në vitin 2022 (mbi limit). Aktualisht jemi në fazën e përgatitjes se dokumentacionit teknik.

Nuk janë realizuar investime në Komisariatin e Policisë Mat për ndërtimin apo rikonstruksionin e ambienteve. Nga muaji Tetor 2021, ka filluar ndërtimi/rikonstruksioni i objekteve te Drejtorisë se Policisë Dibër, projekt i cili është në zbatim dhe afati i implementimit sipas kontratës është 24 muaj. Puna ka vijuar sipas Grafikut të punimeve dhe parashikohet të përfundojë brenda afatit.

### **Në lidhje me ambientet e D.V.P Tiranë**

- Është në proces ndërtimi i ambienteve të dhomave të sigurisë për DVP Tiranë, ci cili pritet të përfundojë gjatë vitit 2021 dhe do të akomodojë gjithë personat e ndaluar/arrêtuar të kësaj njësie poliore.

- Pas përfundimit të ndërtimit të godinës së re të dhomave të sigurisë do të bëhet e mundur mos mbajtja e personave të arrestuar/ndaluar në komisariatet e policisë nr. 1, 2, 3 dhe 5 Tiranë.
- Ambientet ekzistuese për të arrestuarit/ndaluarit në komisariatet e policisë nr. 1, 2, 3, 5 do të rikonstruktohen dhe do të vihen në funksion për dhoma shoqërimi sipas kushteve dhe standardeve të kërkua (për femra, të mitur dhe persona madhorë).
- Është zbatuar plotësisht rekomandimi i KPT-së për mos mbajtjen e personave të arrestuar/ndaluar në ambiente/dhoma që janë nën kubaturën dhe sipërfaqen minimale, më pak se 5 metër katror, në komisariatet e policisë nr. 1, 2 dhe 3 në DVP Tiranë. Mbyllja dhe mos përdorimi i këtyre dhomave është bërë me urdhër të veçantë të D.P.P. Shtetit.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Avokati i Popullit me keqardhje vëren se niveli i zbatimit të këtij rekomandimi edhe pas 4 vitesh mbetet i ulët, kjo sipas gjetjeve tona kryesore mbi bazën e inspektimeve periodike.

Ndërkohë që sipas informacionit të DPPSH dhe në takimin e zhvilluar më datë 25 Shkurt 2022, me përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u evidentua dhe njëherë se **rekomandimi KPT-së nuk është realizuar**. Situata paraqitet si më poshtë vijon:

- ka përfunduar faza e projektit për rikonstruksionin dhe ndërtimin e godinave të DVP dhe Komisariatit të Policisë Elbasan, por ende dhe për vitin buxhetor 2022 **nuk** janë lëvruar fondet për kryerjen e këtij investimi.
- në DVP Dibër ka filluar të zbatohet projekti për ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinës të Drejtorisë dhe Komisariatit të Policisë Dibër, ku përfshihet edhe ndërtimi i dhomave të reja të shoqërimit dhe dhomave të sigurisë.
- sa i takon, Komisariatit të Policisë Mat aktualisht nuk është realizuar investimi për ndërtimin apo rikonstruksionin e ambienteve ekzistuese të dhomave të sigurisë, dhomave të shoqërimit dhe ambienteve të tjera, as për vitin 2022.
- Ambientet e dhomave/blllokut të sigurisë për DVP Tiranë, i cili pritej të përfundonte në muajin Dhjetor të vitit 2021 (sipas kontratës të DPSH me subjektin kontraktues)<sup>82</sup> dhe do të akomodonte të gjithë personat e ndaluar/arrêtuar të komisariateve të policisë në varësi të DVP,

---

<sup>82</sup> Kontrata nr.1412, datë 14.08.2019 mes DPSH dhe operatorin privat “HASTOCI” shpk, për ndërtimin e zonës së sigurisë në LPD Tiranë.

Tiranë, nga inspektimi i kryer nga Avokati i Popullit pranë kësaj godine rezulton se këto dhoma nuk janë marrë në dorëzim dhe nuk janë vënë në funksion<sup>83</sup>.

- në lidhje me mbylljen e dhomave të sigurisë, në komisariatet e policisë nr.1,2,3 dhe 5 në DVP Tiranë, të cilat nuk plotësojnë parametrat teknikë dhe jetësor për mbajtjen e një dhe më shumë personave, Komiteti European për Parandalimin e Torturës (KPT) ka rekomanduar “*Krijimin e kushteve minimale për ajrim dhe ndriçim natyror në ambientet e dhomave të sigurisë. Të mos ketë persona të arrestuar/ndaluar në dhoma të sigurisë me sipërfaqe jo më pak se 5m<sup>2</sup>, dhe mos të mbajnë më shumë se një person në dhomë*”<sup>84</sup>. Kjo situatë është evidentuar edhe në inspektimet periodike të zhvilluara nga Mekanizimi Kombëtar (MKPT) dhe në përfundim të tyre ka adresuar rekomandime përkatëse DPSH dhe DPV Tiranë me qëllim përmirësimin e kësaj situate, si dhe mundësimin e një qëndrimi dinjitoz për personat e ndaluar/arrestuar në këtë institucion<sup>85</sup>. Konkretisht situata e dhomave të sigurisë në komisariatet e policisë në Tiranë paraqitet si më poshtë vijon:
- në zbatim të këtij rekomandimi, Komisariatit të Policisë nr.1, Tiranë me shkresë nr.1494/1 prot., datë 12.03.2021 drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, bën me dije se janë marrë masat duke mbyllur 2 (dy) dhoma sigurie të cilat nuk përbushnë kushtet kubike për qendrimin e personave të ndaluar/arrestuar<sup>86</sup>. Ndërkohë në inspektimin e kryer nga MKPT në Komisariatin e Policisë nr.1, në lidhje me zbatimin e rekomandimit të KPT-së për mbylljen e dhomave të sigurisë që nuk plotësojnë parametrat teknik dhe jetësor, rezultoi se këto dhoma ishin të hapura dhe funksionale. Në përfundim të këtij inspektimi, **MKPT rekomandoi**<sup>87</sup> **në mënyrë të përsëritur**, mbylljen e menjëherëshme të dhomave ekzistuese të sigurisë. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Komisariati i Policisë nr.1 me shkresë nr.1050/1 prot., datë 01.03.2022 drejtuar Avokatit të Popullit na informon se, janë marrë masa të menjëherëshme për mbylljen e dhomave të sigurisë pasi nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret që garantojnë trajtim njerëzor dhe dinjitoz të personave të arrestuar/ të ndaluar. Avokati i Popullit në kuadër të monitorimit të protestave qytetare të zhvilluara në Tiranë në datat 9 dhe 10 mars 2022 e në vijim, inspektoi dhe ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë ku qëndronin shtetasit në mjediset e drejtorisë dhe komisariateve të policisë në Tiranë. Grupi i ekspertëve që inspektoi mjediset në Komisariatin e Policisë nr.1, konstatoi se,

<sup>83</sup> Nga vizita inspekuese në bllokun/godinën e sigurisë në muajin Janar 2022 e Avokatit të Popullit, Komisionerit të MKPT-së dhe Drejtoret të DVP Tiranë u konstatua se, investimi ka përfunduar por kanë nevojë edhe disa elemente shtesë sigurie dhe të fillojë funksionimi i plotë i saj.

<sup>84</sup> Në zbatim të këtij rekomandimi të KPT, me urdhërin nr.1010, datë 14.08.2019 të DPP së Shtetit në Komisariatin e Policisë nr.1, Tiranë, duhet të ishin mbyllur 2 dhoma sigurie.

<sup>85</sup> Rekomandim nr.K4/I15-2 prot., date 08.02.2019;

Rekomandim nr.K4/I80-2 prot., datë 11.05.2020;

<sup>86</sup> Procesverbal nr.846-B prot., datë 07.07.2020 “Mbi mbylljen e një dhoma në ambientet e sigurisë të Komisariatit nr.1, Tiranë”.

<sup>87</sup> Rekomandim nr. K4/I4-2 prot., datë 02.02.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së në mbylljen e dhomave të sigurisë që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret teknikë dhe jetësor”.

dhomë e sigurisë ishte e hapur dhe në të ishin akomoduar shtetas në bazë të urdhërave për arrestimin e tyre të lëshuara nga OPGJ, për dyshime në kryerjen e disa veprave penale sipas dispozitave të parashikuara në nenet 262, 271 dhe 293 të Kodit Penal. Ky konstatim, përbën shkelje të rëndë të të drejtave të personave të arrestuar, si dhe tregues i qartë i moszbatimit të rekomandimit të KPT-së dhe Avokatit të Popullit, për mbylljen e dhomave të sigurisë në këtë komisariat. Njëkohësisht, ky rast është edhe mungesë serioziteti në komunikimin e drejtuesve të policisë të këtij Komisariati me institucionin e Avokatit të Popullit, ku ka një diskordancë midis asaj që informohemi me shkresë zyrtare dhe ndryshe paraqitet situata kur ka shoqërimë dhe arrestime masive nga strukturat e policisë të DVP-së në Tiranë. Aktualisht në Komisariatin e Policisë nr.1, Tiranë, është vetëm një dhomë sigurie, e cila edhe ajo nuk i plotëson standardet e përcaktuara nga legjisacioni shqiptar dhe ai ndërkontrollor, në lidhje me parametrat teknik dhe jetësor që duhet të plotësojnë dhomat e sigurisë.

- në Komisariatin e Policisë nr. 2 në Tiranë, ambienti i sigurisë përbëhet nga 2 (dy) dhoma sigurie. Njëra nga dhomat e sigurisë ishte me përmasa  $3 \times 3$ m, ndërsa dhoma tjeter ishte me përmasa  $4 \times 3$ m. Kapaciteti fizik i dhomave të sigurisë është për mbajtjen, trajtimin dhe sigurimin e 4 personave të ndaluar/arrêtuar dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë, deri në transferimin e tyre për në IEVP. Nisur nga sipërfaqet dhe kubaturat e dhomave, niveli i ndriçimit dhe ajrimit, si dhe kushtet materiale në të cilën ndodhen dhomat e sigurisë në këtë komisariat, konstatojmë se ato **nuk i plotësojnë parametrat teknik dhe jetësor për ndërtimin e dhomave të sigurisë**.
- në Komisariatin e Policisë nr. 3, ambienti i sigurisë përbëhet nga 3(tre) dhoma sigurie dhe vetëm 1(një) dhomë është funksionale. Dy dhomat e tjera, janë të mbyllura e të vulosura, sipas rekomandimeve të KPT-së gjatë vizitës inspektuese të zhvilluar në vendin tonë në vitin 2018, pasi nuk ato plotësonin parametrat teknikë dhe jetësor për ndërtimin e dhomave të sigurisë. Nga monitorimet e MKPT-së rezultoi se mbyllja e dy dhomave të tjera të sigurisë nuk i ka përmirësuar, por i ka përketqësuar standardet e trajtimit të personave të ndaluar/arrêtuar që mbahen në ambientin e sigurisë të komisariatit. Dhoma e sigurisë ishte me përmasa  $4 \times 2$ m dhe me kapacitet për mbajtjen dhe sigurimin e 3(tre) personave të ndaluar/arrêtuar në moshë madhore. Në rastet e ndalimit/arrêtimit të personave femra dhe të mitur, në përfundim të veprimeve proceduriale shoqëroheshin menjëherë për në dhomat e sigurisë të DVP Tiranë. Nisur nga sipërfaqet dhe kubatura e dhomës të sigurisë, ajo **nuk plotëson normat dhe parametrat teknikë dhe jetësorë për një person të arrestuar/ndaluar.<sup>88</sup>**
- në Komisariatin e Policisë nr. 5 në Kamëz, ambienti i sigurisë përbëhet nga 3(tre) dhoma sigurie, me kapacitet për mbajtjen dhe sigurimin e 3 (tre) personave të arrestuar/ndaluar. Sipërfaqja e përgjithshme e dhomave është më pak se  $10\text{m}^2$  metra dhe jo e ndarë në ambient

---

<sup>88</sup> Kreu V, pikë 3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkësë/ankesave të tyre”.

qëndrimi(dhomë) me sipërfaqe  $6m^2$  dhe paradhomë me sipërfaqe  $4m^2$ .<sup>89</sup>Këto dhoma nuk plotësojnë kushtet.<sup>90</sup>

Nga sa më sipër rezulton se rekondim i nuk është plotësuar se dhe dhomat e reja nuk janë vënë ende në funksion, ndërsa “mbyllja e dhomave” në Komisariatin nr. 1 është bërë vetëm formalisht.

## **II. 6 Oendra pritëse e mbyllur për të Huajt (QMH), Karrec**

### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekondon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për t'u siguruar që në Qendrën pritëse të Mbyllur për të Huajt (QMH), Karreç:

- të gjithë shtetasit e huaj të sapoardhur të përfitojnë nga një kontroll gjithëpërfshirës mjekësor (përfshirë kontrollin për sëmundjet e transmetueshme) nga një mjek ose një infermier plotësisht i kualifikuar që raporton tek një mjek sa më shpejt të jetë e mundur pas pranimit të tyre. Në lidhje me këtë, vëmendje e veçantë gjithashtu duhet t'i kushtohet ekzistencës së mundshme të çrrëgullimeve mendore dhe dobësive të tjera (të tilla si përvojat traumatike);
- regjistrimin pas një kontrolli mjekësor të një të ndaluarit, qoftë i sapoardhur apo jo, përmban:
  - (i) një informacion të plotë të gjetjeve objektive mjekësore bazuar në një kontroll të plotë (mbështetur nga një "tabelë trupore" për shënimin e lëndimeve traumatike dhe mundësisht, fotografi të lëndimeve);
  - (ii) një llogari të deklaratave të bëra nga personi në fjalë që janë të rëndësishme për ekzaminimin mjekësor, përfshirë çdo pretendim për keqtrajtim të bërë nga ai/ajo;
  - (iii) vëzhgimet e mjekut sipas pikave (i) dhe (ii), duke treguar qëndrueshmërinë midis çdo pretendimi të bërë dhe gjetjeve objektive mjekësore.

Për më tepër, rezultatet e çdo ekzaminimi, përfshirë deklaratat e lartpërmendura dhe vëzhgimet e mjekut, duhet t'i vihen në dispozicion të ndaluarit dhe avokatit të tij/saj;

- një dosje mjekësore individuale të hapet pa vonesë dhe të ruhet siç duhet për çdo shtetas të huaj të sapoardhur;
- sa herë që regjistrohen lëndime të cilat janë në përputhje me pretendimet për keqtrajtim nga shtetasit i huaj (ose që, edhe në mungesë të pretendimeve, janë tregues të keqtrajtimit),

<sup>89</sup> Kreu V, pika.3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkësë/ankesave të tyre”.

<sup>90</sup> <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/news/this-article-is-available-only-in-albanian-765/>

informacioni sistematikisht vihet në vëmendjen e prokurorisë, pavarësisht nga dëshirat e personit në fjalë.

- Personeli i kujdesit shëndetësor duhet të këshillojë të ndaluarin për ekzistencën e detyrimit të raportimit dhe që përcjellja e raportit tek autoritetet përkatëse nuk zëvendëson kryerjen e një ankesë zyrtare;
- punonjësit të kujdesit shëndetësor që punon në Qendër i kujtohet detyrimi i tij sipas nenit 282 të KPP për të raportuar, brenda 48 orëve, çdo lëndim tregues të keqtrajtimit nga zyrtarët e zbatimit të ligjit te prokurori kompetent.

### **b. Përgjigjja zyrtare**

Qendra e Mbyllur për të Huajt nuk është objekt paraburgimi. Në këtë qendër pranohen shtetas të huaj të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë kufizimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në QMH janë akomoduar 12 shtetas të huaj.

Dhjetë qytetarët e parë kanë një problem shumë të ndryshëm nga të huajt e mëparshëm të akomoduar në QMH dhe qëndrimi i tyre në qendër është maksimal (këta shtetas janë nën hetim nga Drejtoria e Shërbimit Inteligjent Kundër Terrorizmit dhe Prokuroria e Krimeve të Rënda). Kjo ka çuar në një situatë të rënduar në momente të caktuara (të reflektuara në informacionin tonë). Këta të huaj kanë qenë shumë të dhunshëm duke thyer dhe djegur mobilje, dyer dhe dritaret e dhomave të tyre ose të ambienteve të përbashkëta. Duhet theksuar se edhe në dhomat e izolimit këta shtetas të huaj kanë thyer xama, tualete, ngrohëse dhe lavamanë, të gjitha këto pasqyruar në informacione, raporte shërbimi dhe libra shërbimi. Disa nga këta qytetarë kanë tentuar të arratisen disa herë duke përdorur forcë nga brenda ambienteve të QMH-së, por shërbimet e policisë i zbuluan dhe i neutralizuan ata. Ka pasur edhe raste kur shtetas të huaj kanë kundërshtuar me dhunë punonjësit e policisë gjatë kryerjes së detyrës.

Për sa i përket forcës së ushtruar nga punonjësit e policisë është përdorur si mjeti i fundit dhe duke zbatuar rregulloren, asnjëherë pa shkak dhe në kundërshtim me Vendimin nr.1083 dt 28.10.2009 për krijimin e Qendrës së Mbyllur dhe miratimin e rregullave të saj të procedurës, Kapitulli V Neni 1, paragrafët 1, 2 dhe 3 a, b tregon qartë rastet e përdorimit të forcës.

QMH ka një program ditor të aktiviteteve që konsiston në ngrënien e vakteve, pastrimin e dhomave, ventilim, aktivitete në natyrë si pingpong ose lojëra në natyrë, shikimi i televizorit në ambiente të mbyllura, duke ndarë dhe lexuar libra të ndryshëm në bibliotekë. Për sa i përket shikimit të televizorit kjo nuk është më e mundur pasi qytetari X e ka prishur dhe asnjë pajisje

tjetër nuk është vënë në dispozicion. Për arsyet e sigurie një grup nga Delta është vendosur pranë QMH-së i cili punon 24/7.<sup>91</sup>

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

Qendra e Mbyllur për të Huajt (QMH) është ngritur dhe funksionon me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1083 datë 28.10.2009, “*Për ngritjen e Qendrës së Mbyllur dhe për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe funksionimit te saj.*”

Bazuar në Rregulloren e saj Institucioni i Avokatit të Popullit bën vizita monitoruse të herë pas hershme për vlerësimin e kushteve të Qendrës dhe cilësinë e trajtimit të personave të akomoduar në të.

Në QMH, zbatohet një protokoll shëndetësor i Qendrës së Profilaksisë dhe Mjekimit të DPPSH-së.

Shtetasit e huaj para se të akomodohen në QMH kalojnë në vizitë mjekësore nga personeli shëndetësor (nd/mjeku), ku kontrollohet vizualisht antropometria e trupit, për sëmundje lëkure të mundshme.

Merret një anamnezë e përgjithshme familjare e personave mbi problemet shëndetsore që ka patur më parë, dhe këto shënohen në kartelën klinike që hapet për çdo rast dhe evidenton ecurinë shëndetësore deri në largimin nga QMH. Në rastet kur kemi situata epidemike raportohet menjehëre te Qendra e Profilaksisë dhe Mjekimit në DPPSH.

Kur konstatohen elemente të pranisë së një sëmundje mendore, kryhet një vizitë tek mjeku specialist në Poliklinikën e Specialiteteve Durrës. Për sëmundjet sekondare trajtimi bëhet në QMH, ku ka një bazë të mjaftueshme medikamentesh për të ofruar ndihmën e parë dhe mjekime afat shkurtër.

Rastet e emergjencave mjekësore të cilat gjykojnë nga infermieri, si të pa trajtueshme në QMH, zgjidhen duke bashkëpunuar me 127 (Urgjencën Durrës).

Janë marrë masat dhe është zgjidhur problemi i shërbimit stomatologjik për shtetasit e huaj në QMH.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka vlerëuar dhe do të marrë masa në vazhdimësi për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian Kundër Torturës, Avokatit të Popullit dhe institucioneve të tjera të pavarura e kushtetuese në funksion të respektimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut.

### d. Gjetjet e MKPT

<sup>91</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 14-16.

## **Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, nuk është zbatuar.**

Nga monitorimet e MKPT-së në Qendrën Pritëse të Mbyllur për të Huajt (QMH), Karreç në organikën e kësaj qendre **nuk ka mjek**, por vetëm një infermier, i cili nuk plotëson kriterin e kërkuar në Raportin e KPT-së. Gjithashtu **mungon edhe mjeku stomatolog** dhe në rast nevoje shtetasit e huaj dërgohen në klinikat private dhe Qendra nuk ka fonde për këtë shërbim. Infermieri kryente vizitat e personave të akomoduar në këtë Qendër, që në momentet e para dhe në mënyrë periodike, por kjo është e pamjaftueshme. Në intervistat konfidenciale të zhvilluara nga ekspertë e MKPT me personat e huaj të akomoduar në Qendër, janë konstatuar se shtetasit e huaj reflektonin gjendje të rënduar emocionale dhe për shkak të saj ka patur raste që ata dëmtonin edhe veten me mjete prerëse. Duke marrë në konsideratë këto problematika, **nevoja për mjek në Qendër është emergjente**.

Nga kqyrja e dokumentacionit në QMH Kareç, konstatohet se ekzistojnë dy rregjistra, një regjistër i vizitave dhe regjistri tjetër ai i mjekimit, të cilat janë të plotësuara në rregull. Në rastet kur kërkohen ekzaminime të specializuara apo të sëmundjeve infektive, të huajt dërgohen në Spitalin Rajonal Durrës, apo trajtohen nga Sektori i Higjenës pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Durrës. Institucioni ende **nuk ka një autoambulance**. Në rastet emergjente pëndoreshin makinat e Qendrës për transportimin e të huajve pranë qendrave spitalore.

Gjithashtu, në këtë Qendër **ka probleme lidhur me furnizimin me medikamentet mjekësore** të nevojshme. Një pjesë e medikamenteve blihen me fondet e institucionit dhe pjesa tjetër ofrohen në formë donacioni nga shoqata Caritas.

Në lidhje me mungesat në staf, Avokati i Popullit ka rekomanduar ndër të tjera marrjen e masave të nevojshme për shtimin e stafit të kësaj Qendre me 1 mjek, 1 punonjës social, edukator, 1 jurist, 1 stomatolog, 1 përkthyes fillimisht part-time e më pas në varësi të kapaciteteve me kohë të plotë, me qëllim respektimin e të drejtave të të huajve të parregullt në Republikën e Shqipërisë. Kushtet e përgjithshme të Qendrës në vitin 2022 rezultojnë të përkeqësuara krahasimisht me kohën e bërgjes së vizitës së KPT-së.

## **II.7 Ankesat në lidhje me keqtrajtimin e personave nga oficerët e policisë**

### **a. Rekomandim i KPT**

Rekomandimi lidhet me ndjekjen me përparësi të ankesave në lidhje me trajtimin, hetimin dhe tolerancën zero për këto raste (numri i ankesave është indikator për të vlerësuar zbatimin e këtij rekomandimi). Mbi numrin e ankesave në lidhje me keqtrajtimin e personave nga oficerët e

policisë dhe numri i procedurave penale/disiplinore të cilat janë ngritur si rezultat i këtyre keqtrajtimeve.

### b. Përgjigjja zyrtare

Për sa i përket forcës së ushtruar nga punonjësit e policisë është përdorur si mjeti i fundit dhe duke zbatuar rregulloren, asnjëherë pa shkak dhe në kundërshtim me Vendimin nr.1083 dt 28.10.2009 për krijimin e Qendrës së Mbyllur dhe miratimin e rregullave të saj të procedurës, Kapitulli V Neni 1, paragrafët 1, 2 dhe 3 a, b tregon qartë rastet e përdorimit të forcës.

Për periudhën raportuese (shtator 2017-dhjetor 2019), në Shërbimin e Çështjeve të Brëndshme dhe Ankesave të Ministrisë së Brendshme u referua si më poshtë:

**78** ankesa / denoncime për keqtrajtim ose dhunë të dyshuar nga punonjësit e policisë gjatë dërgimit të të ndaluarve në komisariatin e policisë ose mbajtjes së tyre në vëzhgim. Duke ndjekur hetimin administrativ të këtyre ankesave, rezultoi se nuk ishte ushtruar dhunë fizike apo verbale. Megjithatë, për shkak të sjelljes së pahijshme të policisë në lidhje me komunikimin e papërshtatshëm me këta shtetas, në **13** raste (nga 78 ankesa gjithsej) Shërbimi i Çështjeve të Brëndshme dhe Ankesave sugjeroi fillimin e procedimit disiplinor ndaj **20** oficerëve të policisë.

Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave gjatë periudhës 2017-2019 ka dërguar 36 procedime penale në prokurorinë e rretheve gjyqësore ndaj 47 punonjësve të policisë për keqtrajtim ose ushtrim dhune gjatë shoqërimit të të arrestuarve në komisariat. Këta oficerë ishin akuzuar nga prokuroria për veprën penale të “*sjelljes veprime arbitrale*”, në përputhje me përcaktimet e nenit 250 të Kodit Penal.

#### ➤ Të gjitha këto referime janë iniciuar nga akuzat e qytetarëve.<sup>92</sup>

Në gjithsej **36** referime penale, Prokuroria:

- vendosi mosfillimin e procedimit në **8** raste
- vendosi pushimin e çështjes në **15** raste
- **11** referime për të cilat hetimi është në vijim
- Janë shpallur fajtorë në **2** raste **3** punonjës policie

Të gjitha të dhënat gjenden në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Viti	Nr. i referimeve penale	Nr. i oficerëve të policisë	Vendimi i mosfillimit të procedimit	Nr. i pushimit të çështjeve	Hetimi në vijim	Vendimi	Nr. i oficerëve të policisë të shpallur fajtor

<sup>92</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 15-16.

1.	2017	10	8	3	6	-	1	2
2.	2018	10	17	2	7	-	1	1
3.	2019	16	22	3	2	11	-	-
4.	Total	36	47	8	15	11	2	3

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit si dhe drejtoret e Departamenteve të Policisë kriminale dhe Departamentit për Sigurinë Publike kanë tërhequr vëmendjen dhe kanë kërkuar gjithë personelit policor që të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë vetem dhe në bazë të ligjit dhe procedurave standarde të punës duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, si dhe çdo veprim apo mosveprim tjetër në kundërshtim me rregullat dhe procedurat standarde që cënojnë integritetin fizik dhe të drejtat e njeriut janë të denueshme sipas akteve ligjore në fuqi.

Pjesë e strukturave qendrore të Policisë së Shtetit është dhe Drejtoria e Standarteve Profesionale, e cila ka përgjegjësinë për evidentimin e trajtimin e të gjitha shkeljeve dhe mangësive të konstatuara apo të raportuara per punonjësit e Policisë së Shtetit dhe në përfundim jep masa disiplinore deri në përashtim nga Policia e Shtetit per punonjësit përgjegjës.

Kjo strukturë ka përgjegjësinë e kryerjes së kontrolleve dhe monitorimeve të të gjithë strukturave/shërbimeve të Policisë së Shtetit lidhur me permbushjen e detyrave dhe përgjegjësive sipas akteve ligjore/nënligjore dhe procedurave standarde të punës të miratuara për këtë qëllim, si dhe inspektimi e kontrollës së pa planifikuara në raste të veçanta.

Drejtoria e Standarteve Profesionale, në vazhdimësi ka ndjekur, trajtuar rastet e veprimeve e mosveprimeve të punonjësve të policisë duke dhënë masat përkatëse disiplinore deri në perjashtime nga Policia e Shtetit deri në ndjekje penale, per raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut (keqtrajtim të personave, ushtrim dhune, shoqërim i padrejtë, etj)

	<b>Viti</b> <b>Lloji i masës</b>	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Përashtim nga Policia		10	6	5	2	4	4
2	Ulje me një gradë për 6 muaj							
3	Shtyrje e afatit të gradimit deri në 2 vjet	2	3	6	13	12	13	10
4	Pezullim pa pagesë deri në 30 ditë	8	3					

5	Masa të lehta disiplinore		5	44	7	1	7	8
6	<b>Masa parandaluese (jo disiplinore)</b>				2		2	
7	<b>Totali</b>	11	21	59	27	15	26	22

Për rastet kur shkelja ka elementët e një vepre penale, materiali i referohet AMP-së për vlerësim e fillimin e ndjekjes penale dhe tregues në këtë drejtim duhet të merren pranë SHCBA-së.

Ne përkrahim dhe jemi në pritje të përfundimeve të hetimeve të rekomanduara në organin e prokurorisë nga MKPT për ankesa të administruara ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me kryerje të veprimeve arbitrale e shpërdorime të detyrës gjatë vitit 2019-2020.

**Ne kemi vlerësuar rekomandimin, përmarrjen e masave të nevojshme për përgatitjen dhe miratimin e një procedure standarde, për veprimet proceduriale që duhet të kryejnë punonjësit e Policisë së Shtetit në rastet kur janë të pranishëm fëmijët (rasti i F.H); dhe Ju risjellim në vëmendje se:**

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në zbatim të detyrimeve të Ligjit Nr.37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" (KDPM), Ligjit Nr. 18/2017 "Per të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", akteve nënligjore të miratuara në zbatim të tyre, si dhe rekomandimeve të herë pas hershme të Avokatit të Popullit, vazhdimit ka marrë masa duke hartuar dokumenta administrativë, procedura standarde të punës dhe letër-porosi e tërheqje vëmendje për strukturat vendore, per trajtimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre, ndër të cilat përmendim:

- Procedura Standarde të Punës "Trajtimi i të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake" miratuar me Urdhër Nr.336, datë 04.04.2018, të D.P.P.SH.
- Procedura Standarde e Veprimit për "Njësinë e Intervistimit të të Miturve, standartet teknike dhe procedurat e përdorimit të këtyre ambienteve", miratuar me Urdhrin Nr.715, datë 05.06.2019, të D.P.P Shtetit.
- Letër-Porosi (e DPPSH), Nr. 278/1 Prot, datë 15.01.2020, për "Zbatimin me korrektësi të ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veçanti të drejtave të Fëmijëve, gjatë kryerjes së veprimeve policore dhe procedurale nga ana punonjësve të Policisë së Shtetit", ku është përcaktuar:

Lidhur me rekomandimin "Për përfshirjen në grupet e ndërhyrjes të policisë edhe të një psikologu apo sociologu për të asistuar personal e mitur/fëmijë që gjenden në ambientet ku do të kryhen operacionet policore", theksojmë se:

- Rekomandimi është i pa zbatueshëm nga ana jonë, pasi kryerja e veprimeve dhe operacioneve policore për kërkimin, kapjen, shoqërimin e personave autorë/të dyshuar të kryerjes se veprave penale; kontolleve të banesave dhe ambienteve të tjera, bëhen në

mënyrë të menjëhershme dhe në vlerësim e reagim të situatës kriminale dhe të rendit publik, ku përgjithësisht rrethanat dhe koha e shkurtër për ndërhyrje nuk favorizojnë/mundësojnë sigurimin e informacionit per prezencën e fënijëve dhe prezencës së psikologut.

- Referuar nenit 49, të Kodit të Drejtësisë Penale per të Mitur, miratuar me Ligjin nr. 37/2017, nga ky rregull (*prania e psikologut*) bëhet përjashtim edhe në rastet kur vetë të miturit janë objekt i drejtpërdrejtë i punës/veprimeve proceduriale, kur veprimet ose mosveprimet e të miturit rrezikojnë sigurinë publike dhc/osc në rastet e parashikuara lidhur me gjendjen e flagrancës.

Me përjashtim të rasteve/situatave emergjente, të përmendura më sipër, ku për shkak të rrethanave kërkohet ndërhyrje e menjëherslune (aty për aty), në të gjitha rastet e tjera, para kryerjes së ndërhyrjes ndër të tjera është marrë në konsideratë prania e mundshme e Fëmijëve (nën 18 vjeç) në këto ambiente dhe janë marrë masa për:

- Përcaktimin e një punonjësi policie (mundësish punonjëse) për të komunikuar me fëmijët, me qëllim shmangien e prezencës së tyre gjatë ndërhyrjes duke kërkuar bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e prindërve, kujdestarit ligor apo ndonjë personi tjetër madhor që kujdeset për ta.
- Veçimin e fëmijëve në një ambient ku të mos shikojnë veprimet e policisë, duke i lënë nën kujdestarinë/mbikëqyrjen e një prej prindërve, një të afërt apo një personi tjetër madhor që të kujdeset për ta.
- Përdorimin në mënyrë sa më të kufizuar të mundshme të forcës dhe mjeteve të tjera shtrënguese (bazuar në parimin e proporcionalitetit), në rastet kur nuk është bërë e mundur shmangia e prezencës së fëmijëve gjatë kryerjes së veprimeve dhe operacioneve policore.
- Shmangien në çdo rast të përdorimit të "forcës eksesive ose brutale", e cila konsiderohet e paligishme dhe shpesh morale, që zakonisht përfshin veprimet që kanë të bëjnë me përdorimin e një gjuhe abuzive (fjalë fyese dhe denigruese), përdorimin e panevojshëm të forcës, shtrëngimit, kërcënimit, shtytjet e të goditurat me shkop gome, etj.

Në rastet kur personat të cilët janë Objekt i shoqërimit, arrestimit apo ndalimit, në momentin e kryerjes së veprimeve policore/procedurale për shoqërimin, ndalimin apo arrestimin, kanë nën kujdesin e tyre fëmijë (nën 18 vjeç) dhe nuk ka persona të tjera që mund të kujdesen për ta (Pëmijët), janë merrë masa për sigurimin e prezencës së një të afërti/personi madhor, si dhe njoftimin/referimin e menjëhershëm të rastit pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës, me qëllim lënien nën kujdes dhe marrjen e masave mbrojtëse të nevojshme për fëmijët.

#### d. Gjetjet e MKPT

Në lidhje me këtë **rekomandim të KPT-së, vlerësojmë tërësinë e masave të marra me efekt parandalues dhe disiplinor për punonjësit e policisë, si dhe angazhimin e drejtuesve të**

**policisë në të gjitha nivelet e drejtimit, për ndëshkimin e tyre në rastet e keqtrajtimeve të shtetasve në mjediset e policisë së shtetit dhe jashtë saj. Gjithsesi duhen evidentuar çështjet e dhunës verbale në Komisariate si dhe për vetë faktin se në pjesën më të madhe të Komisariateve nuk ka dhoma të intervistimit, por edhe ku ka, përsëri vijon praktika përmarrjen në pyetje në dhomat e punonjësve të policisë.**

Pavarësisht frysës së mirë për të ulur ndjeshëm ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike, MKPT ka konstatuar se masat e marra nuk janë të mjaftueshme. Registrat e ankesave nuk janë mjet efektiv për bërjen e ankesave, e ato në pjesën më të madhe nuk rezultojnë të kenë të evidentuara raste ankesash. Në procesverbalin e mbajtur për komunikimin e masave të ndryshme të personave të ndaluar/arrêtuar ose të ndjekjes në gjendje të lirë, formalisht përfshihet fjalia “nuk kam pretendime për keqtrajtim”.

Në një pjesë të komisariateve sistemi i kamerave brenda godinës së komisariateve nuk është plotësisht funksional, ka pikë të vdekura dhe ndonjëherë i pa lidhur me serverin qendror përmajtjen e pamjeve filmike.

Avokati i Popullit nëpërmjet Seksionit të Veçantë dhe MKPT-së ka trajtuar 183 ankesa në vitet 2019-2022.

Një problematikë e cila është evidente gjatë zhvillimit të protestave qytetare në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit, ka të bëjë me dhunën fizike, verbale dhe tejkalimin e forcës të punonjësve të policisë ndaj protestuesve gjatë shoqërimit dhe mjediset e policisë. Për këtë Avokati i Popullit ka bërë rekomandime të cilat priten të zbatohen në vijim.

- Shkresa nr. K2/L1-4 prot., datë 29.07.2021 “*Rekomandim për zbatimin e detyrimit ligjor për të paralajmëruar personat pjesëmarrës në tubim se do të përdoret forcë për shpërndarjen e tyre si dhe i parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret gaz lotsjellës dhe ujë me presion (rasti i protestave të zhvilluara në Tiranë, në muajin dhjetor 2020)*”.
- Shkresa nr. K2/I4-2 prot., datë 11.06.2021 “*Rekomandim për zbatimin e parimit ligjor të proporcionalitetit kur përdoret forcë fizike për të kontrolluar sjelljen e protestuesve (disa raste të ndodhura gjatë protestave të mbajtura në Tiranë, në muajin dhjetor 2020)*”.
- Shkresa nr. K2/I20-29 prot., datë 17.11.2020 “*Rekomandime mbi veprimet/mosveprimet e kundërligjshme të strukturave të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar*”.<sup>93</sup>

Për sa më sipër konsiderojmë se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe se zbatimi përbajtësor i tij mbetet sfidë e forcave të policisë së shtetit.

<sup>93</sup> Për sa më sipër konsiderojmë se ky rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe se zbatimi përbajtësor i tij mbetet sfidë e forcave të Policisë së Shtetit. Konsulto:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Teatri%20Kombetar%20nenor%202020.pdf>

## SEKSIONI III

### MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

#### ***III.1 Pacientët me masë mjekësore "mjekim i detyruar"***

##### **a. Rekomandim i KPT**

###### ***Pacientët me masë mjekësore "mjekim i detyruar":***

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale së bashku me Ministrinë e Drejtësisë janë angazhuar të marrin hapa tranzitore urgjente për përmirësimin e kushteve dhe kujdesit ndaj personave që kanë marrë nga gjykata masën "***mjekim i detyruar***", siç është planifikuar në "Planin e Përbashkët të Veprimit për Funksionimin e *Institucionit të Posaçëm Tranzitor të Lezhës*", miratuar me urdhër të përbashkët të të dy ministrave, me veprime specifike mbi strukturën e burimeve njerëzore (personeli administrativ dhe klinik, trajnime, etj.), rregullimi i shërbimeve (funksioni i shërbimeve shëndetësore dhe rregullimet e kujdesit dhe sigurisë etj.), duke parashikuar dispozita të veçanta për procesin tranzitor të këtyre personave.

Gjithashtu, Komiteti për Parandalimin e Torturës (KPT), në raportin e vitit 2018 për Shqipërinë ka theksuar se: "Nëse autoritetet shqiptare vazhdojnë të mos zbatojnë rekomandimin e mëparshëm që të gjithë pacientët me çrrregullime të shëndetit mendor të transferohen në një institucion të posaçëm psikiatriko mjeko-ligjor, do të vendoset procedura e parashikuar në **nenin 10, paragrafi 2** i Konventës Europiane për Parandalimin e torturës dhe dënimive ose trajtimeve çnjérëzore ose poshtëruese"<sup>94</sup>.

##### **b. Përgjigja zyrtare**

Për sa i përket përmirësimit të kushteve dhe kujdesit për pacientet psikiatrik forensik, subjekt të "trajtimit të detyrueshëm", si masë gjyqësore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministria e Drejtësisë është e përkushtuar të ndërmarrë hapa urgjent kalimtarë, siç është planifikuar zyrtarisht në "Planin e Përbashkët të Veprimit për Funksionimin e "Institucionit të Posaçëm Tranzitor Lezhë", miratuar me urdhër të përbashkët të dy ministrave, me veprime specifike për strukturën e burimeve njerëzore (stafi administrativ dhe klinik, trajnimet, etj.), rregullorja e shërbimeve (funksioni i shërbimeve të shëndetësisë dhe masat e kujdesit dhe sigurisë),

<sup>94</sup> Neni 10 i Konventës Europiane për Parandalimin e Torturës dhe Dënimive ose Trajtimeve Çnjérëzore ose Poshtëruese parashikon se "Pas çdo vizite, Komiteti përpunon një raport mbi faktet e konstatuara gjatë saj duke pasur parasysh çdo vëzhgim që mund t'i jetë paraqitur nga Pala e interesuar. Ai i bën të njojur kësaj të fundit raportin e tij, i cili përmban rekomandimet që ai i gjykon të nevojshme. Po qe nevoja Komiteti mund të këshillohet me Palën për t'i sugjeruar përmirësimë në mbrojtjen e personave të privuar nga liria. 2 Nëse Pala nuk bashkëpunon ose refuzon të përmirësojë situatën nën dritën e rekomandimeve të Komitetit, ky i fundit, pasi Pala të ketë pasur mundësi të shpjegohet, mund të vendosë me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij të bëjë një deklaratë publike lidhur me këtë çështje." Konsulto: <https://rm.coe.int/16806dbac6>

etj. Ekzistojnë dispozita specifike për procesin e transferimit për të gjithë pacientët forensik dhe orarin e tij.

Duke ditur që Shqipërisë i mungon ekspertiza në psikiatrinë fprensike, MSHMS i ka drejtuar një kërkesë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për ofrimin e mbështetjes teknike për funksionimin e institucionit kalimtar të Lezhës si dhe për rishikimin e planeve aktuale për krijimin e Institucioni të Veçantë Mjekësor, duke zbatuar dispozitat e veçanta të ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" dhe standardet e nevojshme shëndetësore. Pjesë e letrës ishte gjithashtu kërkesa për mbështetje financiare nga donatorët për themelimin e këtij institucioni të ri.

Pjesë të kërkesës së mësipërme janë adresuar nëpërmjet mbështetjes së KiE, të planifikuar në kuadër të Programi i Horizontal Facility II – Komponenti: Rritja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të të burgosurve në Shqipëri. Në Rezultatin e ndërmjetëm 2 të këtij plani "*Dispozita e kujdesit shëndetësor në burg, veçanërisht për të burgosurit me probleme mendore dhe për pacientët forensik është përmirësuar*" aktivitetet janë rihartuar në bazë të sugjerimeve të institucionit tonë, duke u ndalur në formulimin e PSV-së dhe pilotimin e kësaj të fundit në objektin tranzitor të Lezhës" me synimin për të zhvilluar një metodologji funksionale që përmirëson kujdesin shëndetësor dhe veçanërisht kujdesi për shëndetin mendor në burgje.<sup>95</sup>

### c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Drejtësisë vijojnë angazhimin e tyre me qëllim përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me masë mjekësore "*mjekim i detyruar*". Në këtë kuadër MSHMS ka identifikuar një truall të mundshëm, ish godina psikiatrikut në Shkodër, për ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posaçëm, sipas parashikimeve specifike të Ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", i ndryshuar, dhe standardeve ndërkontaktore të këtë fushë. Me qëllim zbatimin e kësaj mase, MSHMS dhe MD kanë hartuar një projekt-fashë dhe kanë aplikuar në fondet IPA, me titull "*Establishment of the National Special Medical Institution for forensic psychiatric patients*" për financimin e këtij institucioni, si në terma të sigurimit të infrastrukturës së duhur ashtu edhe në fuqizim kapacitetesh të burimeve njerëzore të specializuara në këtë fushë (në numra dhe profile profesionale, si dhe në trajnime dhe hartim rregulloresh e procedurash standarde të ofrimit të shërbimit).

### d. Gjetjet e MKPT

Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, është zbatuar pjesërisht vetëm në nëntor 2021 dhe ka genë i pazbatuar që nga 2018 deri në 2021.

<sup>95</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 34.

Nga takimet zyrtare dhe komunikimet me MSHMS dhe MD jemi bërë me dije se i pranojnë rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe janë duke u marrë marrë masa paraprake për zbatimin e këtij rekomandimi, duke identifikuar një truall të mundshëm, ish-godinën e Spitalit Psikiatrik në Shkodër, **për ngritjen e Institucionit Mjekësor të Posacëm** për akomodimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën "*mjekim i detyruar*".

Është për tu përshëndetur iniciativa e Ministrit të Drejtësisë, z. Manja lidhur me angazhimin për mbylljen e burgut të Zaharisë, si dhe nenshkrimi i Marrëveshjes mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësië dhe Mbrojtjes Sociale për përmirësimin e trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, që u firmos ne 23 nentor 2021, nga Ministri i Drejtësisë Ulsi Manja dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, në prani të përfaqësuesve të Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Europës në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë.

Në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye procesi transferimit nga IEVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore<sup>96</sup> dhe akomodimi i tyre në dy godinat në IEVP Lezhë

**POR, nga ana tjetër** Avokati i Popullit vijon ta konsiderojë neglizhencë të theksuar nga ana e autoriteteve përgjegjëse ngritjen e institucionit të posacëm mjekësor për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilat gjykatat kanë marrë vendim për "*mjekim të detyruar në një institucion mjekësor*" apo kanë caktuar masën shtrënguese "*shtrim të përkohshëm në një institucion psikiatrik*", ndonëse për këtë problematikë ka pasur vëmendje të posacëm të çdo institucioni vendas ose ndërkombëtar të drejtave të njeriut. Në mungesa e trajtimit të posacëm dhe rehabilitues, krijon problematika që këta shtetas të ketë përmirësim shëndetësor dhe psikologjik. Duke patur parasysh se shkeljet e konstatuara janë të përsëritura dhe me pasoja, i ka rekomanduar për çdo vit Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të ndërhyjë **menjëherë** për përmirësimin e situatës.

Nga analiza e të dhënave buxhetore për 2021, asnjë nga fondet e rindërtimit nuk u përdorën për përmirësimin e kushteve në IEVP Shën Koll, Godina 112 megjithë dëmtimet që kanë pësuar ato godina, si dhe të dhënave për nevojat buxhetore të paraqituar në projekt buxhetin e vitit 2022, kontatojmë se ende në planet e afërtë të MSHMS nuk është parashikuar asgjë lidhur me Spitalin Forensik. Madje në asnjë nga zërat as në zërin spitale të ndryshme nuk është percaktuar asnjë zë lidhur me furnizimin e ndërmjetëm të dy ndërtesave të përshtatura të IEVP Shën Koll, që do të shërbejnë për personat të cilët janë me masë mjekësore "mjekim i detyruar". Janë bërë parashikime në projekt buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë, por këto propozime janë në zërin investime dhe jo shërbime apo paga për stafin mjekësor.

Për këto rekomandime kërkohet një vëmendje e shtuar dhe konkrete.

<sup>96</sup> 217 shtetas me masë mjekësore "shtrim i detyruar" dhe 97 shtetas me masë mjekësore "shtrim i përkohshëm"

### ***III. 2 Personat me çrregullime të shëndetit mendor***

#### **a. Rekomandim i KPT**

Prej disa vitesh Shqipëria po zbaton qasjen e shëndetit mendor të komunitetit, e cila synon të ofrojë shërbime të shëndetit mendor dhe mbështetje pozitive të shëndetit mendor, sa më afër popullsisë. Ligji nr. 44/2012, "Për Shëndetin Mendor", i ndryshuar, ka për qëllim promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me shëndetin mendor, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor, mbrojtjen kundër diskriminimit, torturës dhe trajtimit çnjerëzor si dhe promovon trajtimin e bazuar në komunitet.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në përgjigjen e nisur pranë Avokatit të Popullit referon se "ka një Plan Veprimi për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri, të cilin në përgjigjen e Qeverisë Shqiptare datë 27 Shkurt 2020, mbi raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës së tij në Shqipëri në datat 20 - 30 Nëntor 2018<sup>97</sup>, dhe ka planifikuar ta rishikojë deri vitin e ardhshëm (2020), në mënyrë që të përmirësojë më tej veprimet në fushën e shëndetit mendor dhe të integrojë shërbimet e ndihmës shëndetësore dhe sociale".

#### **b. Përgjigjja zyrtare**

Prej disa vitesh Shqipëria po zbaton qasjen e shëndetit mendor komunitar, e cila synon të ofrojë shërbime të shëndetit mendor dhe mbështetje pozitive të shëndetit mendor, sa më afër popullatës. Kjo qasje është parashikuar në kuadrin strategjik dhe ligjor për shëndetin mendor që është hartuar në kuadër të kësaj reforme. Më konkretisht Shqipëria ka miratuar Ligjin nr.44/2012 "Për shëndetin mendor", i cili synon promovimin dhe mbrojtjen e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve të lidhura me shëndetin mendor, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime të shëndetit mendor, mbrojtja nga diskriminimi, tortura dhe trajtim çnjerëzor si dhe promovon trajtimin e bazuar në komunitet. MSHMS gjithashtu ka adaptuar një paketë të pasur aktesh nënligjore që lehtëson zbatimin e dispozitave të veçanta ligjore të ligjit për shëndetin mendor.

Gjithashtu, është një plan veprimi dhjetëvjeçar për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri miratuar në vitin 2013 (2013-2020). Vizioni për të ardhmen vazhdon të frymëzohet nga filozofia e mbrojtjes së të drejtave të personave me çrregullime mendore dhe nevoja të veçanta në shëndetit mendor dhe lufta kundër përjashtimit dhe diskriminimit nëpërmjet krijimit të një rrjeti të integruar të shërbimeve të shëndetit mendor për trajtim, rehabilitim dhe riintegrin social. Bazuar në krijimin e këtij Rrjeti të Shërbimeve të Integruese të Shëndetit Mendor për përbashkjen e dy objektivave kryesore strategjike, konkretisht të Decentralizimit të Shërbimeve të Shëndetit

<sup>97</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020).

Mendor duke zgjeruar dhe pasuar rrjetin ekzistues me shërbime më afër komunitetit dhe Deinstitucionalizimit nëpërmjet reduktimit të numrit të shtretërve psikiatrikë dhe ngritjen dhe forcimin e shërbimeve komunitare të shëndetit mendor. Në këtë kuadër në Shqipëri janë krijuar 10 Qendra të Shëndetit Mendor dhe 14 Shtëpi të Mbështetura duke pasuar sistemin e shëndetit mendor në Shqipëri.

MSHMS ka planifikuar të rishikojë Planin e Veprimit për Shëndetin Mendor vitin e ardhshëm, në mënyrë që të përmirësojë më tej veprimet në fushën e shëndetit mendor dhe të integrojë shërbimet shëndetësore dhe sociale.<sup>98</sup>

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

Përsa i përket zbatimit të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013-2022, informojmë se ky dokument është në vitet e fundit të zbatimit të tij dhe se në përfundim të tij do të ndërmerret një vlerësim i aktiviteteve të parashikuara në të.

Qasja komunitare e ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor mbetet një synim kyç strategjik i cili do të reflektohet edhe në dokumentin e ri të Strategjisë Kombëtare Shëndetësore.

### d. Gjetjet MKPT

#### Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, nuk është zbatuar.

Plani i Veprimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013-2022 është ende në proces zbatimi nga MSHMS. Pritet që me përfundimin e tij të ndërmerret një vlerësim i aktiviteteve të parashikuara në të, si dhe **rishikimi i këtij Plani Veprimi** për vitet e ardhshme, me qëllim që të përmirësojë më tej veprimet në fushën e shëndetit mendor dhe të integrojë shërbimet e ndihmës shëndetësore dhe sociale, por nuk rezulton asnjë ndryshim në shërbimet e dhëna në komunitet që nga viti 2018. Sigurisht që tërmeti dhe pandemia kanë pas ndikim por ato kanë përkeqësuar situatën e personave e të shëndetit mendor.

Nga analiza e të dhënavë buxhetore për 2021, si dhe të dhënavë për nevojat buxhetore të paraqitur në projekt buxhetin e vitit 2022, konkretisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rezulton se fondet e alokuara për adresimin e problemeve të shëndetit mendor, si dhe të personave të privuar nga liria, në përgjithësi janë të pamjaftueshme dhe nuk përkojnë në një masë të konsiderueshme me nevojat reale financiare për të përbushur angazhimet e ndërmarrë në këtë fushë.

**MSHMS duhet të marrë masat e duhura në një kohë sa më të shpejtë lidhur me nevojën e ngritjes së një institucioni i cili duhet të sigurojë ofrimin e një kujdesi terapeutik human dhe**

<sup>98</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 35.

**të sigurt nëpërmjet sigurimit të balancës së duhur mes kujdesit dhe sigurisë, në respekt të të drejtave të njeriut.**

Gjithashtu gjatë inspektimeve të MKPT vihet re e sistemi i brendshëm i ankimit eshtë një çështje e pazjidhur nga ana e mekanizmave të shërbimeve të shëndetit mendor. Mungesa e këtij sistemi në thelb cënon parimin e transparencës dhe llogaridhënieς për rastet individuale që mund të trajtohen brenda sistemit të shërbimit të shëndetit mendor.

### ***III.3 Kushtet e jetesës së pacientëve në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit***

#### **a. Rekomandim i KPT**

Për sa i përket kushteve të jetesës së pacientëve në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka planifikuar në vitet e ardhshme rindërtimin e Spitalit Psikiatrik të Elbasanit bazuar dhe në rekomandimet e Delegacionit për kushtet e jetesës të cilat do të zbatohen në projektin e rindërtimit.

#### **b. Përgjigja zyrtare**

Sic e përmendëm edhe në përgjigjen e mëparshme, një ndërhyrje për rindërtimin e Spitalit Psikiatrik Elbasan eshtë planifikuar për vitet e ardhshme dhe rekomandimi i Delegacionit për kushtet e jetesës do të jenë pjesë e ToR të projektit të rindërtimit.

Për sa i përket farmakoterapisë në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit, konfirmojmë se jo vetëm ky spital, por edhe të gjitha institucionet psikiatrike stacionare, furnizohen normalisht dhe nuk ka mangësi të tilla.<sup>99</sup>

#### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Në lidhje me investimet në shërbimet e specializuara të shëndetit mendor, në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2021-2023 janë parashikuar ndërhyrje rikonstruktuese si për Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan, ashtu edhe për Shërbimin e Psikiatrisë pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë. Ndërkohë që në përgjigjen e qeverisë shqiptare përmendet se eshtë planifikuar rikonstruksioni i Spitalit Psikiatrik të Elbasanit në vitet në vijim dhe se rekomandimi i Delegacionit për kushtet e jetesës do të jetë pjesë e ToR të projektit të rindërtimit.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

**Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, eshtë i pazbatuar.**

---

<sup>99</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> "Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 35.

Gjatë inspektimeve të zhvilluara nga MKPT në vitet 2019, 2020 dhe 2021 u evidentuan nevojat për investime, kushte me të mira materiale për një shërbim cilësor, nevojë për një numër në rritje të stafeve mjekësore dhe mbështetëse.

Në përgjigje të raporteve me rekomandime të MKPT-së gjatë viteve 2020 dhe 2021, jemi bërë me dije nga MSHMS<sup>100</sup> se, në PBA 2020-2022 është planifikuar rikonstruksioni i plotë i godinës së Spitalit Psikiatrik "Sadik Dinçi" Elbasan, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet infrastrukturore dhe të organizimit të këtij shërbimi.

Por, nga monitorimi i buxhetit të këtij institucioni për vitin 2022, ky fond nuk është lëvruar ende dhe sipas informacionit, investimi për rikonstrukcionin e spitalit është shtyrë **për buxhetin e vitit 2023.**

### **III.4 Stafi dhe trajnimet**

#### **a. Rekomandim i KPT**

Në lidhje me nevojën për trajnim të vazhdueshëm të stafit klinik të shërbimeve të shëndetit mendor, duke synuar adresimin e boshllëqeve të identikuara nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues<sup>101</sup> (KPT), për mungesën e kapaciteteve specifike të stafit klinik të shëndetit mendor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është shprehur se, në bashkëpunim me Organizatën Botërore të Shëndetit (OBSH) dhe Departamentin Psikiatrik të Fakultetit të Mjekësisë, po vlerëson mundësitet për të zbatuar një program kombëtar trajnimi për të gjithë profesionistët e shëndetit mendor pjesë e institucioneve publike të shëndetit mendor.

#### **b. Përgjigja zyrtare**

Për sa i përket nevojës për rritjen e numrit të mjekëve psikiatër dhe infermierëve, si dhe të stafit tjeter psikosocial, MSHMS dhe Departamenti i Psikiatrisë, Fakulteti i Mjekësisë, në kursin e specializimit pasuniversitar të këtij viti, këtij kursi i janë bashkuar 23 mjekë të rinj, ndërsa 28 janë në fazën e vazhdueshme të rezidencës psikiatrike.

Për sa i përket nevojës për trajnim të vazhdueshëm të stafit klinik të shërbimeve të shëndetit mendor, ne informojmë Delegacioni se edukimi i vazhdueshëm për profesionistët shëndetësorë është procesi përmes të cilit profesionistët shëndetësorë përditësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre për të përbushur nevojat e pacientëve, shërbimet shëndetësore dhe zhvillimin e tyre profesional. Zhvillimi i tyre profesional lidhet me konteksti multidisiplinar i kujdesit ndaj pacientit që, përvçe

<sup>100</sup> Shkresa nr. 4023/I prot., datë 26.09.2019 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit me lëndë "Kthim përgjigje".

<sup>101</sup> shih: <https://rm.coe.int/168097986b>. "Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT)" from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2019).

njohurive dhe aftësive mjekësore, përfshin aftësitë menaxheriale, sociale dhe personale. Përveç nevojës për zhvillim profesional, profesionistëve shëndetësorë u kërkohet të angazhohen në aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm që t'i përgjigjet kërkesave përkatëse për Certifikimin dhe Rilicensimin. Aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm lidhen me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë e profesionistit në pozicionin aktual të punës dhe brenda seancës minimale të trajnimit që kërkohet të ndiqen nga secili profesionist shëndeti (mjekë dhe infermierë), rreth 80% e tyre duhet të jenë të tipologjisë së tyre të punës dhe të tjera mund të jetë të natyrës së përgjithshme të kujdesit shëndetësor. Kombinimi i nevojave dhe detyrimet janë në thelb të sistemit të edukimit të vazhdueshëm që po zbaton Shqipëria prej disa vitesh.

Ndërkohë, duke synuar adresimin e mangësive të identikuara nga Delegacioni lidhur me mungesën e kapaciteteve specifike të stafit klinik të shëndetit mendor, MSHMS në bashkëpunim me ëWorld Health Organization dhe Departamentit të Psikiatrisë të Fakultetit të Mjekësisë është duke vlerësuar mundësitë për të të zbatuar një program kombëtar trajnimi për të gjithë pjesën profesionale të institucioneve të shëndetit mendor publik.<sup>102</sup>

### c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës

Përsa i përket trajnimeve të stafeve të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor, COVID-19 paraqiti një sfidë të rëndësishme për të gjithë sistemin shëndetësor në nivel global, ndaj dhe aktivitet trajnuese dhe mbështetëse u riorientuan dhe u riformatu, me qëllim ofrimin e një përgjigje sa më efektive mbi shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale, në kuadër të kësaj pandemie.

Në këtë kontekst, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me OBSH dhe UNICEF, organizuan një paketë trajnimesh online "Shëndeti Mendor dhe Mbështetja Psikosociale në Situatë Emergjencë". Këto trajnime kishin për qëllim pajisjen e profesionistëve të linjës së parë me një kuptim themelor të koncepteve, njohurive dhe mjeteve për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale të njerëzve gjatë një situate emergjencë.

Trajnimi u nda në 8 module të veçanta, të zhvilluara çdo të enjte, nga data 28 maj deri më 16 Korrik 2020. Në këto sesione u trajtuan çështje të tillë si:

- prezantimi shëndetit mendor në situata emergjencë;
- çështjet ndërkulturore dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut gjatë emergjencave humanitare;
- ndërtimi i programeve psikosociale dhe të shëndetit mendor në situata emergjencë;

---

<sup>102</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 36.

- shëndeti mendor dhe mbështetja psikosociale me bazë në komunitet për fëmijë dhe adoleshentë gjatë emergjencave humanitare;
- dhuna seksuale dhe me bazë gjinore gjatë emergjencave humanitare;
- çrregullime të lidhura me stresin gjatë emergjencave humanitare;
- Hidhërimi, humbja dhe depresioni;
- çrregullime të rënda mendore; çrregullime të lidhura me përdorimin e substancave dhe epilepsia;
- si dhe detajuan konceptet mbi Ri-ndërtimin më të mirë pas këtyre fatkeqësive.

Mesatarisht, në çdo ëebinar u sigurua një pjesëmarrje prej 230 personash, me profile të ndryshme profesionale, ndër ta një pjesëmarrje e lartë u sigurua nga stafet multidisiplinare të shërbimeve të specializuara të shëndetit mendor.

#### **d. Gjetjet e MKPT**

Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, pjesërisht i zbatuar, pasi trajtimi duhet të jetë vazhdues për të siguruar shërbim të përshtatshëm për personat me probleme të shëndetit mendor.

Gjatë periudhës së pandemisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me OBSH dhe UNICEF, kanë organizuar një paketë trajnimesh online me temë "Shëndeti Mendor dhe Mbështetja Psikosociale në Situatë Emergence".

Mbetet si detyrë, që në të ardhmen MSHMS-ja të organizojë **trajnime të vazhdueshme të stafit klinik të shërbimeve të shëndetit mendor**, duke synuar adresimin e boshllëqeve të identikuara nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT), gjatë vizitës inspektuese në Shqipëri në vitin 2018.

#### ***III.5 Shtrimi i pavullnetshëm***

##### **a. Rekomandim i KPT**

KPT rekomandon autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapa në nivel legjislativ për të siguruar që në të gjitha spitalet psikiatrike në Shqipëri shtrimin dhe/ose trajtimin e pavullnetshëm duhet ta rishikojnë kryesisht në mënyrë periodike nga gjykata; vetë pacientët të kenë të drejtë të kërkojnë një rishikimit të vendimit të gjykatës për shtrimin dhe/ose trajtimin e pavullnetshëm; në kuadër të procedurave të sipërpërmendura të rishikimit gjyqësor, pacientët në fjali dëgjohen personalisht nga gjyqtari.

## **b. Përgjigjja zyrtare**

MSHMS ka krijuar një grup pune për ndryshimin e ligjit “*Për shëndetin mendor*” brenda tremujorit të parë të vitit 2020. Grupi i punës do t’i referohet rekomandimit të Delegacionit në lidhje me mbrojtjen ligjore të personave me çrregullime mendore (të trajtimit të pavullnetshëm, shqyrtimi i tij dhe procedurat e shkarkimit, pëlqimi për shtrimin në spital dhe pëlqimi për procedurat e trajtimit, izolimit dhe kufizimit, statusi ligjor i banorëve kronikë).<sup>103</sup>

## **c. Përgjigjja e Institucionit përgjegjës**

Raporti i fundit i KPT-së ka trajtuar në një masë të madhe mangësitë ligjore në fushën e shëndetit mendor, duke propozuar një sërë ndryshimesh ligjore me qëllim fuqizimin e mbrojtjes ligjore të personave me çrregullime të shëndetit mendor. Për zbatimin e këtyre rekomandimeve, MSHMS ka përfunduar procesin e rishikimit të Ligjit nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", i ndryshuar, dhe aktualisht projekt-ligji pritet të kalojë në mbledhjen e radhës së Këshillit të Ministrave.

Informojmë se projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.44/2012 "Për Shëndetin Mendor, të ndryshuar"<sup>104</sup> i cili reflekton rekomandimet e KPT-së, është publikuar në faqen e MSHMS.

## **d. Gjetjet e MKPT**

Rekomandimi i KPT-së është zbatuar nga pikëpamja e përbushjes së detyrimeve ligjore, mirëpo ne do vijojmë të monitorojmë zbatimin në praktikë të këtij rekomandimi në spitalet psikiatrike të vendit, pasi deri më tani procedurat e vendosjes së pavullnetshme nuk përbëjnë mbrojtje efektive, dhe kjo kategori pacientësh zakonisht nuk është përfshirë në procedurën gjyqësore.

## ***III.6 Mjetet e kufizimit***

### **a. Rekomandim i KPT**

Për sa i përket mjeteve të kufizimit, të dhënat e të gjitha spitalet psikiatrike për periudhën janar - dhjetor 2019, duket se kanë disa probleme, kryesisht në lidhje me dokumentacionin e të gjitha rasteve të kufizimit, siç janë përshkruar në Raportin e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues (KPT). Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

<sup>103</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf(2020), fq. 36.

<sup>104</sup> Miratuar me ligjin nr. 20/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar.

Sociale éshtë angazhuar të monitorojë rregullisht zbatimin e duhur të masave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te të gjitha institucioneve psikiatrike në vitin e ardhshëm.

### **b. Përgjigja zyrtare**

Për sa i përket mjeteve të kufizimit, të gjitha institucionet psikiatrike kanë iniciuar një program trajnimi të stafit të brendshëm për procedurat e kufizimit dhe teknikat e de-përshkallëzimit, duke ndjekur dispozitat specifike të protokollit nr. 586, datë 30 tetor 2013, nga Ministri i Shëndetësisë.

Ndërkohë, MSHMS ka sjellë në vëmendjen e institucioneve të spitaleve psikiatrike nevojën urgjente për zbatimin e rekomandimeve që çdo pacient që i nënshtrohet kufizimit mekanik ose izolimit nga mbikëqyrja e vazhdueshme, duke mos qenë objekt i kësaj procedure në vëzhgimin e një pacientit tjetër, konsultimi i nevojshëm me pacientët pas heqjes së mjeteve të kufizimit dhe që të gjitha fazat e kufizimit, duke përfshirë mbajtjen fizike, izolimin dhe kufizimin kimik janë regjistruar në regjistrin e dedikuar të kufizimeve (shtojca e Urdhrit Nr. 586, të MSHMS). Në këtë në lidhje me të gjitha institucionet e lartpërmendura éshtë dhënë urdhër i veçantë për të shmangur ndërhyrjet e punonjësve të policisë brenda spitaleve/reparteve.

Të dhënat e kufizimit të raportuara nga çdo spital psikiatrik për periudhën Janar – Dhjetor 2019 duket se ka disa probleme, kryesisht lidhur me dokumentacionin për të gjitha rastet e kufizimit, siç e ka përshkruar tashmë Delegacioni në raportin e tyre.

- Spitalet Psikiatrike të Tiranës: 21 raste me këmisha force dhe 1 në izolim;
- Spitali Psikiatrik Elbasan: 3 raste të kufizimit kimik dhe mekanik;
- Spitali Psikiatrik Vlorë; 32 kufizim mekanik dhe 1 izolim;
- Spitali Psikiatrik Shkodër: 1 rast kufizimi mekanik.

Në këtë kuadër, vitin e ardhshëm, zbatimi i duhur i masave të sipërpërmendura do të jetë objekt i një monitorimi të rregullt të të gjitha spitaleve psikiatrike nga MSHMS.<sup>105</sup>

### **c. Përgjigja e Institucionit përgjegjës**

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KPT-së të lidhura me procedurat e kufizimit, MSHMS u tërroqi vëmendjen të gjitha shërbimeve të shëndetit mendor te specializuara me shtretër në vend, për zbatim korrekt të këtyre procedurave, veçanërisht me elementët të lidhur me dokumentimin. Duke qenë se COVID-19 kushtëzoi zbatimin e vizitave monitoruese sipas planifikimeve paraprake të MSHMS, me tejkalimin e kësaj situatë do të vijohet me planifikimin dhe zbatimin e këtyre vizitave me qëllim vlerësimin e zbatimit te rekomandimeve të mësipërme.

---

<sup>105</sup> shih: <https://rm.coe.int/16809cb571> “Response of the Albanian Government to the report of the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT on its visit to Albania)” from 20 to 30 November 2018 CPT/Inf (2020), fq. 36-37.

#### d. Gjetjet e MKPT

##### Rekomandimi i KPT-së për këtë çështje, pjesërisht i zbatuar.

Nga inspektimet e kryera nga MKPT, rezulton se në tërësi spitalet psikiatrike janë të kompletuara me mjetet kufizuese, por ato janë të vjetëruara, kryesisht “jelekët e forcës”. Pacientët me sëmundje kritike me pranim të pavullnetshëm, të cilët refuzojnë trajtimin e nevojshëm të shëndetit mendor, mund t'i nënshtrohen gjithashtu kufizimit fizik. Prandaj, kufizimi fizik është një qasje vendimtare për të mbajtur trajtimin e nevojshëm të pacientëve me çrregullime të rënda mendore. Mjetet e kufizimi fizik duhet të vendosen/perdoren nga personel i kualifikuar. Duke qenë se personeli dhe pacientët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve kritike gjatë aplikimit të kufizimit fizik, vetëm personeli i kualifikuar është i autorizuar të aplikojë kufizimin fizik.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se ende nuk është miratuar një protokoll të unifikuar specifisht për spitalet psikiatrike, për përdorimin e mjetave të forcës. Për të mbrojtur interesin më të mirë të pacientit, përdorimin e mjetave të forcës duhet të zbatohet si mjeti i fundit vetëm nga personeli i kualifikuar.

MKPT-ja rekomandon se nga autoritete shendetesore duhet te merren masat që dhomat e kufizimit fizik të ndërtohen dhe pajisen në përputhje me pikën 4.4.6 të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit mendor të Specializuar me Shtretër”, në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar.

## **Përfundime të përgjithshme:**

- Koordinim më të mirë nga institucionet eprore në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KPT-së nga institucionet përkatëse sipas përgjegjësisë.
- Mungesa e kuptimit thelbësor të Raportit nga organet zbatuese rezulton në mos angazhimin maksimal në dhënien e rëndësisë së duhur zbatimit të këtyre rekomandimeve.
- Nevoja emergjente për trajnimin e punonjësve të cilët janë të angazhuar në zbatimin e këtyre rekomandimeve.
- Zbërthimin në detyra specifike të këtyre rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe marrjen e masave konkrete për zbatimin e tyre.
- Hartimin e një plani masash për zbatimin e tij në vijimësi dhe ngritjen e një mekanizmi përgjegjës dhe efikas për ndjekjen e zbatimit të këtyre rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe kontrollin e tyre të herëpashershëm nga institucioni epror.
- Marrja e masave për zbatimin efektiv dhe real të rekomandimeve të KPT-së, pasi vetëm dërgimi i shkresave për njohjen dhe zbatimin e këtij reporti nuk ka arritur qëllimin për realizimin e tyre.
- Njohjen e menjëhershme të drejtuesve të emëruar rishtaz në institucionet zbatuese me këtë report, pasi ndryshimet e shumta në struktura kanë sjellë për pasojë standarde të ndryshme në realizimin e tyre.
- Rekomandimet e KPT-së janë një garanci për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për rrjedhojë duhet të bëhen pjesë integrale e punës së përditshme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre.
- Implikimet buxhetore në shumicën e rasteve kanë sjellë një ritëm të ulët ose dhe pamundësinë në zbatimin e rekomandimeve dhe për pasojë kanë sjellë kushte dhe trajtim çnjerëzor në respektimin e të drejtave të njeriut.
- Institucionet në të shumtën e rasteve kanë reaguar mbi zbatimin e rekomandimeve pas kërkesave të përsëritura nga ana e Institutonit të Avokatit të Popullit pa i kushtuar vëmendjen e duhur dhe rëndësisë së këtij reporti.

- Evidentojmë raste ku komunikimi i autoriteteve me KPT-në ka qenë i pasaktë duke krijuar përshtypjen e gabuar në realizimin e këtyre rekomandimeve siç është mbyllja e dhomave të sigurisë dhe vendosja në konservim *de jure* por jo *de facto* e Zaharisë etj.
- Monitorimet e vazhdueshme të institucionit të Avokatit të Popullit sjellin në mënyrë të vazhdueshme në vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse rëndësinë e marrjes së masave dhe zbatimit të rekomandimeve të KPT-së, zbatimi i të cilave mbetet në masë të ulët.
- Niveli i zbatimit të rekomandimeve të KPT-së është i ulët duke mbajtur në konsideratë se ka kaluar një kohë e mjaftueshme nga zbardhja e këtij Raporti, dhe se masat e marra deri më tani nuk kanë sjellë rezutatet e kërkua.
- Moszbatimi i përpiktë i rekomandimeve të KPT-së sjell për pasojë mosrespektimin/shkeljen e standardeve të kërkua dhe gjithëpranuara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

## ANEX

**Tabela pasqyruese e shërbimit mjekësor në burgje**

Nr.	Institucioni	Organika Mjek	Mjek		Infermier			Kapaciteti zyrtar i nr. te te burgosurve ne IEVP
			Fakti	Mungesa Mjek [1]	Organika Stafi Infermier	Fakti	Mungesa Infermier	
1	Jordan Misja 313	2	2 mjek me kohë te plotë -	Nuk ka	9	8	1	320
2	Mine Peza 302	2	2 mjek me kohë te plotë -	Nuk ka	6	6	0	170
3	IEVP Durrës	5	4 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	11	11	0	300
4	IEVP Krujë	6	4 mjek me kohë te plotë 2 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te plotë (ose 2 mjek me kohë te pjesshme)	12	12	0	196
5	IEVP Fier	4	2 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme dhe 1 mjek	12	10	2	870
6	IEVP Kosovë, Lushnjë	2	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	5	5	0	189
7	IEVP Vlorë	2	Nuk ka mjek me kohë te plotë 2 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te plotë (ose 2 mjek me kohë te pjesshme)	6	6	0	115
8	IEVP Reç, Shkodër	4	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme dhe 2 mjek	11	9	2	775
9	IEVP Tepelenë	2	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	5	5	0	70
10	IEVP Drenovë	3	3 mjek me kohë te plotë	Nuk ka	7	4	3	312
11	IEVP Elbasan	2	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	5	5	0	140
12	IEVP 325 Burgu i Grave	2	2 mjek me kohë te plotë	Nuk ka	5	5	0	80
13	IEVP Burrel	2	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	5	5	0	198
14	IEVP Sarandë	1	Nuk ka mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	4	3	1	31
15	IEVP Peqin	4	3 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	10	9	1	685
16	IEVP Fushë Krujë	3	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme dhe 1 mjek	6	6	0	312
17	IEVP Rrogozhinë	3	3 mjek me kohë te plotë	Nuk ka	6	6	0	343
18	IEVP Lezhë	3	1 mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme dhe 1 mjek	9	9	0	100
19	IEVP Berat	3	Nuk ka mjek me kohë te plotë 2 mjek me kohë te pjesshme	2 mjek me kohë te plotë	5	5	0	37
20	IEVP Kukës	1	Nuk ka mjek me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	0	-	-	36
21	IEVP Kavajë	2	1 me kohë te plotë 1 mjek me kohë te pjesshme	1 mjek me kohë te pjesshme	5	5	0	40
Totali		58	33 mjek me kohë te plotë 19 mjek me kohë te pjesshme	16 mjek me kohë te plotë	144	134	10	5592

[1]Për qëllim të dhënies së shërbimit 1 mjek me kohë të plotë mund të zëvendësohet me 2 mjek me kohë të pjesshme.

Për 21 IEVP të inspektuara nga MKPT për vitin 2021, rezulton se organikat e këtyre institucioneve kanë në total 58 mjek të miratuar, nga të cilët :

- 33 prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë;
- 19 prej tyre janë të punësuar me kohë të pjesshme.

Mungesa e mjekëve në total në të gjithë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, është gjithsej 16 mjekë me kohë të plotë. Kjo është përllogaritur duke marrë në konsideratë edhe faktin se në një pjesë të madhe të IEVP një pjesë e shërbimit mjekësor mbulohet nga mjeket me kohë të pjesshme.

## ANEX

Tabela me të dhënat për mbipopullimin dhe shtretërit e lirë në IEVP

<b>NR.</b>	<b>Institucioni</b>	<b>Kapaciteti fakt</b>	<b>Kapaciteti në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë</b>	<b>Popullimi në I.E.V.P në muajt përkatës</b>	<b>Mesatarja e popullimit për muajt përkatës</b>	<b>Mbipopullimi/ Shtretër bosh (e llogaritur duke mare si referencë muajin dhjetor dhe kapacietin zyrtar)</b>
1	IEVP Fier	860	870	Korrik 697 Gusht 756 Shtator 775 Tëtor 824 Nëntor 824 Qershor 694 <b>Dhjetor 683</b>	750 të burgosur	187 shtretër bosh
2	IEVP-së Kosovë, Lushnjë	182	189	Qershor 93 Korrik 92 Gusht 92 Shtator 129 Tëtor 156 Nëntor 166 <b>Dhjetor 123</b>	122 të burgosur	66 shtretër bosh
3	IEVP Kukës	34	36	Qershor 46 Korrik 40 Gusht 37	34 të burgosur	8 shtretër bosh

				Shtator 31 Tëtor 27 Nëntor 27 <b>Dhjetor 28</b>		
4	IEVP Vlorë	168	115	Maj 166 Qeshor 169 Korrik 184 Gusht 202 Shtator 206 Tëtor 177 Nëntor 175 <b>Dhjetor 170</b>	181 të burgosur	<b>55 persona mbi popullim</b>
5	IEVP Reç, Shkodër	775	775	Prill 471 Maj 456 Qershori 457 Korrik 455 Gusht 471 Shtator 508 <b>Dhjetor 479</b>	471 të burgosur	296 shtretër bosh
6	IEVP Tëpelenë	75	70	Shkurt 91 Mars 93 Prill 93 Maj 94 Qershori 100 Korrik 98	94 të burgosur	<b>19 persona mbi popullim</b>

				<b>Dhjetor 89</b>		
7	IEVP Drenovë	382	312	Janar 464 Shkurt 469 Mars 469 Prill 471 Maj 460 Qershori 464 Korrik 464 <b>Dhjetor 464</b>	466 të burgosur	<b>152 persona mbi popullim</b>
8	IEVP Elbasan	140	120	Mars 158 Prill 160 Maj 157 Qershori 160 Korrik 163 Gusht 170 <b>Dhjetor 163</b>	186 të burgosur	<b>43 persona mbi popullim</b>
9	IEVP Durrës	299	300	Janar 261 Shkurt 258 Mars 255 Prill 259 Maj 256 Qershori 265 Korrik 277 Gusht 311 Shtator 318	271 të burgosur	39 shtretër bosh

				<b>Dhjetor 261</b>		
10	IEVP Burrel	196	198	Shkurt 158 Mars 150 Prill 150 Maj 165 Qershori 164 Korrik 155 <b>Dhjetor 159</b>	157 të burgosur	38 shtretër bosh
11	IEVP Sarandë	36	31	Janar 35 Shkurt 35 Mars 37 Prill 37 Maj 40 Qershori 38 <b>Dhjetor 35</b>	37 të burgosur	4 persona mbi popullim
12	IEVP Peqin	550	685	Janar 414 Shkurt 414 Mars 401 Prill 413 Maj 414 Qershori 409 <b>Dhjetor 414</b>	411 të burgosur	271 shtretër bosh
13	IEVP Minë Peza	170	170	Janar 162 Shkurt 167 Mars 161	198 të burgosur	8 shtretër bosh

				Prill 161 Maj 158 <b>Dhjetor 162</b>		
14	IEVP Fush Krujë	312	312	Nëntor 373 <b>Dhjetor 373</b> Janar 367 Shkurt 375 Mars 382 Prill 381	375 të burgosur	<b>61 persona mbi popullim</b>
15	IEVP Rrogzhinë	338	343	Janar 241 <b>Dhjetor 240</b> Nëntor 244 Tëtor 255 Shtator 249 Gusht 259	248 të burgosur	3 shtretër bosh
16	IEVP Lezhë	105	700	Prill 80 Maj 96 Qershori 99 Korrik 94 Gusht 116 Shtator 124 <b>Dhjetor 137</b>	107 të burgosur	563 shtretër bosh
17	Jordan Misja 313 Tiranë	468	320	Nëntor 418 <b>Dhjetor 389</b> Janar 391	403 të burgosur	<b>69 persona mbi popullim</b>

				Shkurt 406 Mars 406 Prill 407		
18	Ali Demi (Gra)	114	80	Qershori 60 Muaji Korrik 71 Gusht 77 Shtator 75 Tëtor 77 Nëntor 76 <b>Dhjetor 58</b>	71 të burgosur	22 shtretër bosh
19	IEVP Berat	112	37	Janar 127 Shkurt 138 Mars 139 Prill 141 Maj 142 Qershori 141 <b>Dhjetor 127</b>	136 të burgosur	90 persona mbi popullim
20	IEVP Krujë (Zaharia)	308	196	Nëntor 308 <b>Dhjetor 0</b>	E mbyllur	
21	IEVP Kavajë	40	40	Korrik 24 Gusht 20 Shtator 20 Tëtor 19 Djetor 17	20 të burgosur	13 shtretër bosh
22	Spitali I burgut	100	99	-	E ndryshueshme	
23	IEVP Tropoje	26	25	Korrik 20 Gusht 20	22 të burgosur	1 person mbi popullim

				Shtator 22	
				Tëtor 20	
				Nëntor 22	
				<b>Dhjetor 26</b>	
24	IEVP Vaqar	146	-	-	E mbyllur

Totali		<b>5300</b> shtretër faktik	<b>5827</b> shtretër sipas faqes zyrtare		<b>4762</b> - numri mesatar i të burgosurve	<b>494</b> persona mbi popullim per IEVP të caktuara (bazuar në të dhenat e muajit dhjetor dhe kapacitetit të publikuar në faqen zyrtare të Ministrise se Drejtësise) si dhe 1514 shtretër të lire.
--------	--	--------------------------------	--	--	---	---

- Për IEVP të cilat janë të mbyllura, nuk janë llogaritur numri i kapaciteteve, gjithashtu për spitalin e burgjeve numri nuk mund të përllogaritet pasi është një e dhënë e ndryshueshme në mënyrë periodike.

Mbipopullimi ne IEVP me %

Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale	Kapaciteti zyrtar	Numri i personave të burgosur në muajin dhjetor	% e mbipopullimit për muajin dhjetor
<b>IEVP Vlorë</b>	115	170	48%
<b>IEVP Tepelenë</b>	70	89	27%
<b>IEVP Drenovë</b>	312	464	49%
<b>IEVP Elbasan</b>	120	163	36%
<b>IEVP Sarandë</b>	31	35	13%
<b>IEVP Fush Krujë</b>	312	373	20%
<b>Jordan Misja 313 Tiranë</b>	320	389	22%
<b>IEVP Berat</b>	37	127	243%
<b>IEVP Tropoje</b>	25	26	4%